

Banka popullore e Republikës së Maqedonisë



RAPORTI VJETOR 2015

Shkup, prill 2016

Përkthim në gjuhën shqipe: Grupi punues i Fakultetit të biznesit dhe ekonomisë pran
Universitetit të Evropës Juglindore Tetovë (i pa lekturuar).

Përmbajtja

Fjala e guvernatorit.....	5
I. Politika monetare në vitin 2015.....	8
1.1. Objektivat e Bankës popullore.....	8
1.2. Pozicionimi i politikës monetare.....	9
II. Ambienti ekonomik ndërkombëtar	17
III. Zhvillimet makroekonomike në vitin 2015	21
3.1. PBB dhe inflacioni.....	21
3.2. Tregu i punës.....	23
3.3. Financat publike	26
3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm.....	30
3.5. Agregatët monetarë dhe kreditorë	35
IV. Ambienti makroekonomik dhe politika monetare më 2016 dhe 2017	41
V. Instrumentet monetare	44
5.1. Bonot e thesarit.....	44
Raporti 1. Vështrim mbi rrjedhat e krijimit dhe tërheqjes së likuiditetit në vitin 2015.....	45
5.2. Depozitat dhe kreditë e disponueshme në BPRM	46
5.3. Rezerva e obligueshme.....	47
5.4. Repo-operacione për krijimin e likuiditetit në sistemin bankar	49
5.5. Kredia e instancës së fundit	49
Raporti 2. Zhvillimet në tregun e parasë.....	50
VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore	51
6.1. Ndryshimet në kornizën për menaxhimin me rezerva valutore.....	51
Shtojca 3. Aktivitete të lidhura me promovimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e rezervave valutore	52
6.2. Kushtet për investim në tregjet ndërkombëtare financiare.....	53
6.3. Investimi në rezerva valutore të huaja.....	55
6.3.1. Ekspozimi kreditor.....	55
6.3.2. Likuiditeti i rezervave valutore.....	56
6.3.3. Struktura valutore	57
6.3.4. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit dhe rezultatet nga investimi i rezervave valutore.....	58
VII. Aktivitetet dhe trendet në sistemet pagesore.....	60
7.1. Sistemet pagesore.....	60
7.2. Instrumentet pagesore	62
7.3. Mbikëqyrja e sistemeve pagesore.....	64
7.4. Aktivitetet tjera në sistemet pagesore.....	64

VIII.	Emetimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike në Republikën e Maqedonisë - operacionet e thesarit	66
8.5.	Monedha në qarkullim	66
8.6.	Furnizimi i bankave me kartëmonedha dhe monedha metalike	67
8.7.	Përpunimi dhe riciklimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike	68
8.8.	Ekspertiza për paratë e dyshimta/ falsifikuara	68
8.9.	Shitja e monedhave metalike për çështje koleksionimi	69
IX.	Statistika	70
X.	Funksioni mbikëqyrës dhe rregullator i BPRM	73
10.1	Kuadri rregullator mbikëqyrës për vitin 2015.....	73
10.2	Kryerja e supervizionit dhe mbikëqyrja	74
10.3	Kontrollet në terren të rreziqeve.....	74
10.4	Kontrollet në terren në pajtueshmëri me rregulloret.....	75
10.5	Licencimi i bankave dhe shtëpive të kursimit në vitin 2015	76
XI.	Auditimi i brendshëm.....	77
XII.	Përmirësimi i kapacitetit institucional i BPRM.....	78
12.1.	Planifikimi strategjik	78
12.2.	Menaxhimi me rreziqet operative.....	78
12.3.	Sigurimi i vazhdimësisë në punë.....	79
12.4.	Administrimi i burimeve njerëzore.....	79
12.5.	Veprimtaria kërkimore.....	81
12.6.	Zhvillimi në fushën e teknologjisë informative	82
XIII.	Aktivitete tjera	83
13.1.	Bashkëpunimi ndërkombëtar	83
13.2.	Marrëdhëniet me publikun.....	84
13.3.	Edukimi financiar	84
13.4.	Veprimtari muzeore, bibliotekare dhe arkivuese	85

Fjala e guvernatorit

Të nderuar,

Në vitin 2015, ekonomia e Maqedonisë edhe përkundër rreziqeve dhe jo sigurisë së pranishme për gjatë vitit shënon arritje adekuate makroekonomike. Në kushte të rreziqeve të mëtejme nga ambienti i jashtëm, vazhdimisht të pranishme në vitet e krizës globale dhe të rikuperimit të ekonomisë globale të pas krizës, si edhe rreziqet gjeopolitike më të theksuara, edhe në këtë vit përsëri dolën në pah sforcimet fundamentale të ekonomisë së Maqedonisë të bazuar në ndryshimet strukturore, të cilat mundësuan ruajtjen e një rritje ekonomike adekuate. Nga ana tjetër, për vitin 2015 ishin në mënyrë specifike të theksuara rreziqet në raport me situatat politike të brendshme, të cilat edhe pse sollën një dozë shtesë të pasigurisë, vlerësohen se kishin pasoja të kufizuara ndaj ekonomisë. Megjithatë, këto situata imponuan sfida shtesë në udhëheqjen e politikës monetare ndaj të cilëve u përgjigj me ndryshime adekuate të drejtuara kah realizimi i objektivave ligjore të vendosura.

Në kushte të inflacionit të ulët, pozitës tejte solide në bilancin e pagesave dhe si pasoj e kësaj edhe zhvillimi stabël i kursit të këmbimit, normat e interesit të instrumenteve bazike monetare në vitin 2015 ishin të pandryshuara. Relaksimi shtesë i politikës monetare në euro-zonën për gjatë vitit, si ekonomi-esperancë, ishte në favor të rruajtjes së pandryshueshme të politikës monetare vendore, duke pasur parasysh rritjen implicite të normave vendore të interesit. Nga ana tjetër, që nga tremujori i parë i vitit, ishte theksuar hapësira për rruajtjen e politikës monetare adaptuese, nëpërmjet uljes shtesë të normave të interesit të depozitave të disponueshme dhe krijimin e parakushteve për orientimin më të madh të mjeteve të disponueshme të bankave drejt kreditimeve të sektorit privat.

Gjithashtu edhe në vitin 2015 ishte në zbatim masa jostandarde për lirim nga rezerva e detyrueshme për kreditë të miratuara ndaj sektorit eksportues dhe energjetik, por duke pasur parasysh efektin pozitiv ndaj kreditimit, përdorimi i kësaj mase u vazhdua edhe për dy vite.

Në vitin 2015, ekonomia e Maqedonisë e ruajti rritjen solide (3.7%), duke dëshmuar vitalitetin kundrejt rreziqeve të ambientit të jashtëm dhe të brendshëm. Rritja kryesisht u krijua nga konsumi vendor dhe eksporti. Në kësi suaza, duhet në veçanti të theksohet kontributi i kompanive të reja me kapital të huaj në anën e eksportit, projektet e mëdha infrastrukturore të sektorit publik dhe rënies së mëtejme të papunësisë me ndikim pozitiv ndaj konsumit individual. Inflacioni në vitin 2015 ishte në një normë të butë negative (-0.3), nën ndikimin e faktorëve të anës së ofertës, edhe atë kryesisht çmimet e ulëta të karburanteve në tregje botërore, të cilët kishin ndikim më të lartë edhe të zhvillimit të inflacionit në suaza globale. Megjithatë mesatarja e inflacionit bazë ishte i moderuar pozitivisht (0.5%) duke referuar në kërkesë vendore solide. Deficiti në llogarinë rrjedhëse, edhe pse pak u zgjerua, përsëri pas gjashtë viteve me radhë është në nivel të ulët prej rreth 2% nga PBB. Edhe më me rëndësi, në vitin 2015 është shënuar ngushtim të deficitit, kryesisht si pasojë e kompanive të reja në zonat ekonomike, si edhe efektit të volitshëm të çmimeve të importit të energjisë, ndërsa transferet private edhe matej janë relativisht stabël. Llogaria financiare e bilancit të pagesave shënon zhvillime specifike, pjesërisht duke shprehur ambientin global të ndërlikuar, me çka është realizuar fluks hyrës të moderuar të investimeve direkte, flukse dalëse në bazë të pagesave të obligimeve të shtetit ndaj jashtë, si edhe të daljeve të sektorit privat. Në kësi kushte, rezervat valutore shënuan një rënie të moderuar, por megjithatë ngelën në nivelin adekuat.

Edhe pse ekonomia në tërësi, në mënyrë solide i tejkaloi sfidat nga ambientet, megjithatë josituria e pranishme në raport me situatën politike vendore dhe eskalimit të krizës greke mëtepër u bart me kanalet e pritjeve, e veçanërisht duke u reflektuar kah prirja për kursime të popullatës. Sipas kësaj, në kushte të pasigurisë dhe rënies së shtrirjes së interesit në mes depozitave denarike dhe atyre në valutë të huaj, rritja e depozitave gjithsej në mënyrë të moderuar ngadalësoi trendin disavjeçar të denarizimit të kursimeve, që në vitin 2015 shënoi stabilizim. Në kësi rrethana, është realizuar ndryshim te rezervat e detyrueshme nëpërmjet lirimit të bankave nga ky obligim për depozitat denarike të popullatës mbi një vit, me qëllim ti jepet përkrahje kursimit afatgjatë në valutë vendore. Zhvillimet kredituese në mënyrë të moderuar u ngadalësuan për gjatë krizës politike, por megjithatë kah fundi i vitit përsëri u përshpejtuan, me çka realizimi i rritjes vjetore prej 9.5% është i ngjashëm me atë të vitit të kaluar dhe njëherit mbi nivelin e realizimeve të më shumë vendeve të regjionit.

Në një përzierje shumë komplekse të ndikimeve të faktorëve të mjedisit të jashtëm dhe atij të brendshëm, përsëri u dëshmuar bazat e shëndosha dhe stabile të sistemit bankar në Republikën e Maqedonisë. Gjatë një pozicioni stabil të kapitalit dhe të likuiditetit, është realizuar një zvogëlim i vogël i pjesëmarrjes së plasmanëve jofunksionale. Megjithatë, rreziku kreditor duke pasur parasysh lidhshmërinë me aktivitetet kyçe të bankave, edhe matej është në qendër të interesit tonë. Në këtë kontekst, kah fundi i vitit 2015 sollëm pakon e masave që do ju kushtohen rreziqeve eventuale në sferën e miratimit dhe rritjes së shpejtë të kredisë konsumatore afatgjata të popullatës dhe në mënyrë shtesë ndërmarrja e masave të cilat do lehtësojnë qasjen gjer te financat, e veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Masat në raport me shlyerjen e plasmanëve jofunksionale të cilët janë të rezervuar në më shumë se dy vite, do të duhej të kontribuojnë për një tregues sa më real të punës së bankave. Në kontekst të eskalimit të krizës greke, ndërsa duke pasur parasysh lidhjet e zhvilluara tregtare dhe financiare me këtë ekonomi fqinje, në pjesën e dytë të vitit, në aplikim ishin masat e përkohshme, masat për kufizimin e daljes së kapitalit kah jorezidentët grek. Në përgjithësi marur edhe në vitin 2015 vazhdoi avancimi i rregulativës për sistemin bankar, në pajtueshmëri me standardet në këtë sferë, që do të duhej në mënyrë shtesë të forcon punën e vet.

Në kushte të ndryshimeve të mëdha në tregjet financiare ndërkombëtare, edhe në vitin 2015 bëme përpjekje të mëdha që të rrisim fleksibilitetin në sferën e menaxhimit me rezervat valutore. Përpjekje identike të vlefshme janë bërë edhe në avancimin e aktiviteteve tjera të punës. Veçanërisht duhet theksuar përkushtimin tonë të vazhdueshëm për harmonizimin me standardet valide në sferën e statistikave, sistemit të pagesave, infrastrukturës informative dhe të gjitha sistemeve tjera. Në vitin 2015 u soll sistemi për udhëheqje me rreziqet operative të punës për të sforcuar mekanizmin e kontrollit në të gjitha sferat e punës. Avancimi i aktiviteteve hulumtuese, edukimit financiar dhe hapja e rritur kah publiku edhe matej janë në listën e prioriteteve, me efekte të shumta pozitive ndaj agjentëve tjerë ekonomik në ekonominë vendore. Pritet që aktivitetet aktuale në sferën e trajnimeve të mëtejme dhe mbindërtimin e kuadrit, si edhe gjerë më tani, në vazhdimësi do kontribuoj për forcimin e kapaciteteve të institucionit që ka të bëjë me menaxhimin e sfidave në të gjitha segmentet e punës.

Në pajtueshmëri me projeksionet makroekonomike, edhe në vitin 2016 mund të presim arritje makroekonomike solide edhe pse përsëri këto pritje janë në një masë të theksuar të ngarkuar me rreziqet aktuale të ambientit të jashtëm dhe atij të brendshëm. Ngelim në gatishmëri dhe në fleksibilitet të reagojmë ndaj të gjitha sfidave, me qëllim të realizimit të objektivave të politikës monetare në raport me ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe kursit të këmbimit, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe përkrahjen e stabilitetit makroekonomik në ekonominë vendore.

Shkup, 28 prill 2016

*Guvernator dhe kryesues
i Këshillit të BPRM-së
Dimitar Bogov*


I. Politika monetare në vitin 2015

1.1. Objektivat e Bankës popullore

Ruajtja e stabilitetit të çmimeve paraqet objektivin kryesor ligjor të politikës monetare të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë (NBRM). Objektivi tjetër i BPRM i cili është në varësi të objektivit kryesor, është të kontribuoj drejtë ruajtjes së sistemit financiar stabël, konkurrues dhe orientues kah tregu. BPRM e mbështet politikën e përgjithshme ekonomike pa mos rrezikuar arritjen e objektivit kryesor dhe në përputhje me parimin e ekonomisë së hapur të tregut e konkurrencës së lirë. Në aspekt strategjik, në drejtim të arritjes së objektivave bazë, nga tetori i vitit 1995 e gjer më vitin 2001 BPRM e aplikon strategjinë e rruajtjes stabël të kursit të këmbimit nominal të denarit në raport me markën gjermane dhe më pas në raport me euron.


BPRM në vitin 2015 edhe përkundër pasigurisë së jashtëzakonshme të ambientit për gjatë pjesës më të madhe të vitit, me sukses realizoi objektivat e parashtruara ligjore. Krahas rreziqeve të pranishëm dhe thujtës të vazhdueshëm nga ambienti i jashtëm, në vitin 2015 pasiguria në mënyrë shtesë ishte e theksuar edhe si pasojë e kontekstit politik vendor të pavolitshëm. Efektet nga këto dy faktor ishin të kufizuar dhe kryesisht u reflektuan nëpërmjet kanalit të pritjeve, që pjesërisht ndikoi edhe në kursin e këmbimit. BPRM në vitin 2015 intervenoi edhe me një sasi të moderuar të shitjeve neto të valutave, por duke ruajtur stabël kursin e këmbimit nominal të denarit në raport me euron. Në anën tjetër, kompanitë e reja me kapital të huaj të cilat kanë arritur eksport solid, si edhe çmimet e ulëta të naftës, kishin reflektim të volitshëm ndaj zhvillimeve të tregut valutë. Rezervat valutore u zvogëluan, në kushte të pagesave neto të obligimeve të shtetit ndaj jashtë, por përsëri ngelën në nivel solid, me çka të gjithë treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore në vazhdimësi ishin të volitshme dhe treguan nivel të mjaftueshëm për amortizimin e goditjeve eventuale të pavolitshme. Në raport me stabilitetin e çmimeve, në vitin 2015 ishte shënuar një rënie e moderuar e nivelit të çmimeve, në tërësi si pasojë e faktorëve të anës së ofertës, respektivisht nga çmimet më të ulëta të importit të energjisë. Nga ana tjetër inflacioni bazë, mesatarisht edhe më tej është pozitiv që korrespondon me rikuperimin e kërkesës vendore dhe kah fundi i vitit në mënyrë graduale mbyll hendekun negativ të prodhimit. Nga aty, ishte vlerësuar se ka të bëjë me përshtatshmërinë e përkohshme të nivelit të çmimeve në teposhtë, e cila nuk shkakton rreziqe nga vazhdimësia e deflacionit dhe mbindërtimit të rënies së çmimeve në pritjet inflacioniste të subjekteve ekonomike.

Grafik 1
Hendeku i prodhimit dhe inflacioni në %*




* Hendeku i prodhimit paraqet indikatorin për gjendjen ciklike të ekonomisë dhe përlogaritët si raport në mes të shmangies së PBB së realizuar nga PBB potenciale dhe nivelit të PBB potenciale ($GDP_{\alpha} = \frac{GDP_{\alpha} - GDP_p}{GDP_p}$). Te inflacioni dhe inflacioni bazë është paraqitur norma mesatare vjetore në tremujor.

Grafik 2
Rezervat valutore bruto




Grafik 3
Treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore*



* Sipas rregullës së Greenspan dhe Gvidoti (Greenspan-Guidotti rule) është e nevojshme që vendi të ruaj mbulimin e plotë të borxhit afatshkurtër (maturimi rezidual) me rezervat valutore.
** Aktivi likuid përbëhet nga aktivi me likuiditet më të lartë dhe depozitave afatshkurtra të afatizuara te bankat e huaja. Aktivi gjithsej nuk i inkorporon mjetet te bankat vendore.
*** Treguesi u referohet kredive kah sektorin financiar dhe jofinanciar.
Burimi: BPRM dhe ESHS.

Grafik 4
Treguesit e zgjedhur për stabilitetin financiar (në %)



1.2. Pozicionimi i politikës monetare


Gjatë vitit 2015, BPRM e ruajti nivelin e normës së interesit në nivelin më të ulët historik prej 3.25%, me çka edhe mategj aplikon politikë monetar të përshtatshme¹. Gjithashtu, edhe për gjatë vitit 2015 në fuqi ishin masat të orientuara kah përkrahja e kreditimit të sektorit korporativ, nëpërmjet të së cilit nxitet kreditimi i korporativ, ndërsa në të njëjtën kohë zbuten rreziqet eventuale të sektori i jashtëm. Rishqyrtimi i përshtatshmërisë së pozicionimit të politikës monetare kryhej në vazhdimësi, në bazë të pritjeve të sendërtuara në projeksionet e rregullta makroekonomike, në përcjelljen e kushteve më të reja ekonomike financiare në kontekst të projeksioneve, si dhe në bazë të bilancit të

¹ Në mars të vitit 2015, BPRM i zvogëloi normat e interesit për depozitat e disponueshme brenda ditës prej 0.50% në 0.25% dhe të depozitave 7-ditore nga 1.00% në 0.50%. Zvogëlimi u realizua për shkak të orientimit të tepcicës së mjeteve likuide të bankave kah sektori privat dhe shfrytëzimi i depozitave të disponueshme për menaxhim të tepcicave likuide afatshkurtra në suaza të periudhës së rezervës së detyrueshme.

rreziqeve si dhe mundësisë së realizimit të tyre. Duke pasur parasysh pasigurinë e ambientit të jashtëm dhe atij të brendshëm në vitin 2015, që kishte efekte të caktuara ndaj pritjeve të subjekteve ekonomike si dhe prirjes së tyre në raport me vëllimin dhe strukturën valutore të kursimeve, për gjatë vitit janë bërë ndryshime edhe te instrumenti i "rezervës së detyrueshme". Qëllimi i ndryshimeve ishte përkrahja shtesë e kursimit të popullatës në afat gjatë në denar. Kah mesi i vitit 2015, BPRM sollti edhe masën e përkohshme për mbrojtjen e derdhjes së kapitalit për sjelljen kah Greqia, në kontekst të pasigurisë që kishte të bëjë me krizën e borxhit të Greqisë. Gjithashtu, me qëllim të parandalimi të dukurive rritëse të rreziqeve për stabilitetin financiar si dhe ndikimit të tyre ndaj stabilitetit të ekonomisë në tërësi, ka fundi i vitit janë ndërmarr masa makroprudente për ngadalësimin e rritjes së shpejtë të kredive konsumatore afatgjata, duke i riplotësuar me masa për përkrahjen e kreditimit korporativ.


Pasiguria dhe ndryshueshmëria e zhvillimeve janë karakteristikë e mjedisit të jashtëm edhe gjatë vitit 2015. Edhe pse rikuperimi i ekonomisë globale vazhdoi, përsëri revidimet e vlerësimeve të rritjes ekonomike globale ishin në kahe rënëse. Gjithashtu, për gjatë vitit ishin të ndryshueshme edhe kushtet financiare globale. Ambienti i këtyre imponoi nevojën për menaxhimin me kujdes të politikës monetare vendore. BQE në vazhdimësi e rriste nivelin lehtësues të politikës monetare, që kontribuoi në përmirësimin e kushteve ekonomike dhe financiare në euro-zonën, por njëkohësisht, e theksoi edhe cenueshmërinë dhe pasigurinë e rikuperimit të ardhshëm. Kah mesi i vitit, rreziqet në euro-zonën në mënyrë shtesë erdhën në shprehje si pasojë e eskalimit të serishëm të krizës së borxhit në Greqi, si pasojë e vështirësive të vendit rreth realizimit të pagesave në bazë të maturimit të borxheve të kreditorëve ndërkombëtar. Në fillim të korrikut ato u zvogëluan pas marrëveshjes së Greqisë me partnerët evropian për programin e tretë për ndihmë financiare nëpërmjet mekanizmave Evropian për stabilizim, por ngjarjet e këtyra megjithatë përsëri i theksuan problemet strukturore dhe mundësinë e vazhdueshme për paraqitjen e goditjeve të pavoritshme. Në këtë periudhë, si faktor global i rrezikut u paraqitën edhe përshpejtimi i rritjes së ekonomisë kineze, me çka efektet e pavoritshme ndaj ekonomisë vendore ishin të vlerësuara se mundën të ndjehen nëpërmjet kanaleve indirekte. Rritja më e ngadalësuar ekonomike e Kinës është faktor i rrezikut për rritjen e euro-zonës, e veçanërisht për Gjermaninë, e cila nga ekonomitë evropian është më e eksponuar në eksport, ndërsa nëpërmjet këtij kanali ajo krijon rreziqe indirekte për ekonominë e Maqedonisë. Njëherit, rritja e ngadalësuar e ekonomisë kineze reflektohet edhe në tregjet e produkteve primare, veçanërisht te metalet, që në mënyrë të pavoritshme reflektohet te kushtet e këmbimit të ekonomisë së Maqedonisë. Në të vërtetë ndryshimet e vazhdueshme në pritjet për çmimet e produkteve primare që ndikojnë në inflacionin vendor dhe kushteve të këmbimit janë karakteristika shtesë për vitin 2015. Gjatë vitit, prognozatat për çmimet e naftës, metaleve dhe produkteve ushqimore në vazhdimësi janë korrigjuar në kahe rënëse, duke e rritur pasigurinë dhe duke ndryshuar supozimet në bazë të së cilëve determinohen pritjet në ekonominë vendore.

Grafik 5
Arrijtjet Rishikimet e rritjes ekonomike globale, ndryshimet vjetore (në %)




Burimi: Pasqyra ekonomike botërore (FMN, data baza e PEB).

Grafik 6
VIX indeksi (indeksi i ndryshueshmërisë implicite të letrave me vlerë S&P500)




Grafik 7
Çmimet botërore të produkteve primare, realizimet dhe revidimet, ndryshimet mesatare vjetore, në %



Pozicionimi i politikës fiskale, si një komponentë e rëndësishme e ambientit ku realizohet edhe politika monetare, në vitin 2015 në thelb u vlerësua si relativisht e kujdesshme, por me prani të rreziqeve. Për gjatë vitit nuk kishte sinjale të shmangieve të mëdha nga planifikimi i trajektorës së konsolidimit fiskal, me çka u vërtetua edhe me rebalancin e buxhetit në qershor dhe realizimet për vitin 2015. Edhe pse deficitin buxhetor i paraparë me rebalancin dhe ai i realizuar janë më të mëdhenj nga deficitin paraprak i planifikuar, shmangia është më e vogël në raport me vitet paraprake, ndërsa njëherit shënohet edhe zvogëlim vjetor të deficitit fiskal. Megjithatë, rreziku në raport me dinamikën e mëtejme të konsolidimit fiskal ishte i pranishëm. Krahas kësaj, për gjatë vitit, ekzistonte edhe pasiguria në raport me strukturën e burimeve të financimit të deficitit buxhetor, si pasojë e ndryshimeve të supozimeve për pjesëmarrjen e burimeve të huaja dhe financimit nëpërmjet tregut të brendshëm të letrave me vlerë në burime-bruto të financimit. Edhe përkundër faktit të nivelit komod të rezervave valutore, likuiditetit të lartë të sistemit bankar dhe aktivitetit solid kreditues, këto ndryshime në supozimet për financimin e shtetit nuk

kishin shumë efekt ndaj politikës monetare, por megjithatë e rritën pasigurinë e ambientit për gjatë vitit.

Grafik 8
Revidimi i parashikimeve makroekonomike



Parashikimet për të gjithë treguesit ka të bëjë me parashikimet makroekonomike të BPRM, me një përjashtim të projeksonit të saldosit buxhetor dhe financimin e tij, e cila është marrë nga Ministria e Financave.
Burimi: BPRM, ESHS dhe FMN.

Edhe përkundër pasigurive dhe ambienti i jashtëm me akoma një stimulim të pamjaftueshëm, si edhe ndryshimet të pjesshme të supozimeve të cilat mbështeten projektionet për ekonominë vendore, zhvillimet e treguesve ekonomik vendor ishin relativisht të volitshëm, ndërsa madhësia dhe karakteri i shmangieve në raport me projektionet na udhëzuan në nevojën për ndryshime në pozicionimin politikës monetare nëpërmjet të normës së interesit. Rivlerësimet e rregullta të politikave monetare treguan se niveli i normës së interesit prej 3.25% është adekuat, në kushte të bazave ekonomike të shëndosha, në mungesë të disbalanceve më të mëdha, dhe parasëgjithash me më shumë rreziqe. Në vitin 2015 rezervat valutore, si një tregues për kapacitetin e mbrojtjes prej goditjeve, u zvogëluan, kryesisht si pasojë e shlyerjes së borxheve të shtetit ndaj jashtë, ndërsa në pjesë më të vogël si pasojë e intervenimit të BPRM ndaj tregut valutor. Megjithatë, të

gjithë treguesit e mjaftueshmërisë së rezervave valutore në vazhdimësi rruhen në nivel adekuat. Gjithashtu edhe për vitin 2015 ishte karakteristike revidimi i vazhdueshëm e deficitit të llogarisë rrjedhëse, më saktë përmirësimi i tij, në kushte kur arritjet e kapaciteteve të reja ishin mbi pritjet dhe treguan përmirësime strukturore të sektorit të jashtëm. Efekt të fuqishëm pozitiv ndaj llogarisë rrjedhëse kishte edhe rënia e çmimeve të derivateve të naftës, e cila ishte shumë më e vjetër në krahasim me pritjet fillestare. Nga ana tjetër, rezervat në llogarinë financiare ishin në gjendje dhe kahe të pavolitshme. Një nga faktorët kyç të këtyre ndryshimeve ishin rrjedhat afatshkurtra (valutave dhe depozitave të popullatës), të cilat dhanë sinjal për rritje të prirjes së popullatës për posedim të valutave të gatshme, në kushte të rreziqeve sa më të mëdha nga ambienti i jashtëm dhe rreziqeve politike vendore. Megjithatë, këto efekte ishin të moderuara, ndërsa në tregun valutor me një intensitet të lartë u reflektuan për gjatë muajit qershor dhe korrik, kur edhe eskaloj kriza në Greqi dhe rreziqet vendore. Në këto dy muaj, BPRM intervenoi me një sasi të mëdha të shitjeve neto të valutave, ndërsa intervenimi kumulativ në muajt e ngelur donë të thotë riblerje neto të valutave të huaja. Shitjet e përgjithshme neto e valutave të huaja për gjithë vitin shënon rreth 34 milionë euro, që është një përqindje shumë e vogël nga tërësia e rezervave valutore të disponueshme, a me atë edhe tregues të karakterit kufizues të efekteve nga rreziqet, por edhe për potencialin solid valutor në sistemin bankar, i mjaftueshëm për mbulimin e nevojave valutore në ekonomi.


Zhvillimet e tregut valutor në vitin 2015 i konstatuan pritjet stabile të kursit të këmbimit, ndërsa në atë kontekst edhe në pritjet stabël të inflacionit. Niveli i përgjithshëm i çmimeve vazhdoi të zvogëlohet në mënyrë të moderuar edhe për gjatë vitit 2015 (rënie mesatare vjetore prej 0.3%), në tërësi si pasojë e çmimeve më të ulëta të energjentëve. Për gjatë vitit, në kushte të realizimeve më të dobëta dhe korigjimet e vazhdueshme rënëse të pritjeve ndaj çmimeve importuese solli që BPRM të revidoj projeksionin për inflacionin në kahe rënëse. Përshtatshmëria e përcaktuar në teposhtë për gjatë vitit ishte karakteristike edhe për pritjet inflacioniste, kryesisht si pasojë e zvogëlimit të çmimeve të produkteve primare. Në rrethana të këtilla, kur ecuria e inflacionit dhe pritjet inflacioniste ishin nën ndikimin e ndryshueshmërisë së çmimeve, ishte vlerësuar se përshtatshmëritë janë të një karakteri të përkohshëm. Kjo u konstatua edhe nëpërmjet vlerësimeve për mbylljen e hendekut të prodhimit kah fundi i vitit dhe nëpërmjet ndryshimeve të inflacionit bazë (pa produktet ushqimore dhe energjetike), e cila kishte tendenca të rritjes së moderuar edhe në vitin 2015 duke shënuar vlera mesatare prej 0.5%

Krahas pritjeve stabël të kursit të këmbimit dhe të inflacionit, rreziqet e shkaktuara nga kriza e borxheve të Greqisë dhe konteksti politik vendor, patën efekt të konsiderueshëm ndaj vëllimit të kursimeve të popullatës dhe afatizimit të tyre si dhe strukturës valutore. Për gjatë vitit, kursimet edhe matej rriten, por megjithatë rritja e depozitave të popullatës në suaza të sistemit bankar ishin më të dobët në krahasim me atë të vitit të kaluar. Reagimet e subjekteve vendore ndaj pasigurisë së rritur në lidhje me krizën e borxheve në Greqi dhe ambientit politik vendor ishte evident dhe nëpërmjet të një prirje të theksuar të popullatës për rruajtjen e mjeteve likuide në llogarit e transaksioneve, ndërsa kursimi i rri në formë të depozitave², në masë më të madhe ishte në valutë të huaj. Megjithatë, niveli i euroizimit, i matur nëpërmjet pjesëmarrjes së depozitave me komponentë valutore në depozitat gjithsej u mbajt në nivel relativ stabël edhe kah fundi i vitit shënonte vlerën prej 40.3%. Karakteristikë pozitive ishte fakti që kursimi i ri në formë të depozitave të afatizuara ishte plasuar në afat gjatë, me çka edhe pjesëmarrja e depozitave afatgjata të popullatës në gjithsej depozitat, mesatarisht u rrit në vitin 2015.

² Kundrejt faktorëve të theksuar, rritja e kursimeve në valutë të huaj i shënuar në muajin e parë të vitit, shpjegohet si efekt i masave të Bankës qendrore Zvicerane për lëshimin e kufirit të poshtëm të kursit të këmbimit (prej 1.2 franga Zvicerane për një euro) në janar të vitit 2015.

Grafik 9

Shkalla e euroizimit, pjesëmarrja e depozitave valutore në gjithsej depozitat (me para depozituese), në %



Burimi: BPRM.

kapitale, me një rëndësi të veçantë gjer në fund të vitit⁴. Masat ishin sjell me qëllim të mbrojtjes nga daljet eventual të theksuara të kapitalit nga ekonomia vendore kah Greqia dhe me atë pengimin e prishjes së theksuar të ekuilibrit në bilancin e pagesave dhe të stabilitetit të sistemit financiar.

Krahas pranisë së rreziqeve në ekonomi, mungesa e e presioneve inflacioniste dhe realizimet e volitshme në sektorin e jashtëm, si dhe përkrahja fiskale në rritjen ekonomike nëpërmjet investimeve në projekte infrastrukturore, siguruan ambient të volitshëm për një rritje solide ekonomike të mëtejme. Aktiviteti ekonomik në vitin 2015 rritej me një rritëm solid, me çka realizimet ishin të moderuara mbi pritjet. Shikuar në aspekt të politikës monetare, ritmi dhe struktura e rritjes ekonomike nuk kontribuoi në krijimin e ç'ekujlibrave të brendshëm apo të jashtëm në ekonominë vendore. Rikuperimi i ekonomisë në vitin 2015 ishte i përkrahur edhe nëpërmjet të aktiviteteve kredituese të bankave. Aktiviteti i tregut kreditues rritej, i përkrahur edhe nga lehtësimet e kushteve kreditore si edhe nga rritja e kërkesës për kredi. Megjithatë, gjatë vitit, me një rritje të rreziqeve nga ambienti i brendshëm dhe rritjes së ngadalësuar të burimit themelor të financimit të bankave, kreditimit i sektorit bankar u ngadalësua dhe ishte nën pritjet e projeksioneve të muajit prill. Ky ngadalësim ishte i përkohshëm, me çka kah fundi i vitit në tregun kreditor ishte shënuar një rritje e lartë e aktiviteteve, e cila kontribuoi për realizimin e rrjedhave më të mëdha në krahasim me ato të projektuarat. Zhvendosjet pozitive kah fundi i vitit ishin konstatuar edhe nga aspekti i strukturës së rritjes kreditore, ose rritjes kredituese të sektorit korporativ. Në këtë kontekst, BPRM në vitin 2015 vazhdoi ti jep përkrahje kreditimit të sektorit korporativ, nëpërmjet vazhdueshmërisë së vlefshmërisë së masave jostandarde të orientuara kah përkrahja e neto-eksportuesve dhe prodhuesve të energjisë elektrike⁵. Me qëllim të vazhdimit të këtij trendi, në pakon e masave makroprudente që BPRM i solli në dhjetor për

³ Me këto ndryshime BPRM realizoi zvogëlimin e normës së rezervave të detyrueshme për obligimet e bankave ndaj personave fizik në sferën e valutës vendore me afatizim mbi një vit, nga 8% në 0%, me çka këto obligime fituan tretman të njëjtë si edhe detyrimet mbi dy vite, për të cilat nga viti 2012 aplikohet norma 0%. Më detajisht për ndryshimet në rezervat e detyrueshme shiko në pjesën e Raportit vjetor me titull Instrumentet monetare.


⁴ Me skadimin e afatit të vlefshmërisë, në dhjetor të vitit 2015 masat u ndërprehen.

⁵ Me këtë masë mundësohet zvogëlimi i bazës për rezervat e detyrueshme të bankave për vlerën e kredive të reja të lejuara për neto eksportuesit si dhe prodhuesve vendor të energjisë elektrike dhe për investimet e bankave në mjete borxhi në valutë vendore pa klauzolë valutore të lëshuara nga neto-eksportuesit dhe prodhuesit vendorë të energjisë elektrike. Masa u soll kah fundi i vitit 2012, ndërsa filloi të aplikohet nga viti 2013. Nga sjellja e masës, aplikimi i saj ishte vazhduar dy herë, përkatësisht gjer në fund të vitit 2017.

mbrojtje nga rreziqet e mundshme në të ardhmen ndaj stabilitetit financiar dhe pengimin e paraqitjes së joekuilibrave makroekonomik në të ardhmen, ishin inkorporuar edhe masa për lehtësimin e kushteve për financimin e sektorit korporativ⁶.

Grafik 10


Struktura e aktivitet të bankave – kontribut në ndryshimet vjetore, në p.p.



Burimi: BPRM.

Grafik 11

Kontributi në ndryshimin vjetor të gjithsej kredive, në p.p.




Në kushte të aplikimit të “de fakto” kursit valutor fiks-nominal të denarit në raport me euron, ndryshimet në normat e interesit në euro-zonën, si ekonomi esperancë, kanë rol të rëndësishëm në aspekt të pozicionimit të politikës monetare në vend. Në vitin 2015, BQE e mbajti normën bazë të interesit në nivel prej 0.05%, me çka shtrirja e interesit në mes të normës bazë të BPRM dhe normës së interesit bazë të BQE u mbajtë në nivel stabil dhe në dhjetor shënoi 3.2 p.p.

Në ekonominë vendore, bankat edhe mëtej i zvogëlojnë normat e interesit, me çka shtrirja e interesit në mes normave denarike të interesit dhe atyre në valutë të huaj në mënyrë të moderuar u zvogëlua, gjatë një zvogëlimi më të theksuar të normave denarike të interesit të depozitave në raport me normat e interesit të depozitave në valutë të huaj⁷.

⁶ Më detajisht për masat makroprudente të BPRM shiko në pjesën 10.1 të këtij raporti ose në shtojcën numër 3: Pasqyrë e pakos më të re të masave të sjellura nga ana e BPRM në dhjetor të vitit 2015, Raporti i tremujorit të BPRM, shkurt viti 2016.

⁷ Për ngushtimin e shtrirjes së interesit në fillimin e vitit 2015 kontribut të theksuar kishte metodologjia e re e normave të interesit, më të cilën normat e interesit të depozitave në të parë dhe depozitave brenda ditës duke filluar nga viti 2015 nuk inkorporohen në përlogaritje të interesit të gjithsej depozitave.

Grafik 12
Shtirirja e interesit p.p.



Norma bazë e interesit të BPRM – norma e interesit e bonove të thesarit të BPRM.

Norma bazë e interesit të BQE – norma e interesit të operacioneve bazike për rifinansim të BQE.


Burimi: BPRM dhe BQE.

II. Ambienti ekonomik ndërkombëtar


Ekonomia botërore vazhdoi të rimëkëmbet edhe gjatë vitit 2015, por më me ngadal në krahasim me periudhën paraprake. Rritja ekonomike botërore në vitin 2015 ishte 3.1%, që paraqet një ngadalësim të moderuar në krahasim me vitin paraprak, dhe njëkohësisht edhe rritje më e ulët që nga fillimi i krizës globale. Rritja më ngadalësuar ekonomike është pasojë e ngadalësimit të mëtejshëm të ekonomive me rritje të përsheptuara, në masë të madhe të shkaktuara nga rënia e aktivitetit të vendeve eksportuese të mallrave, duke pasur parasysh ndërthurjet jo të favorshme të këtyre tregjeve. Kjo veçanërisht vlen për tregun e naftës, ku përgjatë vitit 2015 erdhi deri tek korigjimi i papritur i theksuar rënës i çmimeve. Gjithashtu, në rritjet e ulëta ekonomike të këtij grupi të vendeve ka kontribuar edhe ngadalësimi i rritjes së Kinës. Duke pasur parasysh madhësinë dhe rëndësinë e ekonomisë kineze në kërkesën globale, këto arritje si dhe pasiguria rreth zhvillimeve në të ardhmen u bartën në korniza globale përmes kanaleve tregtare, rënie e çmimeve botërore të një pjese të produkteve primare, rënie e besimit dhe rritja e ndryshueshmërisë së tregjeve financiare. Rreziqet e theksuara gjeopolitike gjithashtu kanë ndikuar negativisht në rritjen globale. Në anën tjetër, në vitin 2015 në grupin e ekonomive të zhvilluara erdhi deri te një përsheptim i lehtë i rritjes ekonomike, e cila pjesërisht është si pasojë e rritjes së për, shpejtuar të eurozonës. Pikërisht, rikuperimi ekonomike e euro-zonës vazhdoi në vitin 2015, por i sforcuar dhe në masë të madhe i mbështetur nga forcimi konsumit privat. Rritja e të ardhurave të disponueshme, e mbështetur nga arritjet e mirë e tregut të punës dhe rënia e çmimit të naftës e mundësoi rimëkëmbjen e konsumit. Nga ana tjetër, investimet dhe eksporti në eurozonë edhe më tej vlerësohen si burime jomjaftë të fuqishëm të rritjes. Në grupin e vendeve të zhvilluara, ekonomia e SHBA-ve, edhe gjatë vitit 2015 ka shënuar rritje më të lartë dhe njëkohësisht edhe realizimet ishin pak më të mira në krahasim me vitin paraprak. Bartës kryesor i rritjes edhe të ekonomisë amerikane ishte konsumi, e përkrahur nga kushtet e favorshme financiare dhe përmirësimit të kushteve të tregut të punës dhe tregut të patundshmërive.

Grafik 13


Rritja ekonomike globale (në %)



Rritja e tregtisë globale (në %)



Ritja reale e PBB në vendet e zhvilluara (në %)




burimi: Pasqyra ekonomike botërore, tetor viti 2015 dhe azhurnimi në janar të vitit 2016, Eurostat.

Inflacioni në korniza globale edhe matej ngadalëson duke reflektuar në masë të madhe rënien e çmimeve botërore të energjentëve dhe çmimeve të produkteve primare ushqimore. Inflacioni global në vitin 2015 ishte 2.6%, kundrejt 3.2 % të një vit më parë. Një reduktim i ndjeshëm i inflacionit ishte vërejtur në grupin e vendeve të zhvilluara, ku inflacioni nga 1.4% në vitin 2014 është zvogëluar në 0.3% në vitin 2015. Ky ngadalësim i inflacionit të përgjithshëm e reflekton rënien e komponentët ushqyese dhe energjetike, ndërsa inflacioni bazë në këtë grup të vendeve edhe matej është stabil. Te vendet me ritje të shpejtuar, krahas rënies së çmimeve botërore të energjisë dhe ushqimeve, inflacioni rritet në mënyrë të moderuar dhe nga 5.1% në vitin e kaluar, arrin në 5.5% në vitin 2015. Këto lëvizje të çmimeve në një pjesë janë si pasojë e deprecimit të valutave në vendet eksportuese të naftës, e që kanë efekt bartës në inflacionin e përgjithshëm.


Në raport me treguesit konkret kuantitativ, të cilët e pasqyrojnë ambientin e jashtëm të ekonomisë së Maqedonisë, kërkesa e huaj efektive për prodhimet e Maqedonisë në vitin 2015 u rrit me 1.5% me çka rikuperimi që filloi në vitin e kaluar vazhdoi edhe gjatë këtij viti. Kontribut më të madh pozitiv në realizimet vjetore kishin ekonomitë e Gjermanisë dhe Bullgarisë, ndërsa vendet e tjera kanë pasur kontribut pozitiv por më të moderuar. Në pajtueshmëri me zhvillimet globale të çmimeve, inflacioni efektiv i huaj në vitin 2015 ishte negativ dhe shënonte -0.3%. Shikuar në aspekt të vendeve të veçanta, lëvizjet negative në masë të madhe shpjegohen me ndryshimet në Serbi (në kushtet e deprecimit të dinarit) si edhe me rënia e çmimeve në Greqi, Slloveni dhe Bullgari.

Grafik 14
Kërkesa e huaj efektive



Burimi: Përlogaritjet e BPRM⁸.

Grafik 15
Inflacioni efektiv i huaj




Në tregjet e produkteve primare në vitin 2015, vazhdoi trendi i uljes së çmimeve të energjisë, metaleve dhe produkteve ushqimore. Korrigjim më të rëndësishëm në rënie ka pësuar çmimi i naftës, e cila ka shënuar rënie të theksuar në gjysmën e dytë të vitit 2014 dhe uleshin gjithashtu edhe në vitin 2015. Çmimi mesatar i naftës prej 96 dollarë amerikan për fuçi e tipit "brend" në vitin 2014 u zvogëluan në mesatarisht 51 dollar në vitin 2015. Për këtë zhvillim të çmimit të naftës kanë ndikuar si faktorët në anën e ofertës ashtu edhe faktorët në anën e kërkesës. Vendet anëtare të OPEC-ut kanë kontribuar në rritjen e ofertës. Ata, me qëllim që të ruajnë pjesëmarrjen në treg, gjatë gjithë vitit nuk u përgjigjën në rënie e çmimeve dhe vazhduan me nivelin e lartë të prodhimit. Pritjet për përfshirjen e fundit të Iranit, pas heqjes së sanksioneve ndaj këtij shteti nga Kombet e Bashkuara, gjithashtu kishte presion rënës ndaj çmimit, si dhe shkallës së lartë të stoqeve në SHBA. Në anën e kërkesës, rritja ekonomike më e dobët e ekonomive me rritje të shpejtuar dhe ekonomive në zhvillim ka kontribuar në uljen e çmimit të këtij produkti. Rënia vjetore e çmimeve të metaleve ka vazhduar fuqishëm edhe në vitin 2015 dhe shënonte 21%, që paraqet të katërtin vit radhazi të rënies së çmimeve. Kjo rënie është rezultat i kërkesës së dobët nga ana e vendeve me zhvillim të shpejtuar dhe vendeve në zhvillim, veçanërisht të Kinës dhe Indisë në kushte të rritjes së ofertës dhe nivelit të lartë të stoqeve. Në vitin 2015, indeksi i çmimeve të ushqimit u zvogëluar për 17% në krahasim me vitin paraprak e cila


⁸ Kërkesa e huaj efektive llogaritet si shumë e indekseve të ponderuar të prodhimit të brendshëm bruto të partnerëve më të rëndësishëm tregtarë të Republikës së Maqedonisë. Në llogaritjen e indeksit janë të përfshira: Gjermania, Greqia, Italia, Holanda, Belgjika, Spanja, Serbia, Kroacia, Sllovenia dhe Bullgaria. Ponderet janë llogaritur në bazë të pjesëmarrjes së eksportit ndaj këtyre vendeve në eksportin e përgjithshëm. Inflacioni efektiv i huaj paraqet një shumë të ponderuar të indekseve të çmimeve të konsumit të vendeve, partnerë më të rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë në sferën e importit të mallrave për konsumin e gjerë. Struktura e ponderuar bazohet në pjesëmarrjen e normalizuar të importit nominal nga secili vend në importet e përgjithshme nominale në periudhën prej vitit 2010-2012. Në llogaritjen e këtij treguesi janë përfshirë: Bullgaria, Gjermania, Greqia, Franca, Italia, Austria, Sllovenia, Kroacia dhe Serbia.

rezultoi nga rënia e çmimeve të kulturat e drithërave, vajrave ushqimore dhe produkteve tjera ushqimore.

Grafik 16
Zhvillimi mujor i çmimeve të produkteve primare energjetike dhe joenergjetike



Grafik 17
Zhvillimi mujor i çmimeve të naftës së papërpunuar, metaleve⁹ dhe ushqimeve



Burimi: Baza e të dhënave të FMN për çmimet e produkteve primare.

Në vitin 2015, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara kanë aplikuar politika monetare divergjente. Në SHBA, në kushte të arritjeve ekonomike solide, FED ka filluar normalizimin e politikës monetare dhe për herë të parë pas tetë viteve, në dhjetor të vitit 2015 e rriti shënjestrimin e normës së interesit në tregun e parasë për 0.25 pikë përqindje edhe atë nga 0.25%-0.50%¹⁰. Për gjatë vitit, FED vazhdoi me politikën e riinvestimit të letrave me vlerë, me çka madhësia e bilancit mbetet në nivel stabil. Në aspekt të drejtimeve të ardhshme të politikës, në komunikim me publikun në mënyrë eksplicite është treguar se politika monetare edhe më tej do të mbetet akomoduese edhe përkundër rritjes së normave të interesit me çka procesi i normalizimit do të zbatohet gradualisht, varësisht nga realizimet dhe pritjet ekonomike. Nga ana tjetër ekonomia e eurozonës rikuperohet në vitin 2015, por më ngadalë në krahasim me ekonominë amerikane dhe me intensitet të ndryshëm mes vendeve anëtare. Për të mbështetur procesin e rikuperimit ekonomike dhe përafrimit të normës së inflacionit kah niveli i shënjestruar në afat mesëm, BQE gjatë vitit 2015 vazhdoi me zbatimin e politikës monetare ekspansioniste, duke siguruar mbështetje likuide të institucioneve financiare. Në janar, për të nxitur aktivitetin kreditues, BQE ka miratuar paketë të re të masave stimuluuese. Me këto masa të cilat filluan të zbatohen në mars të vitit 2015, BQE e zgjeroi përfshirjen dhe e rriti sasinë e letrave me vlerë të cilat i ribleu nëpërmjet programeve ekzistuese (CBPP3-Covered Bond Purchase Programme dhe ABSPP-Asset Backed Securitities Purchase Programme)¹¹. Në të njëjtën kohë BQE e uli koston e likuiditetit të bankave për mjetet e siguruar përmes operacioneve të shënjestruara

⁹ Indeksi i metaleve është indeks kompozit që përfshinë çmimet e bakrit, aluminit, xeheve të hekurit, fletëzave metalike, nikelit, zingut, plumbit dhe uraniumit.

¹⁰ Njëkohësisht, FED ka aplikuar edhe instrumente tjera, përkatësisht e rriti normën e kompensimit të bankave për rezervën e detyrueshme (duke përfshirë normën e mjeteve të ndara të tepërta mbi rezervën e detyrueshme) si dhe norma e operacioneve diskontuese (nga 0,75% në 1%). Si plotësim i masave të mëparshme, dhe për vendosjen e kufirit më të ulët të normave të interesit të tregut, FED e përcakton normën e interesit të repo-operacioneve të kundërta gjatë ditës (për tërheqjen e likuiditetit) në nivelin 0,25%. Tek ky instrument, ishte i braktisur kufizimi i furnizimit (në vlerë prej 300 miliard dollar amerikanë), por u përfshinë kufizime ditore në sasinë e pjesëmarrësve individual (në vlerë prej 30 miliard dollar amerikanë).

¹¹ Shuma e letrave me vlerë është rritur nga 12 në 60 miliard euro në muaj. Mandej, në kuadër të programeve ishin të përfshirë edhe letra me vlerë të denominuara në euro me rejting investiv të lëshuara nga qeveritë qendrore të shteteve anëtare të eurozonës, agjencitë dhe institucionet evropiane, me afat maturimit prej 2 deri 30 vjet. Gjithashtu, ishte mundësuar edhe blerja e letrave me vlerë pa rejting investiv, në rast se vendet emetuese janë në kuadër të programit për mbështetje të BE/FMN. Gjithashtu, me programin janë përfshi edhe letra me vlerë me interes kupon të indeksuara për inflacion, si dhe letra me vlerë me interes fluktuiv. Riblerja e letrave me vlerë realizohet në tregun sekondar, duke kufizuar në 33% për emetuesin dhe 25% në vlerë të emetimit. Në kushtet e ndarjes së rrezikut, pjesa më e madhe e blerjes shtesë pra 80% , nuk përfshihen në të ashtuquajturën "Ndarja e humbjeve" përderisa 20% janë pjesë e humbjes së përbashkët të rrezikut hipotetik në Eurosistem (8% e blerjes shtesë, që BQE do të realizoj, përkatësisht 12% e blerjes shtesë, që do të realizojnë bankat qendrore kombëtare).

afatgjata (TLTRO-Targeted Long Term Refinancing Operations)¹². Në kushte kur përsëri pritët ngadalësim i rritjes ekonomike dhe normës relativisht të ulët të inflacionit, BQE kah fundi i vitit e uli normën e interesit për operacionet e depozitave nga -0.2% në -0.3% dhe e ka vazhduar zbatimin e programit për lehtësimin kuantitativ deri kah mesi i vitit 2017.


¹² Zvogëlimi është bërë në atë mënyrë që norma e interesit të këtij instrumenti është vendosur në nivelin bazë të normës së interesit për rifinancim (0.05%) për dallim nga më parë kur kësaj norme të interesit i janë shtuar 0.10 pikë bazë.

III. Zhvillimet makroekonomike në vitin 2015

3.1. PBB dhe inflacioni


Ekonomia vendore vazhdoi të rritet me tempo të përshpejtuar edhe në vitin 2015, vit ky në të cilin komfor të dhënave, prodhimtaria e brendshme shënoi rritje për 3.7%. Ndonëse me një intensitet të përmirësuar në krahasim me vitin paraprak, ekonomia nacionale vazhdoi të rritet në kushte të një shëndetësimi të ngadalë të ekonomive nacionale të partnerëve kyç. Krahas kësaj, gjatë vitit 2015 ekzistonte dhe një shkallë e shprehur e pasigurisë që rrjedhonte nga ndodhitë politike në vend përkatësisht frika nga derdhja e efekteve negative nga to në rrjedhat ekonomike si dhe në subjektet vendore dhe të huaja. Analiza e shtytësve kryesorë të rritjes gjatë vitit 2015, nxjerr në pah se një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur sektori i ndërtimtarisë, lëvizje këto që në masë të madhe rrjedhojnë nga realizimi i projekteve publike infrastrukturore. Edhe në vitin 2015, njëlloj si në vitin paraprak, rritja e ekonomisë vendore në masë të madhe ndërlidhet me funksionimin e kapaciteteve të orientuara drejt eksportit, veprimtaria e të cilave siguroi një rritje të konsiderueshme të prodhimtarisë dhe eksportit. Në rrethana të tilla, u regjistruan edhe zhvendosje pozitive në tregun e punës, që dha në stimul shtesë për rritjen e aktivitetit ekonomik vendor.

Grafik 18
PBB dhe kërkesa efektive e jashtme
(shkalla vjetore e ndryshimit real, në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe "Consensus Forecast", Shkurt 2016. Janë shfrytëzuar të dhëna paraprake të PBB për vitin 2014, ndërsa për vitin 2015 janë shfrytëzuar të dhëna të vlerësuara.

Grafik 19
Vlerësime të aktivitetit aktual ekonomik të subjekteve afariste
(pasqyra e përgjigjeve)*



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave


*Bilanci paraqet dallim në mes përgjigjeve të ponderuara pozitive dhe negative të shprehura në përqindje. Bilanci tregon lëvizjen e treguesit të analizuar ekonomik, e jo lartësinë e tij reale.

Në vitin 2015 është shënuar rritje te pjesa më e madhe e sektorëve ekonomik. Ndikim më të madh në rritjen vjetore kanë pasur ndërtimtaria, tregtia, transporti dhe hoteleria që në masë të konsiderueshme është në përputhje me treguesit afatshkurtër të zhvendosjeve në këto sektorë. Në suaza të tregtisë¹³ në përputhshmëri me të dhënat mbi qarkullimin, rritja kryesisht i përshkruhet qarkullimit të rritur në tregtinë grosiste, ndërsa lëvizje të volitshme vërehen edhe te tregtia në sasi të vogla dhe te tregtia me vetura.

¹³Analiza e lëvizjeve në tregti është bërë në bazë të dhënave për qarkullim në tregti.

Në fushën e transportit¹⁴, realizime më të mëdha vërehen te transporti i udhëtarëve, ndërsa rritja në sektorin e hotelerisë në vitin 2015 është komfor numrit të rritur të turistëve dhe netëve të kaluara në kapacitete hotelerike. Krahas, tre sektorëve të më lartëm, kontribut të veçantë në zmadhimin e vlerës së shtuar në vitin 2015 ka dhënë sektori i ndërtimitarisë, sektor ky në suaza atë të cilit realisht marrë rol më të rëndësishëm ka luajtur aktiviteti i rritur ndërtimorë në fushën e ndërtimeve të ulta në përputhshmëri me realizimin e projekteve infrastrukturore në financim publik. Zhvendosje të volitshme vërehen edhe në sektorin e industrisë, sektor ky në të cilin është regjistruar një rritje e matur e vlerës së shtuar. Në vitin 2015, rënie e vlerës së shtuar vërehet te bujqësia, drejtimi publik dhe mbrojtja si dhe sektori "art, argëtim dhe rekreacion".


Grafik 20
Kontribut në rritjen vjetore të PBB
(në pikë përqindëshe)




Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM.

Janë shfrytëzuar të dhëna paraprake të PBB për vitin 2014 ndërsa për vitin 2015 janë shfrytëzuar të dhëna të vlerësuara.

Grafik 21
PBB, industria dhe shfrytëzimi i kapaciteteve



Grafiku 22
Inflacioni mesatar vjetor (në %), efekt i transferuar dhe rritje e re (në pikë përqindëshe)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM.

lartë të investimeve në mjete themelore, sipas të gjitha gjasave lëvizjet e tillë atë investimet bruto mundet kryesisht ti përshkruhet zvogëlimit të rezervave. Krahas kërkesës vendore, një përkrahje të shprehur për rritjen e shënuar në vitin 2015 ka dhënë edhe sektori i eksportit,

Shikuar nga këndvështrimi i kërkesës, rritja e ekonomisë vendore në vitin 2015, kryesisht sqarohet me rritjen e kërkesës vendore dhe të aktivitetit eksportues. Kërkesa vendore, në masë më të madhe u përkrah nga rritja e kërkesës personale, duke reflektuar kësaj zhvendosjet e volitshme në tregun e punës, rritjen e pagave reale gjatë vitit, si dhe aktivitetin e rritur kreditues ndaj sektorit "familje". Një kontribut më të vogël pozitiv në rritjen e tilla dha edhe konsumi publik, ndërsa investimet bruto mbetën në nivel të përafërt me atë të vitit paraprak. Megjithatë, në kushte të zhvendosjeve mjaft të volitshme te gati të gjitha kategoritë indikativë më frekuencë të


¹⁴Analiza e lëvizjeve në fushën e transportit është realizuar në bazë të dhënave për udhëtarët dhe mallrat e transportuara.

në ç'rast ngjashëm si në vitin paraprak zhvendosjet pozitive në këtë sektor kryesisht kanë të bëjnë me funksionimin e kapaciteteve të reja prodhuese. Zhvendosjet e tilla të kërkesa vendore dhe eksporti, rezultuan edhe me rritje të importit, rritje kjo që ishte e një intensiteti më të ulët në krahasim me eksportin, me çka edhe kontributi i eksportit neto për vitin 2015 është pozitiv.

Ambienti global i çmimeve përgjithësisht të ulta të produkteve primare, paralelisht me çmimet e zvogëluara të produkteve të importuara, ishin faktorët kyç që ndikuan në lëvizjen e çmimeve vendore të konsumit në vitin 2015. Kështu, në mungesë të presioneve më të larta nga kërkesa vendore, zhvendosjet rënese të çmimeve në ambientin e jashtëm rezultuan edhe me rënie të çmimeve vendore në vitin 2015, në ç'rast u shënuar inflacion negativ prej -0.3%, njëlloj si në vitin 2014. Shikuar sipas dinamikës, çmimet e konsumit mbetën në zonën negative në pjesën më të madhe të vitit, me përjashtim të tremujorit të dytë kur është shënuar një rritje e vogël.


Shikuar sipas komponentëve kryesorë në suaza të indeksit, zvogëlimi i çmimeve të konsumit në tërësi sqarohet me zhvendosjet në suaza të komponentë energjetike, ku gjatë vitit 2015 erdhi deri në thellim të rënies së çmimeve vendore të çmimeve të derivateve të naftës duke reflektuar kështu lëvizjen teposhtë të çmimeve të naftës në bursat botërore. Kështu, çmimet e komponentë energjetike në vitin 2015 shënuan rënie prej 4.1% (një kontribut prej -0.6 pikë përqindësh në inflacionin e përgjithshëm). Edhe pranë rënies së çmimeve të energjisë, inflacioni bazë dhe çmimet e produkteve ushqimore bashkërisht në tërë kohëzgjatjen e vitit 2015 kanë shënuar rritje, por kjo rritje në kushte të mungesës së presionit nga ana e kërkesës dhe rënies së çmimeve të produkteve të importuara për konsum personal, ishte mjaft e dobët. Çmimet vendore të produkteve ushqimore, pas rënies në vitin 2014, në vitin 2015 u rritën për vetëm 0.2% (kontribut prej 0.1 pikë përqindësh në inflacionin e përgjithshëm). Një rritje e vogël prej 0.5% u shënuar edhe te çmimet e produkteve në suaza të inflacionit bazë (kontribut prej 0.2 pikë përqindësh).

Grafik 23
Inflacioni vendor dhe inflacioni efektiv i jashtëm, shkallë vjetore të rritjes (Në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM

Grafik 24
Komponenta të ndryshueshme (ushqim dhe energji) dhe afatgjata të inflacionit (participim vjetor, në pikë përqindëshe)



3.2. Tregu i punës


Treguesit në lëmin e tregut të punës dëshmojnë vazhdimësi të trendeve pozitive edhe në vitin 2015. Realizime e mira në këtë sektor të ekonomisë koincidojnë me realizimet

kryesisht pozitive të pjesa më e madhe e sektorëve ekonomik. Kontribut shtesë në rritjen e punësimit, njëlloj si në vitin paraprak, kanë dhënë funksionimi i kapaciteteve të reja në zonat zhvillimore teknologjike-industriale, si dhe ndikimet e politikës fiskale përmes masave aktive për punësim¹⁵, projektet infrastrukturore të financuara me para publike, politikat e subvencionimit të bujqësisë si dhe linjat kreditore të siguruara përmes bankës Investuese Evropiane të dedikuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Numri i të punësuarve të vitin 2015 shënoi rritje për 2.3%, që paraqet një rritje të përshpejtuar në krahasim me vitin paraprak. Shikuar sipas sektorëve, rritja e punësimit në masë më të madhe lidhet me shërbimet, sektor ky në suaza të cilit dallohen tregtia e vogël dhe ajo grosiste, përderisa një kontribut solid individual ka dhënë edhe zmadhimi i numrit të të punësuarve në "drejtori publike, mbrojtje dhe sigurim i obligueshëm social". Edhe në vitin 2015 vazhdoi trendi i rritjes së numrit të të punësuarve në industri, që kryesisht i përshkruhet zmadhimit të numrit të të punësuarve në industrinë përpunuese dhe ndërtimtare. Punësimi në bujqësi shënon një rënie të vogël, meqë kontribuon negativisht në shkallën e përgjithshme të punësimit, pas rritjes mjaft intensive në vitin 2013 dhe stanjacionit në vitin 2014.


Edhe pranë rritjes së kërkesës për fuqi punëtore, në vitin 2015 u shënuar një përshtatje e vogël rënës e ofertës së fuqisë punëtore. Në fakt, popullsia e përgjithshme aktive shënoi rënie për 0.4%, që në kushte të rritjes paralele të popullsisë joaktive për 1% rezultoi me zhvendosje rënës për 0.3 pikë përqindësh të shkallës së aktivitetit duke rënë kështu në 57%. Rritja e kërkesës në kushte të ofertës më të ulët të fuqisë punëtore rezultoi me rënie të papunësisë. Për pasojë, në vitin 2015 shkalla e përgjithshme e papunësisë në vitin 2015 u zvogëluar për 2 pikë përqindësh duke rënë kështu në 26.1%, ndërsa shkalla e punësimit në vitin 2015 shënoi rritje (për 0.9 pikë përqindësh) dhe arriti shkallën mesatare prej 42.1%. Shikuar sipas grupmoshave, një pjesë e konsiderueshme e rënies së shkallës së përgjithshme të papunësisë ka të bëjë me papunësinë e zvogëluar të grupmoshat më të reja të popullsisë, përkatësisht të grupmosha 15 deri 24 vjeçare si dhe të ajo 25 deri 49 vjeçare.

Grafik 25
Disa tregues të tregut të punës
(ndryshime vjetore, në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM


Grafik 26
Shkalla e papunësisë në %, sipas grup moshave
(ndryshime vjetore, në p.p.)



¹⁵Edhe gjatë vitit 2014, Qeveria e Republikës së Maqedonisë përmes Ministrisë për punë dhe politikë sociale dhe Agjencinë për punësim, vazhdoi me implementimin e programeve dhe masave aktive për të stimuluar shkallën e punësimit të tilla si programi për vetëpunësim i cili u zgjeruar që të përfshijë edhe personat e moshës deri 29 vjeçare, ofrim i përkrahjes financiare për ndërmarrje mikro dhe të vogla dhe zejtarë për të hapur vende të reja pune, programe për punë të dobishme për bashkësinë, si dhe pilot projekte për krijim të bizneseve në komunitetet multietnike, trajnime për ndërtime me efikasitet të lartë energjetik, trajnime nga fusha e turizmit, inkubatorë për zejtarë etj.


Në vitin 2015 vërehet një rritje nominale e pagave mesatare të paguara, edhe atë në shkallë më të lartë në krahasim me vitin paraprak. Veç kësaj, për të dytin vit me radhë është shënuar rrije reale e pagave. Kështu, pagat nominale neto dhe bruto¹⁶ kanë shënuar rritje prej 2.5% përkatësisht 2.7%, në çrast te gati të gjitha sektorët e veprimtarive është shënuar korrigjim rritës. Rënie e pagave është shënuar vetëm te bujqësia, transporti dhe magazinimi, veprimtaritë që kanë të bëjnë me patundshmëri dhe në të ashtuquajturin sektor të veprimtarive shërbyese profesionale, shkencore dhe teknike. Në kushte të përshtatjes rënëse të nivelit të përgjithshme të çmimeve të konsumit prej 0.3%, pagat neto dhe bruto shënuan rritje reale prej 2.7% përkatësisht 3%. Në vitin 2015 është shënuar edhe përmirësim i treguesve të konkurueshmërisë¹⁷. Në fakt gjatë vitit 2015 vazhduan trendet pozitive te produktiviteti i punës i cili në kushte të rritjes më intensive të aktivitetit ekonomik në krahasim me punësimin, në vitin 2015 shënoi rritje prej 2.3%. Kur bëhet fjalë për koston e punës për njësi produkti, edhe në vitin 2015 ka mbetur relativisht stabil (duke shënuar një rritje të vogël prej 0.4%), në kushte të zhvendosjeve të ngjashme te produktiviteti dhe pagat.

Grafik 27
Bruto dhe neto paga vjetore
(ndryshime vjetore, në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM


Grafik 28
Neto paga mesatare sipas sektorëve
(Ndryshime vjetore, në %)



¹⁶Bruto paga e përgjithshme e paguar përfshin: neto pagat e paguara për muajin përkatës, tatim personal i paguar dhe kontribute të paguara (për sigurim pensional dhe invalidor, për sigurim shëndetësorë, për punësim, për sëmundje profesionale dhe për ekonominë e ujërave). Të dhënat e mëlartme kanë të bëjnë me pagat e paguara.


¹⁷Produktiviteti dhe koston e punës për njësi produkti në nivel të ekonomisë nacionale janë kalkuluar në bazë të dhënave për PBB, numrin e përgjithshëm të punësuarve, Anketës për fuqinë punëtore të Enti Statistikorë të Republikës së Maqedonisë si dhe të dhënave për bruto-pagat mesatare.

Grafik29
Produktiviteti i fuqisë punëtore
(ndryshime vjetore, në %)



Burimi: Enti shtetërorë i statistikave dhe kalkulime të BPRM.

Grafik 30
Kosto për fuqinë punëtore, për njësi produkti
(Ndryshime vjetore, në %)



3.3. Financat publike

Gjatë vitit 2015 financat publike u karakterizuan me konsolidim të matur fiskal, që kontribuoi në zvogëlimin e borxhit të qeverisë qendrore, përderisa pjesëmarrja e borxhit publik në PBB shënoi një rritje të pakonsiderueshme. Deficiti buxhetor në vitin 2015 ishte 3.5% i PBB përkatësisht ka shënuar rënie prej 0.7 p. p. në krahasim me vitin paraprak. Ndonëse, një pjesë e ngushtimit të deficitit është rezultat i përmirësimit të komponentëve të tij ciklike, pjesa më e konsiderueshme e korigjimit rënie ka të bëjë me përmirësimin e komponentëve strukturorë. Përmirësimi strukturor i deficitit buxhetor është në përputhshmëri me ndryshimet e bëra të tatimit në fitim, ndryshime këto sipas së cilave nga fillimi i viteve 2015 i shfuqizua masa antikrizë për lirim të fitimit të pashpërndarë të kompanive nga tatimimi¹⁸. Ky ndryshim rezultoi me rritje të konsiderueshme të të hyrave nga tatimi në fitim si dhe me realizim më të suksesshëm të të hyrave buxhetore në krahasim me planifikimin në pjesën e parë të vitit. Këto realizime bashkërisht me nevojën për korigjime të caktuara në anën e shpenzimeve, ishin arsyeja kryesore për miratimin e rebalancit të Buxhetit për vitin 2015¹⁹. Me rebalancin e buxhetit është bërë korigjim telartë i anës së të hyrave (për 2.2%), me një korigjim paralel telartë edhe të anës së të dalurave (për 2.9%), në pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse. Korigjimi më i shprehur telartë i të dalurave në krahasim me komponentin e të hyrave rezultoi me rritje të deficitit në 3.6% të PBB, ndonëse me buxhetin fillestarë për vitin 2015 ishte planifikuar që ai të jetë në nivelin 3.4%. Përmirësimi i deficitit të përgjithshëm buxhetor të realizuar në bazë vjetore, reflektoi edhe të deficitit buxhetor primar²⁰, i cili shënoi rënie për 0.9 p.p. të PBB duke arritur nivelin prej 2.3% të PBB. Krahas kësaj është shënuar rritje edhe të saldoja rrjedhëse buxhetore²¹. Ndryshimi i tillë rrjedhoi nga rritja më e lartë e të ardhurave rrjedhëse, krahas rritjes së komponentëve shpenzuesë, që shkaktoi zvogëlim të deficitit rrjedhës në 1.5% të PBB.


¹⁸Krahas kësaj, nga fillimi i vitit 2015 hynë në fuqi ndryshimet ligjore të tatimit mbi vlerën e shtuar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.130/2014), sipas së cilit pragu për regjistrim të personave fizik dhe juridik është zvogëluar nga 2.000.000 në 1.000.000 denarë. Njëkohësisht nga 1.1.2015 kanë hyrë në fuqi ndryshimet në Ligjin për akciza (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 188/2014) komfor të cilave është bërë zmadhimi i akcizës së cigareve.

¹⁹„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ Nr.144/2015 e 24.8.2015.

²⁰Saldoja primare buxhetore paraqet dallim në mes të ardhurave të përgjithshme buxhetore dhe të dalurave të përgjithshme buxhetore, të zvogëluara për nivelin e pagesës së obligimeve rrjedhëse në bazë të borxheve të marra (norma të interesit). Ky tregues fiskal konsiderohet të jetë më adekuat gjatë analizës së kursit aktual të politikës, meqë ai integron shpenzimet fiskale që rrjedhojnë nga menaxhimi i kaluar i politikës fiskale në pjesën e borxhit publik.

²¹Saldoja rrjedhëse buxhetore paraqet dallimin në mes të ardhurave rrjedhëse (të ardhura nga kontribute tatimore si dhe të ardhura jotatimore) dhe të dalat rrjedhëse buxhetore (për paga dhe kontribute, për mallra dhe shërbime, transfere dhe norma të interesit).

Grafik 31
Treguesit fiskal




Burimi: Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë dhe kalkulime të BPRM.

Deficiti i përgjithshëm strukturor²² në vitin 2015 shënoi rënie për 0.3 p.p. të PBB në krahasim me vitin paraprak duke arritur kështu nivelin prej 4.8% të PBB. Paralelisht me këtë edhe të deficitit primar strukturor vërehet përmirësim, respektivisht rënie nga 3.9% të PBB në vitin 2014 në 3.3% në vitin 2015. Nga analizat e këtyre tregues të politikës fiskale, mundet të përfundohet se në vitin 2015 impulsi fiskal²³ ishte negative në masë të vogël, krahas kontributit të tij pozitiv në vitin paraprak. Duke pasur parasysh ngushtimin e jazit negative prodhues në vitin 2015, impulse negative fiskal tregojnë një karakter kontraciklik të politikës fiskale.


²²Deficiti i përgjithshëm buxhetore fitohet po qese nga deficiti faktik buxhetor largohet komponenta ciklike buxhetore. Ai kalkulohet si dallim në mes të ardhurave të përgjithshme buxhetore të përshtatura sipas efektit të dallimit në mes PBB potencial dhe faktit me koeficient të elasticitetit 1 dhe të dalurat reale buxhetore të përshtatura sipas efektit të dallimit në mes PBB potencial dhe faktit me koeficient të elasticitetit 0. Deficiti primar strukturor kalkulohet ashtu që nga deficiti i përgjithshëm strukturorë minusohet efekti i kostove për norma të interesit

²³Impulsi fiskal definohet si dallim në mes saldo të përshtatur ciklike në vitin paraprak dhe atë të vijues.

Grafik 32
Struktura e financimit të saldosh buxhetore
(në milionë denarë)²⁴



Grafik 33
Qarkullimi me letra shtetërore me vlerë në
tregun primar (përqindje e PBB)




Burimi: Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë dhe kalkulime të BPRM.

Në vitin 2015, financimi i deficitit buxhetor u realizua përmes huazimit neto të brendshëm si dhe përmes shfrytëzimit të depozitave të shtetit në BPRM. Gjysma e parë e vitit u karakterizua me mbështetje në financim përmes depozitave, duke pasur parasysh se kah mesi i vitit 2014 shteti i shfrytëzoi kushtet e volitshme në tregjet ndërkombëtare financiare dhe bëri huazim me qëllim të sigurimit të mjeteve për financim të detyrimeve në vitin 2015, që rezultoi me rritje të depozitave të shtetit te BPRM. Krahas kësaj, një pjesë e mjeteve u siguruan përmes mobilizimit të mjeteve në tregun financiar vendor. Huazimi i jashtëm neto ishte negative, duke marrë parasysh pagimin e rregullt të obligimeve nga ana e shtetit, por edhe për shkak të pagesës së parakohshme të borxhit ndaj FMN-së në bazë të Linjës kreditore për kujdes. Në gjysmën e dytë të vitit 2015, huazimi ndaj jashtë ishte burimi kryesor për financim të deficitit buxhetor, i plotësuar nga tërheqja më e matur e mjeteve nga tregjet financiare vendore, në kushte të rritjes paralele të depozitave. Huazimi i jashtëm neto në gjysmën e dytë të vitit në pjesën më të madhe ka të bëjë me euro-obligacionin e katërt të dhjetorit të vitit 2015, në vlerë prej 270 milion euro. Krahas kësaj, gjatë këtij muaji u realizua edhe pagesa e euro-obligacionit të maturuar të vitit 2005 në vlerë prej 150 milion euro. Në relacion me aktivitetin në tregun vendor, qarkullimi i letrave me vlerë në tregun primar në vitin 2015 ishte 9.2% të PBB që paraqet një zvogëlim prej 1.2 p.p. në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë, në vitin 2015 u shënua një rritje e konsiderueshme e gjendjes së letrave shtetërore me vlerë. Rreth gjysma e rritjes së realizuar mundet ti përshkruhet huazimit afatgjatë të shtetit, përmes publikimit të fletëobligacioneve shtetërore më afatgjata, ndërsa për dallim nga viti paraprak, në vitin 2015 na masë të konsiderueshme në shkallën e përgjithshme të huazimit kishte edhe huazimi afatshkurtër.

²⁴ Te grafiku, Dallim në mes të ardhurave të përgjithshme nga letrat me vlerë kontinuale dhe strukturore (tituj shtetërorë dhe obligacione) dhe të dalurave të përgjithshme për pagesa të borxhit të brendshëm. Ndryshimi negativ te depozitat shtetërore nënkupton deponim të tyre te BPRM.

Grafik 34

Stoku i borxhit të qeverisë qendrore dhe borxhi i përgjithshëm publik



Burimi: Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë dhe kalkulime të BPRM.

Stoku i borxhit të qeverisë qendrore²⁵ në vitin 2015 arriti nivelin prej 3433.2 milion euro, duke shënuar një rritje të matur prej 5.8% në krahasim me vitin paraprak. Borxhi i qeverisë në proporcion me PBB është në nivelin 37.8%, që paraqet një rënie të vogël prej 0.3 p.p. në krahasim me vitin 2014 që në tërësi rezultoi nga borxhi i jashtëm i qeverisë qendrore si pasojë e pagesës së borxheve ndaj kreditorëve të jashtëm, në kushte të zmadhimit paralel të komponentës vendore. Nga ana tjetër, te borxhi i përgjithshëm publik²⁶ është shënuar rritje në bazë vjetore (prej 7.7%), por rritje kjo më e vogël në krahasim me gjashtë vitet paraprake. Borxhi publik në fund të vitit 2015 ishte në nivelin 4224.8 milion euro, respektivisht 46.5% të PBB. Rritja prej 0.4 p.p. të PBB në masë më të madhe mundet ti përshkruhet rritjes së borxhit të jashtëm të garantuar të ndërmarrjeve publike dhe të shoqërive aksionare në pronësi shtetërore, si rezultat i huazimit të intensifikuar për projekte infrastrukturore, edhe parë borxhit më të vogël shtetërorë²⁷ në krahasim me vitin paraprak. Analiza e pjesëmarrjes së këtyre dy komponentë në borxhin e përgjithshëm publik sinjalizon një rënie të mëtejme të pjesëmarrjes së borxhit shtetërorë (në 81.7% krahasuar me 83.2% në vitin 2014), krahas pjesëmarrjes gjithnjë e më të lartë të borxhit të garantuar (nga 16.8% në 18.3%). Ndryshimi vjetorë në borxhin publik, shikuar sipas strukturës residente, rrjedhon nga komponentë vendore, me një rritje të shënuar prej 1.2 p.p. të PBB në krahasim me vitin 2014. Nga ana tjetër, borxhi publik i jashtëm shënoi rënie prej 0.7 p.p. të PBB, por edhe më tutje ka pjesëmarrjen më të lartë në borxhin e përgjithshëm publik (67.3%).

²⁵Ka të bëjë me borxhin e qeverisë qendrore përfshirë këtu edhe fondet publike, por pa komunat..


²⁶Borxhi publik është i definuar me ligjin për borxhin publik („Gazeta zyrtare e RM“ nr. 165/14), sipas së cilit ai paraqet shumën e borxhit shtetërorë dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga ana e shtetit ose komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, si dhe ndërmarrjet tregtare të cilat shteti ose komunat, komunat në qytetin e Shkupit ose qyteti i Shkupit paraqiten si pronar kryesor ose i vetëm, e për të cilat shteti ka dhënë garancinë shtetërore.

²⁷Borxhi shtetërorë përfshin shumën e borxheve të qeverisë qendrore dhe pushteteve lokale.

3.4. Bilanci i pagesave, PIN dhe borxhi i jashtëm


Deficiti i llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave edhe në vitin 2015 qëndroi në nivel të matur, duke mos sinjalizuar disbalanse më të shprehura në sektorin e jashtëm. Megjithatë, në krahasim me vitin paraprak, jazi në llogarinë rrjedhëse shënoi një rritje të matur për 0.6 p.p. të PBB dhe arriti në 1.4% të PBB. Në përjashtim të deficitit tregtar, te të gjithë komponentët tjerë të llogarisë rrjedhëse është shënuar përkeqësim. Në fakt, saldoja e këmbimit të mallrave shënoi përmirësim, në kushte të eksportit të zmadhuar të kapaciteteve të reja industrial në ekonominë vendore dhe zvogëlimit të importit të eneregjensëve, në kushte të rënies së shprehur të çmimeve të naftës në bursat botërore. Krahas kësaj, as gjatë këtij vitit nuk janë shënuar presione më të shprehura mbi importin nga ana e kërkesës vendore. Në vitin 2015, përmes llogarisë vjetore të bilancit të pagesave u shënuan të dalura neto prej 1% të PBB, kryesisht për shkak të rrjedhave afatshkurta – valuta dhe depozite, pjesërisht si refleksion i kërkesës së rritur për deviza, në kushte të risqeve në ambientin vendor. Nga ana tjetër, investimet e drejtpërdrejta dhe huazimi nga jashtë shërbyen si burime të ardhurave kapitale shtesë. Duke marrë parasysh, zhvendosjet e tilla në llogarinë rrjedhëse dhe financiare, një pjesë e nevojave për financim të jashtëm i mbuluan përmes rezervave devizore, të cilat u zvogëluan në bazë vjetore, por edhe më tutje mbeten në nivel adekuat.

Grafik 35
Llogaria vjetore, kapitale dhe financiare (në milion euro)




Burimi: BPRM.

Grafik 36
Participimi i komponentëve të veçanta në ndryshimin vjetor të llogarisë rrjedhëse (në pikë përqindje të PBB)




Analiza e këmbimit të jashtëm tregtar tregon zmadhim të dy komponentëve përbërëse, me atë që eksporti i mallrave është rritur me intensitet më të lartë në krahasim me importin e mallrave. Forcë kryesore lëvizëse e realizimeve pozitive të eksporti ishte aktiviteti eksportues i kapaciteteve të reja industrial në pronësi të huaj. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e degëve tradicionalisht eksportuese, në vend të parë industria e përpunimit të metaleve dhe industria tekstile edhe më tutje shënojnë rezultate më të dobëta. Realizimet të eksporti patën refleksion edhe në anën importuese, kështu që komponenti i lëndës së parë për kapacitetet e reja prodhuese ishte faktori kryesor në rritjen e importit. Nga ana tjetër, importi energjetik shënoi rënie të konsiderueshme, kryesisht për shkak të importit më të vogël të derivateve të naftës, të shkaktuar nga rënia e konsiderueshme e çmimeve të naftës në bursat botërore.

Grafik 37
Kontribut në ndryshimin vjetor të eksportit
(në p.p.)



Burimi: BPRM.

Grafik 38
Kontribut në ndryshimin vjetor të importit
(në p.p.)




Sa u përket komponentëve tjerë të llogarisë vjetore, në vitin 2015 suficiti i shërbimeve u zvogëluar për 0.4 p.p. të PBB. Përkeqësimi i saldosit të shërbimeve kryesisht rrjedh nga të dalurat e rritura neto në suaza të kategorisë "shërbime tjera afariste", ndërsa në masë më të vogël edhe nga të ardhurat neto të zvogëluara të pjesës së udhëtimeve. Nga ana tjetër saldoja e shërbimeve të transportit shënoi suficit të konsiderueshëm, që është në përputhshmëri me realizimet pozitive në këmbimin e mallrave. Zgjerimi i deficitit të të ardhurave primare (për 0.6 p.p. të PBB) kryesisht ka të bëjë me të dalurat neto të rritura në bazë të të ardhurave nga investimet e drejtpërdrejta, duke e reflektuar në masë të konsiderueshme fitimin më lartë të përlogaritur të reinvestuar. Suficiti i të ardhurave sekondare shënon rënie vjetore (për 1.3 p.p. të PBB). Kryesisht për shkak të të ardhurave neto më të vogla nga transferet e shtetit²⁸, derisa të ardhurat neto nga transferet private edhe më tutje janë relativisht stabile.

Analiza e treguesve të konkurrueshmërisë çmimore të ekonomisë maqedonase²⁹ tregon përmirësim në krahasim me vitin paraprak. Kursi Real Efektiv Devizor (KREK) i përlogaritur sipas shpenzimeve të jetës shënoi depreciacion prej 0.9%, ndërsa të KREK i deflacionuar me çmimet e prodhuesve të produkteve industriale është shënuar depreciacion prej 2%. Ndryshimet e tilla vjetore rrjedhojnë nga lëvizjet e volitshme të çmimeve vendore në krahasim me çmimet e jashtme, në kushte të ndikimit neutral nga ndryshimi i kursit të këmbimit efektiv nominal. (KKEN).

²⁸ Rënia e transfereve shtetërore para së gjithash vjen si rezultat i bazës së lartë krahasimore të vitit 2014 kur u shënuar nivelet historikisht më të larta të të ardhurave neto nga transferet shtetërore.


²⁹ Analiza e treguesve për kompetitivitetin çmimor është e bazuar në indeksin e RKEK, të kalkuluar me ponder të bazuar në këmbimin me jashtë pa produkte primare. Produktet primare që mbeten të papërfshira në përlogaritje janë: nafta dhe derivatet e naftës, çeliku dhe hekuri, mineralet dhe lëndët e para të importuara për kapacitetet e reja prodhuese në zonat e lira ekonomike.

Grafik 39
KKEK и KREK, (Kalkuluar sipas indeksit të shpenzimeve për jetesë dhe çmimeve të prodhuesve, 2010=100)



Burimi: BPRM.

Grafik 40
Çmime relative (2010=100)




Llogaria financiare e bilancit të pagesave në vitin 2015 karakterizohet me të dalura neto në nivel 1% të PBB. Shikuar në strukturë, burimi kryesorë i të dalurave janë rrjedhat afatshkurta të valutave dhe depozitat e "sektorëve tjerë", që në këtë vit pjesërisht ndërlidhet me risqet prezente në nivel shtetërorë dhe me prirjet e subjekteve afariste për të disponuar me deviza të gatshme në dorë. Në vitin 2015 huazimi i shtetit jashtë kishte efekt pozitiv mbi llogarinë financiare, ndonëse ky efekt ishte i vogël krahasuar me vitin paraprak kur ai ishte faktori kyç në krijimin e të ardhurave financiare.³⁰ Edhe pse nga fundi i vitit 2015 u publikua euro-obligacioni i tretë në vlerë prej 270 milion euro, përsëri gjatë vitit u bë pagesa e një shumë relativisht të lartë për obligimet në bazë të Linjës kreditore për kujdes ndaj FMN-së si dhe për pagesë të euro-obligacionit të parë. Huazimi neto i sektorëve tjerë³¹ në formë të huazimeve afatgjata ishte 0.5% të PBB dhe gati në tërësi rrjedhon nga huazimi i ndërmarrjeve publike, për përkrahje të ndërtimit të infrastrukturës rrugore. Në vitin 2015 investimet e huaja të drejtpërdrejta siguruan të hyra shtesë në llogarinë financiare me 1.9% të PBB, kryesisht në formë të huazimit në mes kompanive, por të njëjtat ishin më të vogla në krahasim me vitin paraprak. Shikuar sipas veprimtarive, investimet e drejtpërdrejta të investitorëve të huaj ishin kryesisht të orientuara në sektorin e shërbimeve³², prodhimin e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit si dhe të produkteve metalike dhe të makinave.

³⁰ Në vitin 2014, shteti mori hua nga tregjet ndërkombëtare financiare përmes publikimit të euro-obligacionit të tretë në vlerë prej 500 milion euro, me qëllim të financimit të nevojave të shtetit në periudhën 2014-2015. Në dhjetor të vitit 2015 u publikua edhe euro-obligacioni i katërt në vlerë prej 270 milion euro. Mjetet nga ky euro-obligacion gjatë vitit 2015 u shfrytëzuan për pagesë të parakohshme të obligimeve në bazë të PKL të FMN-së, respektivisht për pagesë të euro-obligacionit të maturuar të publikuar në vitin 2005 në vlerë prej 150 milion euro.

³¹ „Sektorët tjerë” i referohet bankave dhe sektorit korporativ jobankar.


³² Një pjesë e rrjedhave të investimeve të huaja të klasifikuara në sektorin e shërbimeve kanë të bëjnë me kapacitet në të cilin ka ndodhur transformim i pronësisë. Veprimtaria e kapacitetit në fjalë në fakt është pjesë e sektorit prodhues industrial.

Grafik 41
Llogaria financiare
(% e PBB)




Burimi: BPRM.

Grafik 42
Investime të drejtpërdrejta
(% e PBB)




Pozita ndërkombëtare investuese (PNI) në fund të vitit 2015 vazhdon të jetë negative dhe kap vlerën prej 4945.3 milion euro respektivisht -54.4% të PBB duke qëndruar kështu në suaza të mesatares për disa vitet e fundit. Stabiliteti i PNI në periudhën e fundit është pasojë e tempos së barabartë të rritjes si të mjeteve ashtu edhe të obligimeve ndërkombëtare, që dëshmon që integrim gjithnjë e më të mirë financiar të ekonomisë nacionale. Kur bëhet fjalë për strukturën e obligimeve ndërkombëtare, edhe në vitin 2015 u shënuar një pjesëmarrje e shprehur e investimeve të huaja të drejtpërdrejta si burim financimi që rezultojnë me rritje të produktivitetit të ekonomisë, duke mos kontribuar me këtë rast në rritje të vulnerabilitetit të jashtëm të saj.

Grafik 43
Pozita ndërkombëtare investuese (% e PBB)



Burimi: BPRM.

Grafik 44
Pozita ndërkombëtare investuese sipas sektorëve (% e PBB)



Në krahasim me fundin e vitit 2014, obligimet neto ndaj pjesës tjetër të botës shënuan rritje prej 1.1 p.p. të PBB, në kushte të rënies së përsheptuar të obligimeve ndërkombëtare (4.6 p.p. dhe 3.5 p.p. të PBB, përkatësisht)³³. Analiza sipas sektorëve të pozitës ndërkombëtare investuese të ekonomisë nxjerr në pah se ndryshimet e tilla rrjedhojnë nga ndryshimet në pozitën e bankës qendrore. Kështu, mjetet neto të bankës qendrore i zvogëluar, si pasojë e zvogëlimit të rezervave devizore. Rënia e rezervave devizore erdhi pas zmadhimit të tyre të konsiderueshëm gjatë vitit paraprak, ndërsa oscilimet e tilla në këtë periudhë të vitit në masë më të madhe janë pasojë e ciklit të huazimit të jashtëm dhe pagesës së borxheve nga ana e shtetit. Kështu, përkundër vitit paraprak, në vitin 2015 pozita e jashtme neto e sektorit "shtet" shënon përmirësim vjetorë,


³³Analiza në vlera absolute tregon një përqendrim të pozitës ndërkombëtare investuese në krahasim me fundin e vitit 2014, si rezultat i rritjes të më shprehur të obligimeve ndërkombëtare në krahasim me mjetet ndërkombëtare.

duke reflektuar pagesën e borxheve ndaj kreditorëve të jashtëm³⁴. Në vitin 2015 procesi i pagesës së borxheve ishte karakteristik edhe për institucionet depozituese që rezultoi me rënie të obligimeve neto të tyre në bazë të huazimeve afatgjata. Pozita neto e "sektorëve tjerë" shënon përmirësim, si rezultat i rënies së obligimeve neto ndaj investitorëve të drejtpërdrejtë të huaj.

Në fund të vitit 2015, borxhi i jashtëm bruto ishte 6353.7 milion euro respektivisht 69.9% të PBB që nënkupton zvogëlim prej 0.4 p.p. të PBB në krahasim me fundin e vitit 2014. Rënie a borxhit të jashtëm bruto në masë më të madhe rrjedhon nga rënia e shënuar të borxhi publik, krahas nivelit më të lartë të borxhit të sektorit privat³⁵. Në këtë rast zvogëlimi i borxhit të jashtëm ka të bëjë me zvogëlimin e obligimeve afatgjata të qeverisë qendrore në bazë të borxheve afatgjata, para së gjithash për shkak të pagesës së parakohshme të linjës kreditore për kujdes ndaj FMN-së në shkurt të vitit 2015 në vlerë prej 153.4 milion euro. Njëkohësisht, borxhi i ndërmarrjeve publike edhe më tej vazhdon të shënojë rritje si rezultat i huazimit gjithnjë e më të madh për përkrahje të infrastrukturës rrugore. Në pjesën e borxhit të sektorit privat, është shënuar një rritje e vogël e borxhit në nivel vjetor si rezultat i obligimeve të rritura ndaj investitorëve të drejtpërdrejtë të huaj, në kushte të zvogëlimit të matur të borxhit të sektorit privat bankar dhe jobankar.

Grafik 45

Borxhi i jashtëm bruto, klasifikim sipas huazuesve dhe sektorëve institucional (% e PBB)



Burimi: BPRM.

Marë në përgjithësi, treguesit e huazimit të jashtëm të ekonomisë vendore tregojnë se borxhi i jashtëm bruto ndodhet në zonën e sigurt. Në fakt, në fund të vitit 2015, treguesi i vetëm sipas së cilës ekonomia nacionale mundet të klasifikohet në grupin e ekonomive me shkallë të lartë të borxhit është pjesëmarrja e borxhit të jashtëm bruto në PBB. Analiza e dinamikës së huazimit të jashtëm tregon zhvendosje të volitshme të gati të gjithë treguesit e solventitetit në krahasim me fundin e vitit 2014, me përjashtim të relacionit në mes pagesës së borxhit dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve dhe të ardhurave tjera që shënon përkeqësim. Nga ana tjetër treguesit e likuiditetit tregojnë një përkeqësim të vogël (për 0.2 p.p.) të pozitës së jashtme përmes proporcionit në mes rezervave devizore dhe gjendjes së borxhit afatshkurtër. Megjithatë, ndryshimet janë të vogla, ndërsa mbulesa e obligimeve në bazë të borxhit afatshkurtër me maturim të ardhshëm me rezerva devizore edhe më tutje është mbi një. Në fund të vitit 2015, borxhi i jashtëm neto si një tregues shtesë për pozitën e jashtme të ekonomisë ishte në nivelin 2363.7 milion euro respektivisht 26% të PBB që në

³⁴Në vitin 2015 shteti kreu dy pagesa të mëdha – pagesën e Linjës kreditore për kujdes ndaj FMN-së dhe pagesën e plotë të kryegjësë së euro-obligacionit të parë. Me qëllim të realizimit të pagesave në fjalë u shfrytëzuan një pjesë e mjeteve nga huazimi i madh i shtetit në vitin 2014 e që ishte i dedikuar për financim të nevojave buxhetore për vitet 2014 dhe 2015 si dhe një pjesë e mjeteve nga euro-obligacioni i ri i publikuar kah fundi i vitit 2015.

³⁵Analiza në vlera nominale tregon se rënia e borxhit bruto në tërësi mundet të përkrahë borxhit më të ulët publik edhe pranë rritjes së përshpejtuar të borxhit të sektorit privat.

relacion me fundin e vitit 2014 paraqet rritje prej 4.4 p.p. të PBB. Rritja e borxhit të jashtëm neto është rezultat i rritjes së borxhit të jashtëm neto publik ashtu dhe të borxhit neto privat.

Tabela 1
Tregues të stokut të borxhit të jashtëm

Treguesit e borxhit të jashtëm	Solventiteti				Likuiditeti		
	Pagesa e interesit / Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto-Borxh/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Bruto-Borxh/ PBB	Pagesa e borxhit/ Eksporti i mallrave dhe shërbimeve dhe të hyra tjera	Rezervat valutore/ Borxhi afatshkurtër	Rezervat valutore/ Borxhi afatshkurtër, me maturim të mbetur*	Borxhi afat shkurtër/ Gjithsej borxhi
	në %				raport	raport	në %
31.12.2004	2,41	129,3	49,3	12,4	1,14	0,89	30,3
31.12.2005	2,66	147,0	56,3	11,06	1,67	1,04	26,7
31.12.2006	3,44	131,3	51,8	21,7	1,95	1,34	29,0
31.12.2007	2,78	119,3	51,3	19,4	1,35	1,08	39,8
31.12.2008	2,66	116,9	54,1	10,2	1,29	0,95	35,2
31.12.2009	2,43	131,0	57,8	11,8	1,29	0,94	32,9
31.12.2010	3,22	140,4	59,7	13,9	1,49	0,99	27,9
31.12.2011	3,12	148,4	64,6	16,8	1,78	1,18	25,2
31.12.2012	2,92	142,1	67,6	13,1	1,64	1,03	26,7
31.12.2013	2,51	137,3	67,3	15,8	1,64	1,08	23,3
31.12.2014	3,02	149,4	74,1	17,3	1,82	1,13	22,3
31.12.2015	2,68	146,1	74,0	20,1	1,62	1,10	22,0
Kriteret për borxh të moderuar	12 - 20%	165 - 275%	30 - 50%	18 - 30%		1,00	

* Kriteri i moderuar i ngarkesës me borxh është marur sipas metodologjisë së Bankës Botërore për përpunimin e treguesve të huazimit, e cila nënkupton shfrytëzimin e proceseve tre vjeçare levizëse të PBB dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve si dhe prurjeve tjera si emëruet të përbashkët të përlogaritjeve të këtyre treguesve.

Punuar në pajtueshmëri me „External debt statistics: Guide for compilers and users“, botuar nga FMN.


Sipas parimeve të Grinspan dhe Gvidoti, e nevojshme është që vendi të ruaj pbulim të plotë të borxhit afatshkurt (maturimi i pjesës së ngjatur) me rezerva valutore.

Burimi: BPRM.

3.5. Agregatët monetarë dhe kreditorë


Rritja e masës monetare dhe aktivitetit kreditorë i bankave vazhdoi edhe gjatë vitit 2015. Në kushte të shëndetësimit të mëtejshëm solid të ekonomisë, lëvizjeve pozitive në tregun e punës si dhe të të ardhurave relativisht të larta në bazë të transfereve private, në vitin 2015 vërehet një rritje solide e masës monetare M4 dhe t bazës depozitore në sistemit bankar. Realizimet e tilla në mënyrë shtesë u përkrahën edhe nga në aktivitet i rritur kreditor. Megjithatë, edhe pranë ambient të volitshëm makroekonomik, realizimet depozituese ishin të ndryshueshme gjatë vitit. Kjo kryesisht ndërlidhet me pasigurinë e ndërlidhur me ndodhitë politike në vend si dhe me eskalimin e ndodhive ekonomike-politike në Greqi, faktorë këto që ndikuan mbi masën e përgjithshme të kursimit në suaza të sistemit bankar. Në rrethana të tilla, rritja e depozitave për tërë vitin 2015 është në nivelin e 70% të rritjes së realizuar gjatë vitit 2014. Nga ana tjetër, edhe pranë oscilimeve gjatë vitit, aktiviteti i përgjithshëm kreditues i bankave gjatë tërë vitit 2015 e ruajti tempos e rritjes si në vitin paraprak. Rritja e përgjithshme e kredive të miratuara për sektorin privat gjatë vitit është pak më i lartë se rritja vjetore gjatë vitit paraprak. Realizimet e tilla në tregun e kredive janë refleksion edhe të rritjes së ofertës, por edhe të kërkesës së zmadhuar, e në kushte të qëndrimeve stabil të bankave mbi riskun e kreditimit të sektorit privat dhe pritjeve të tyre për një përmirësim të caktuar të cilësisë së portfolios kreditorë. Aktiviteti kreditues u përkrah edhe përmes politikës së relaksuar monetare si dhe masave qëllimore të ndërmarra nga autoriteti monetar për përkrahje të kreditimit.

Grafik 46
Ndryshimi vjetor i masës monetare M4, kreditë dhe depozitet e përgjithshme, në %



Burimi: BPRM.

Grafik 47
Pjesëmarrja e kredive të përgjithshme dhe masës valore M4 në PBB, në %




Masa më e gjerë monetare M4 vazhdoi të rritet edhe në vitin 2015, ndonëse me një tempo më të ngadaltë në krahasim me vitin paraprak, me çka shkalla vjetore e rritjes në dhjetor ra në 6.8% nga 10.5% në fund të vitit 2014. Krahas lëvizjes më të ngadaltë, një karakteristikë shtesë e rritjes monetare në vitin 2015 është edhe struktura e burimeve të rritjes. Në fakt, në vitin 2015 vërehet një zvogëlim i konsiderueshëm i kontributit të depozitave të afatizuara në rritjen e masës monetare, në llogari të kontributit rritës të instrumenteve me likuiditet të lartë – paratë e depozituara dhe paratë e gatshme në qarkullim. Zhvendosjet e tilla, pjesërisht mundet të ndërlidhen me risqet prezent të shkaktuara nga pasiguria rreth ndodhive politike vendore, si dhe nga eskalimi i sërishëm i krizës në Greqi kah mesi i vitit, që rezultoi me rritje të preferencës së subjekteve ekonomike për të disponuar me mjete me shkallë të lartë të likuiditetit. Megjithatë, efektet nga këto shoqe u vlerësuan si relativisht të kufizuara, ndërsa kah mesi i vitit u shënuar edhe zvogëlim permanent i tyre.

Tabela 2
Komponentë të masës monetare – gjendje dhe ndryshime

	Gjendja			Ndryshimet vjetore		
	2013	2014	2015	2013	2014	2015
Paratë e gatshme në qarkullim	20.706	23.221	26.300	2,9	12,1	13,3
Paratë në depozitë	49.299	62.326	74.982	7,6	26,4	20,3
M1	70.005	85.548	101.282	6,2	22,2	18,4
Depozitat afatshkurtëra në denar	57.112	57.151	53.554	-0,7	0,1	-6,3
Depozitat afatshkurtëra në valutë të huaj	90.949	90.980	96.514	-3,5	0,0	6,1
M2	218.066	233.678	251.350	0,2	7,2	7,6
Depozitat afatgjata në denar	41.509	51.673	53.517	31,0	24,5	3,6
Depozitat afatgjata në valutë të huaj	20.788	24.527	26.140	23,1	18,0	6,6
Gjithsej depozitat*	210.358	224.330	229.725	5,0	6,6	2,4
M4	280.363	309.878	331.007	5,3	10,5	6,8

*pa paratë e depozituara
Burimi: BPRM.

Grafik 48
Komponentë të masës monetare-dinamik




Duke pasur parasysh zmadhimin e preferencës ndaj likuiditetit, në vitin 2015 mbi dy të tretat e rritjes së poyencialit të përgjithshëm depozitues së bankave rrjedhoi nga zmadhimi i mjeteve në llogaritë e transakcionit. Një sjellje e tillë u vërejt te sektori korporativ, që nuk është e pazakontë duke pasur parasysh nevojën për mjete në funksionimin ditorë. Megjithatë, ruajtja e mjeteve të llogaritë rrjedhëse u vërejt edhe te sektori "popullsi", me çka u sinja lizua një kujdes në sjellje në kushte të risqeve prezente. Analiza e kursimit në sistemin banker pa paratë e depozituara tregon se në esencë rritja vjetore parasëgjithash rezulton nga zmadhimi i depozitave të familjeve ndërsa depozitat korporative shënojnë një rritje modeste. Shikuar në suaza të sektorit

“popullsi”, pjesa më e madhe e rritjes së shënuar edhe më tutje i përshkruhet rritjes së kursimit afatgjatë, por në shkallë dukshëm më të ulët në krahasim me realizimet gjatë viteve paraprake. Nga ana tjetër, pas rënies dyvjeçare në bazë vjetore, depozitat afatshkurta në vitin 2015 shënuan rritje, që është një dëshmi shtesë për preferencën e rritur të familjeve për të afatizuar mjetet e tyre në afate më të shkurta kohore. Paralelisht me ndryshimet në strukturën e afatizimit, ky vit u karakterizua edhe me ndryshime në strukturën e rritjes së shënuar vjetore. Kështu, në periudha më të gjata kohore, në vitin 2015 shënohet rritje e preferencës së familjeve për të kursyer në deviza, me çka ato shndërrohen në bartës kryesorë të rritjes së zmadhuar, në kushte të një kontributi të vogël pozitiv nga depozitat në denarë. Edhe te sektori korporativ, rritja e shënuar vjetore rezulton nga depozitat afatshkurta dhe depozitat në valuta të huaja. Edhe pranë, rritjes së matur të prirjes së subjekteve ekonomike për kursim në deviza, përsëri shkalla e eurozimit (e matur përmes pjesëmarrjes së depozitave devizore në stokun e përgjithshëm të depozitave) edhe më tutje shënon zvogëlim të vogël gradual, në çrast në vitin 2015 mesatarisht ishte rreth 41% krahasuar me mesataren prej 42.4% në vitin 2014.

Duke i pasur parasysh lëvizjet e tilla në strukturën e rritjes vjetore të bazës depozituese nga aspekti i afatizimit dhe valutës, në gusht të vitit 2015, këshilli i BPRM solli Vendim për ndryshim të vendimit për rezervë të detyrueshme³⁶. Qëllimi i masës në fjalë është nxitja e kursimit të popullsisë në sistem bankar në afate të gjatë dhe në denarë, me çka do të ishte kontribuar për burime më stabil të financimit të bankave, si dhe përkrahje shtesë të “denarizimit” të ekonomisë, proces ky përmes së cilit zvogëlohen edhe presionet potenciale mbi rezervat devizore.

Grafik 49

Kontribut në ndryshimin vjetor të depoziteve të përgjithshme të amvisërive në p.p.




Burimi: BPRM.

³⁶ Në përputhshmëri me Vendimin për ndryshim të vendimit mbi rezervën e obligueshme, bëhet zvogëlim i shkallës së rezervës së detyrueshme të bankave për obligimet e bankave ndaj personave fizik në valutë vendore me afatizim të kontraktuar mbi një vit, nga 8% në 0%, me çka këto obligime fitojnë të njëjtin trajtim si obligimet mbi dy vjeçare për të cilat që nga viti 2012 zbatohet shkallë prej 0%.

Grafik 50

Struktura valutore dhe sektoriale e depozitave të përgjithshme (me para depozituese)




Burimi: BPRM.

Në vitin 2015, në kushte të zmadhimit të mëtejshëm të ofertës dhe kërkesës për kredi, aktiviteti i tregut të kredive ishte solid. Rritja vjetore e aktivitetit kreditues të bankave ishte 9.5%, ngjishmë si në vitin paraprak. Rritja e ofertës së kredive u përkrah edhe nga likuiditeti i përshtatshëm dhe pozita solvente e bankave, pritet stabil, konkurrenca prezente të tregun kreditor si dhe tendenca për zmadhim të profitabilitetit. Paralelisht me këtë, shëndetësimi ekonomik kontribuoi për një rritje të aftësisë kredimare të subjekteve ekonomike si dhe për një rritje të prirjes së tyre për të huazuar nga bankat. Një konstatim i tillë përkrahet edhe nga rezultatet nga anketa për aktivitetin kreditues. Në fakt, gjatë vitit vërehet një rritje permanente e kërkesës së përgjithshme për kredi, rritje kjo e cila megjithatë është më e shprehur te sektori "familje", edhe atë kryesisht përmes kërkesës së rritur për kredi banesore dhe kredi konsumatore. Në përputhshmëri me lëvizjet e tilla, rrjedhat kredituese të orientuara drejt sektorit "familje" gjatë vitit në kontinuitet qëndruan në zonën pozitive dhe në fund të vitit përfshinë pjesën më të madhe në stokut të përgjithshëm të kredive të miratuara (rreth 57%). Shikuar sipas llojeve individuale të kredive, rritja vjetore në masë më të madhe sqarohet përmes zmadhimit të mëtejshëm të kredive konsumatore në kushte të rritjes së shënuar edhe te kreditë banesore. Nga ana tjetër, gjatë dy viteve të fundit shënohen edhe shkallë mjaft të larta të rritjes edhe te kreditë e konsumit që mundet të paraqet risk për stabilitetin e ardhshëm të sistemit financiar. Me qëllim të reagimit preventive ndaj sinjaleve të tilla për risqet potenciale në rritje nga këto kredi, në dhjetor të vitit 2015, këshilli i BPRM miratoi masa për ngadalësim të rritjes së lartë të kredive afatgjata konsumatore³⁷.

³⁷Informata më të hollëshme mbi masat e miratuara nga a e BPRM në dhjetor të vitit 2013 përmbahen në pjesën 10.1 të këtij raporti si dhe në raportin tremujor, shkurt 2016 në faqen 51..


Grafik 51
Stoku i përgjithshëm i kredive për popullsinë, sipas dedikimit



Burimi: BPRM.

Në relacion me kreditimin korporativ, kreditë e përgjithshëm për ndërmarrjet përfshinë rreth 43% nga rritja e shënuar vjetore në vitin 2015, që paraqet një realizim më të dobët në krahasim me vitin paraprak kur rritja e kredive ishte e shpërndarë gati në mënyrë të barabartë në mes dy sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë. Duke i pasur parasysh zhvendosjet e tilla e me qëllim të stimulimit të mëtejshëm të kreditimit të sektorit korporativ, BPRM vendosi të vazhdojë me zbatimin e masës jostandarde për nxitje të aktivitetit kreditues të eksportuesve neto dhe të prodhuesve të energjisë elektrike. Krahas kësaj me vendimin për ndryshim dhe plotësim të vendimit mbi metodologjinë e përcaktimit të adekuatitetit të kapitalit, BPRM krijoi kushte për lehtësim të qasjes së ndërmarrjeve (përfshirë këtu edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) në shërbimet financiare të bankave.

Grafik 52
Oferta, kërkesa dhe shqyrtimi i riskut të bankave³⁸ (neto-përqind)
Sektori korporativ Sektori „popullsi“




Burimi: Anketë për aktivitetin kreditor, BPRM.

³⁸Sqarim: Oferta ka të bëjë me ndryshimin e kushteve kredituese (po qese përqindja neto është pozitive në atë rast kushtet kredituese janë të ashpërsuara kurse poqese është zero në atë rast ato janë më të relaksuara); kërkesa për kredi (po qese përqindja neto është pozitive në atë rast kërkesa është rritur, kurse po qese ajo është negative atëherë kërkesa është zvogëluar); faktorët e riskut që ndikojnë mbi parakushtet për kreditim (po qese përqindja neto është pozitive në atë rast kushtet kredituese janë të ashpërsuara kurse poqese është negativ në atë rast ato janë më të relaksuara). Në grafikun që ka të bëjë me popullsinë është paraqitur mesatarja e përqindjes neto të faktorëve të riskut që ndikojnë mbi kushtet kredituese gjatë miratimit të kredive banesore si dhe të atyre që ndikojnë mbi kreditë për konsum. Në faqen zyrtare të BPRM mundet të gjendet informata më të detajuara mbi aktivitetin kreditues.

Shikuar nga aspekti i strukturës së maturimit dhe strukturës valutore në rritjes vjetore të realizuar, në vitin 2015 vërehet një kontribut më i shprehur i kreditimit afatgjatë të ndërmarrjeve si dhe të sektorit "popullsi" në rritjen e përgjithshme, në kushte të prirjeve paralele për huazim në denarë.


Grafik 53
Struktura valutore dhe sektoriale e kredisë së përgjithshme



Burimi: BPRM.

Paralelisht me rritjen solide kreditore dhe lëvizjet e volitshme në aspekt të strukturës së maturimit dhe strukturës valutore, karakteristike për vitin 2015 ishte edhe përmirësimi i vogël i cilësisë së portfolios kreditore, që vërehet edhe përmes rritjes së ngadalësuar të kredive jofunksionale. Kështu pjesëmarrja e kërkesave të dyshimta dhe të kontestueshme në stokun e kredive, mesatarisht është 11.3% që paraqet një zvogëlim të butë në krahasim me vitin 2014 dhe vitin 2013 kur ajo ishte 11.5% respektivisht 11.7%.

Grafik 54
Kërkesa të dyshimta dhe të kontestueshme sipas sektorëve



Burimi: BPRM.

IV. Ambienti makroekonomik dhe politika monetare më 2016 dhe 2017³⁹

Në përputhshmëri me dispozitat ligjore, politika monetare e BPRM në periudhën në vazhdim do të orientohet kah ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si qëllim themelor monetar. Njëkohësisht, BPRM edhe më tej do të kontribuojë në ruajtjen e sektorit stabil dhe konkurrues bankar dhe do ta vazhdojë politikën e përgjithshme ekonomike pa mos rrezikuar qëllimin primar. Nga aspekti i strategjisë monetare, BPRM edhe më tej do të vazhdojë me zbatimin e strategjisë së targetimit të kursit stabil nominal devizor të denarit kundrejt euros. Roli i kursit devizor si spirancë nominale del nga karakteristikat e ekonomisë së brendshme, si një ekonomi e vogël por e hapur, mjaft e varur nga importi i prodhimeve primare. Në kushte të këtilla rritet rëndësia e kursit devizor në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe pritjeve stabile të inflacionit të subjekteve ekonomike. Korniza operative e politikës monetare, si deri më tani, do të vendoset mbi baza fleksibile dhe do të mundësojë udhëheqje efikase me likuiditetin e sistemit bankar dhe ruajtjen e baraspeshës në tregun devizor. Me këtë, politika monetare edhe më tej do të kontribuojë për stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik, si faktor kyç në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për rritje të qëndrueshme ekonomike.

Sipas projeksioneve të BPRM, nga tetori i vitit 2015, pritet që realizimi i politikës monetare në vitin 2016 dhe 2017 të zhvillohet në një ambient relativisht të qëndrueshëm, por me prezencë të mëtejme të rreziqeve të brendshme e të jashtme. Projektionet e fundit të BPRM nga tetori i vitit 2015 parashohin që ekonomia edhe më tej do të shënojë rritje të shpejtë, para së gjithash nën ndikimin e eksportit dhe investimeve, ndërkohë që efekt pozitiv pritet edhe nga shpenzimet private. Sektori bankar edhe më tej do ta mbështeste rritjen ekonomike përmes aktivitetit të zmadhuar kreditor. Pritet që gjendja në sektorin e jashtëm të jetë e përshtatshme edhe në dy vitet e ardhshme, edhe përkaj vlerësimeve për zgjerim të moderuar të deficitit aktual në përputhje me forcimin e aktivitetit ekonomik. Drejtimi i projektuar i rezervave devizore edhe më tej çon kah ruajtja e indikatorëve të përshtatshmërisë së tyre në zonën e sigurisë. Inflacioni do të jetë i moderuar dhe do të lëvizë brenda kornizave të kontrolluara, duke arritur në 1.6% mesatarisht. Në rast të pritjeve për kushte të volitshme ekonomike, BPRM në periudhën e ardhshme kryesisht do të orientohet drejt përcjelljes së realizimit të drejtimit të projektuar të rezervave devizore dhe ngjarjeve në tregun e devizave, si dhe përcjelljen e të gjitha rreziqeve aktuale dhe në bazë të kësaj, do ta përshtatë edhe politikën e saj monetare.

Realizimi i kornizës së projektuar makroekonomike përcillet me rreziqe të cilat dalin nga rrethanat e jashtme po edhe të brendshme. Me këtë rast, rreziqet të cilat mund të kaplojnë ekonominë e brendshme përmes kanaleve të ndryshme, janë kryesisht të lidhura me dinamikën e përmirësimit të rritjes globale ekonomike, si dhe lëvizjet e çmimeve të produkteve primare në bursave në botë. Kjo posaçërisht ka të bëjë me euro-zonën, si partner më i madh i yni tregtar, ku rimëkëmbja ekonomike është relativisht e dobët dhe çon kah zgjatja e kësaj rimëkëmbjeje. Ngadalësimi i rritjes së ekonomisë së Kinës dhe jo-stabiliteti i tregjeve financiare paraqesin gjithashtu faktorë plotësues të rrezikut që e rrisin pasigurinë në këtë rajon. Sa u përket rreziqeve të brendshme, ato kryesisht burojnë nga ambienti i paqëndrueshëm politik, efektet ekonomike të të cilit ishin relativisht të kufizuar, megjithëse rreziku i efekteve të shtyra për periudhën e ardhshme po ashtu ekziston – kjo për shkak të përmbajtjes më të madhe eventuale edhe të subjekteve të brendshme po edhe të atyre të huaja. Realizimi eventual i rreziqeve të përmendura do të thoshte edhe ndërrim të ambientit për realizimin e politikës monetare, në krahasim me pritshmëritë themelore.

³⁹ Në bazë të projeksioneve të BPRM nga tetori i vitit 2015

Në periudhën e ardhshme pritet rritje graduale e inflacionit, e cila sipas projeksioneve të tetorit do të lëvizte ndërmjet 1.5% për vitin 2016 deri në 1.6% për vitin 2017. Rritja e çmimeve në vitin 2016 është në pajtim me lëvizjet e çmimeve të importit, në kushte të përforsimit të pritit të inflacionit të partnerët tregtarë, ndërsa nga gjysma e dytë e vitit 2016 priten shtypje më të mëdha edhe të prodhimet ushqimore dhe energjetike, sipas pritjeve për rritje të çmimit botëror të naftës dhe grurit. Rreziqet e lidhura me lëvizjen e inflacionit për vitin 2016 kanë të bëjnë me ndryshueshmërinë e çmimeve të produkteve primare botërore dhe pasigurinë me lëvizjet e tyre të mëtejshme. Në vitin 2017 pritet stabilizim i inflacionit nën kushte të rimëkëmbjes së mëtejshme të kërkesës së brendshme, rritjes së inflacionit të jashtëm efektiv dhe rritjes minimale të çmimeve të importit të ushqimit dhe energjisë. Projektioni i inflacionit përcillet me rreziqe, të cilat janë kryesisht të lidhura me lëvizjet e çmimeve botërore të prodhimeve primare. Nga aspekti i faktorëve të brendshëm, rreziqet lidhur me këto projeksione kryesisht lidhen me ndryshueshmërinë e kushteve klimatike në periudhën në vijim.

Pritet që trendet e volitshme ekonomike, të cilat ishin karakteristike për vitin 2015 të vazhdojnë edhe gjatë periudhës së ardhshme dyvjeçare, me përsheptim gradual të shkallës së rritjes ekonomike. Në fakt, kontribut më të madh për rritjen ekonomike pritet të japë eksporti dhe investimet, ndërsa efekt pozitiv pritet edhe nga shpenzimet individuale (private). Pritet që shfrytëzimi gjithnjë e më i madh i kapaciteteve ekzistuese të orientuara drejt eksportit dhe supozimet e hyrjes së investimeve të reja në këtë sektor, në kombinim me rimëkëmbjen e pritit të kërkesave nga jashtë, të mbështesin rritjen e eksportit. Aktiviteti i rritur eksportues dhe paralajmërimet për investime në kapacitete të reja, bashkë me nxitjen fiskale në infrastrukturë, do të kontribuojnë në ngritjen e investimeve në dy vitet e ardhshme. Pritet të këto lëvizje të kenë efekt pozitiv edhe ndaj tregut të punës, që nënkupton rritje të kërkesës nga amvisëritë. Përkrahje shtesë të kërkesës së brendshme pritet të vijë edhe nga aktivitetet kreditore. Në kësi kushtesh, rritja e BPB në vitin 2016 do të ishte 3.5%, ndërsa në vitin 2017 do të përsheptohej akoma duke arritur në 4%. Duke marrë parasysh hapjen e madhe të ekonomisë, rreziqet ndaj rritjes së projektuar edhe më tej vijnë nga mjedisi global dhe zhvillimet të botën e jashtme.

Në kushte të likuiditetit solid dhe solvencës (aftësisë pague) së bankave, pritet që rimëkëmbja ekonomike, ambienti më stabil, rritja e potencialit depozitues të bankave, si dhe masat tashmë të ndërmarra nga ana e autoriteteve monetare, do të kontribuojnë për mbështetje më të madhe financiare të ekonomisë së brendshme përmes sektorit bankar. Rritja e kreditove të përgjithshme në vitin 2016 është projektuar në 7.3%, ndërsa deri në fund të vitit 2017 pritet një rritje e përsheptuar kreditore, që do të arrinte deri në 8.3%. Kjo rritje e projektuar kreditore i shpalos faktorët edhe nga ana e kërkesës po edhe nga ajo e ofertës. Në fakt, realizimet pozitive dhe pritjet për vazhdimin e trendeve të volitshme në tregun e punës, si dhe rritja e projektuar solide e aktivitetit investues do të kontribuojnë në kërkesën stabile të kredive në dy vitet e ardhshme. Sa i takon ofertës, edhe më tej pritet mbështetje nga rritja e bazës depozituese dhe nga analizat stabile të rrezikut nga bankat. Në dy vitet e ardhshme, në kushte të rritjes së mëtejme të ekonomisë dhe stabilizimit të pritjeve, pritet një rritje më e fuqishme e depozitave. Rreziqet në rënie rreth projekcionit të rritjes kreditore dhe depozituese ekzistojnë akoma. Rimëkëmbja më e dobët eventuale e ekonomisë nga ajo që pritet, si dhe vazhdimësia e pasigurisë rreth faktorëve të brendshëm të rrezikut, mund të sjellin përmbajtje më të madhe për kursim, t'i kufizojnë burimet e financimit të bankave, t'i përkeqësojnë analizat mbi rrezikun dhe ta zvogëlojnë gatishmërinë e sektorit privat për huamarrje.

Projeksionet për 2016 dhe 2017 tregojnë një pozicion të jashtëm i cili do të sigurojë ruajtje të mëtejshme të rezervave devizore në nivel adekuat. Pritet që deficitin në llogarinë rrjedhëse të zgjerohet dhe të arrijë në 1.9% nga BPB në 2016 dhe 2.4% nga BPB në 2017. Këto vlerësime bazohen mbi supozimet që deficitin i rritur tregtar do të krijohet kryesisht nga importi i mëtejshëm i lëndëve të para të kapaciteteve të reja, si dhe nga importi investues. Një pjesë e

mirë e këtij deficiti edhe më tej do të financohet nga të hyrat dytësore, për të cilat pritet të qëndrojnë në nivele relativisht të larta. Pritet që thellimi plotësues i deficitit të llogarisë rrjedhëse në 2017 të paraqitet si rezultat i zvogëlimit të mëtejshëm konstant të suficitit të të hyrave sekondare dhe rritjes së deficitit të të hyrave primare. Përkundër kësaj, pritet ngushtim i bilancit të mallrave dhe shërbimeve, në kushte të përmirësimit të ambientit global dhe efekteve të mëtejshme të pritura të volitshme nga kapacitetet e orientuara kah eksporti. Sa i takon financimit, pritet që edhe në periudhën në vijim, pjesa më e madhe e financimit të llogarisë rrjedhëse të sigurohet nga investimet direkte të huaja dhe huamarrjet afatgjata të sektorit publik nga jashtë. Te investimet direkte, pritet rritje graduale e butë deri më 2.8% të BPB në 2016 dhe 3% të BPB në 2017. Në aspekt të rezervave devizore, në dy vitet e ardhshme pritet që transaksionet në bilancin e pagesave të nxisin rritje shtesë të rezervave devizore dhe ruajtje të mëtejshme të indikatorëve të përshtatshmërisë së rezervave devizore në zonën e sigurisë. Rreziqet kryesore lidhur me pozitën e jashtme të ekonomisë në këtë periudhë edhe më tej dalin nga dinamika e rimëkëmbjes globale dhe lëvizjet e çmimeve botërore, e me këtë edhe të rritjes së brendshme ekonomike dhe reflektimin e tyre ndaj analizave të investitorëve.

Në dy vitet e ardhshme pritet një politikë e kujdesshme fiskale, me konsolidim gradual të deficitit buxhetor dhe nivel relativisht stabil të borxhit publik.⁴⁰ Politika fiskale është faktor i rëndësishëm i cili ndikon ndaj pozicionimit të politikës monetare, ndërsa koordinimi adekuat i këtyre politikave është faktor kyç për arritjen e qëndrueshmërisë së pozicionit të jashtëm të vendit dhe ruajtjes së stabilitetit makroekonomik. Në periudhën në vijim, pritet ngushtim gradual i deficitit buxhetor. Investimet publike mbeten edhe më tej caqe primare të politikës fiskale. Në fakt, për periudhën në vijim është paraparë realizimi i projekteve kapitale investuese në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, në infrastrukturën lokale dhe sektorin energjetik, në bujqësi, etj. Parashihet që financimi i deficitit të sigurohet nga burime të brendshme dhe të jashtme. Me këtë rast, në kuadër të burimeve të brendshme, është paraparë edhe shfrytëzimi i një pjese të depozitave të akumuluar të shtetit në BPRM, si dhe lëshim i letrave me vlerë. Korniza fiskale e vendosur në këtë mënyrë parashihet të moderuar të borxhit shtetëror në periudhën vijuese, i cili nuk do ta kërcënojë qëndrueshmërinë e financave publike. Politika e vendosur fiskale përcillet me rreziqe, të cilat, ashtu si dhe te politika monetare, burojnë kryesisht nga kushtet e jashtme dhe ndikimi i tyre në aktivitetin e brendshëm ekonomik, si dhe mundësia për të pasur qasje te tregjet e huaja financiare.

BPRM i përcjell rregullisht dhe me kujdes lëvizjet aktuale dhe rreziqet ekzistuese dhe në bazë të kësaj edhe e vlerëson pozicionimin e politikës monetare, duke qenë në gatishmëri për ndërmarrjen e masave adekuate dhe aktiviteteve tjera në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe çmimor të ekonomisë.

⁴⁰ Projektionet në pjesën e politikës fiskale bazohen në propozim-buxhetin për vitin 2016 dhe Strategjinë fiskale të RM për periudhën 2015-2017. Në këtë rast, në pajtim me përfshirjen e supozimit për huamarrje përmes euro-obligacioneve në vitin 2015, janë bërë ndryshime të caktuara në strukturën e financimit të deficitit buxhetor për vitin 2016 me atë që supozohet shfrytëzimi i depozitave shtetërore për mbulimin e nevojave buxhetore, në llogari të huamarrjes më të vogël të jashtme krahasuar me propozim-buxhetin.

V. Instrumentet monetare

Ambienti në të cilin realizohej politika monetare në vitin 2015 u shënua me sfida të shumta të rrethanave të jashtme dhe skenë të jo-stabile politike të brendshme, që solli pasiguri të mëdha në pjesën më të madhe të vitit. Këto rrethana imponuan nevojën për ndryshime gjegjëse në instrumentet monetare nga ana e BPRM, të cilat kishin të bëjnë kryesisht me administrimin efikas të likuiditetit të sektori bankar, mbështetje të mëtejshme të aktivitetit kreditor dhe përforcim i stabilitetit të bazës depozitore të bankave. Kështu, gjatë vitit u bënë ndryshime në mekanizmin për përpilimin e ofertave nga bankat në ankandet e bonove të thesarit, si dhe në vendosjen e instrumentit të rezervës së obligueshme. Këto ndryshime kishin të bëjnë me ruajtjen e trendit të de-euroizimit dhe stimulimin e kursimeve afatgjata të amvisërive me valutën vendore, në kushte kur lëvizjet në sektorin bankar çonin kah përmbajtja e popullatës për shkak të ambientit të pasigurt. Me ndryshimet u mundësua që bankat, përmes harxhimeve më të ulëta, të zhvillojnë produkte të reja depozituese të cilat mundësojnë stabilitet më të madh të bazës depozituese. Pak kohë pas sjelljes së këtyre masave (në gusht 2015), gjatë çerekut të katërt u konstatuan edhe efektet e para pozitive nga to, me ç'rast u vërejt rritje e konsiderueshme e kursimeve afatgjata në denarë të amvisëritë. Në mungesë të presionit të inflacionit dhe presionit ndaj kursit devizor, norma themelore e interesit e bonove të thesarit u ruajt e pandryshuar, në nivel historikisht më të ulët prej 3.25%, me çka BPRM vazhdoi me realizimin e politikës së normave të ulëta të interesit dhe mbështetje të aktivitetit kreditor. Edhe përkundër sfidave, në vitin 2015 u ruajt stabiliteti makroekonomik, ndërsa efektet negative nga tronditjet e brendshme dhe të jashtme u neutralizuan, që flet për një reagim adekuat dhe vendosje të instrumenteve monetare.


5.1. Bonot e thesarit

Në vitin 2015, në mungesë të presionit të inflacionit dhe presionit ndaj kursit devizor, BPRM edhe më tej aplikon politikë monetare akomoduese për shkak të ruajtjes së normave të ulëta të interesit në ekonomi, e me këtë edhe mbështetje më të fortë kreditore për sektorin privat. Norma e interesit e instrumentit themelor u ruajt në nivelin historikisht më të ulët prej 3.25%,⁴¹ ndërsa shuma e ofruar në ankande përmes zbatimit të tenderëve me shuma⁴² është e pandryshuar, respektivisht arrin në 25,500 milionë denarë. Megjithatë, në rast të shfaqjes së rreziqeve të caktuara dhe nevojës për minimizimin tyre, mekanizmi i formimit të ofertave nga bankat në ankandet e bonove të thesarit gjatë vitit u ndryshua dy herë.

⁴¹ Ndryshimi i fundit i norms së interesit të bonove të thesarit u realizua në korrik të vitit 2013.


⁴² Në ankandet e bonove të thesarit, të cilat mbahen në ditën e parë të periudhës së rezervës së detyrueshme (Vendimi i bonove të thesarit, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 166/13) u zbatua tenderi i shumave (shumë e kufizuar e ofertës dhe normë fikse interesi).

Grafik 55
Gjendja e bonove të thesarit dhe norma e interesit



Burimi: BPRM.

Grafik 56
Likuiditeti i sistemit bankar dhe raporti i ofertës dhe kërkesës për bonot e thesarit



Ndryshimi i parë i mënyrës së krijimit të ofertave të bankave në ankandet e bonove të thesarit ndodhi në mars 2015. Kjo ishte e kushtëzuar nga nevoja për të ndaluar trendin e kërkesës së tepërt në ankande nga ana e bankave, dhe atë mbi potencialin e tyre të likuiditetit, por edhe të stimulohet rritja e bazës depozituese të bankave. Në fakt, ofertat e bankave filluan të verifikohen sipas *përfaqësimit të tyre procentual në rezervën e detyruar në denarë*⁴³. Ndryshimi i mënyrës së krijimit të ofertave të bankave në ankandet e bonove të thesarit mundësoi sjelljen e kërkesës në nivel të shumës së ofruar. Në kushte të trendit të ngadalësuar të kursimit në valutën vendore, mekanizmi i krijimit të ofertave të bankave në ankandet e bonove të thesarit u rishqyrtua në gusht të vitit 2015. Kështu, me qëllim të ndikohet në motivimin e bankave për të tërhequr depozite në valutën e vendit, shpërndarja e shumës së ofruar në ankande sipas bankave lidhej me *pjesëmarrjen adekuate, të cilën secila bankë e ka në detyrimet e përgjithshme në valutën e vendit pa klauzolë valutore në nivel sistemi*. Këto ndryshime ishin shtojcë e masave të cilat njëkohësisht u vendosën në sistemin e rezervës së detyruar, për shkak të mbështetjes së procesit të de-euroizimit dhe stimulimit të kursimit afatgjatë në denarë në ekonomi. Deri në fund të vitit, kërkesa për bono të thesarit u mbajt në nivel relativisht stabil (mesatarisht 25.246 milionë denarë⁴⁴).

Raporti 1. Vështrim mbi rrjedhat e krijimit dhe tërheqjes së likuiditetit në vitin 2015


Në vitin 2015, faktorët autonomë kontribuan në rënien e likuiditetit të sistemit bankar për 5.608 milionë denarë, me kontribut më të madh në paratë e gatshme në qarkullim (prej 3.868 milionë denarë)⁴⁵. Në fakt, për rritjen e parave të gatshme në qarkullim më tepër kanë kontribuar të hyrat më të larta të disponueshme të amvisërive, që ishte rezultat i rritjes së pensioneve, rrogave dhe subvencioneve në bujqësi.

⁴³ Rezerva e obligueshme në denarë vërtetohet me zbatimin e normave për detyrime të ndryshme denarike në bilancin e bankave, me ç'rast përfshihet edhe një pjesë (30%) e sasisë së fituar nga detyrimet e vërtetuara devizore sipas normave të cilat aplikohen për rezervën e obligueshme devizore.


⁴⁴ Niveli më i ulët mesatar i bonove të thesarit në raport me ofertën e vërtetuar në mënyrë fikse sqarohet me kërkesën më të vogël në një bankë, e cila një pjesë të mjeteve të nevojshme likuiduese i sugron përmes këtij instrumenti.

⁴⁵ Për tërheqjen e likuiditetit nga sistemi bankar kontribuan edhe transaksionet në shtet (me 1.528 milionë denarë) dhe transaksionet devizore të BPRM me bankat mbështetëse të shitjes neto të devizave (për 2.119 milionë denarë). Në anën tjetër, për rritje të likuiditetit kontribuan vetëm faktorët tjerë autonomë, me efekt prej 1.908 milionë denarësh.

Grafik 57
Ndryshimi i faktorëve autonomë dhe ndikimi i tyre ndaj likuiditetit



Grafik 58
Ndryshimi i instrumenteve monetare**



* OAF nënkupton faktorë të tjerë autonomë (FTA).

** Ndryshimi pozitiv nënkupton zvogëlim të mjeteve likuiduese në një instrument të caktuar dhe rritje e likuiditetit në sistemin bankar dhe anasjelltas.

Burimi: BPRM.

Likuiditeti shënoi rritje më të theksuar në dy muajt e parë të vitit, ndërsa në pjesën e mbetur të vitit faktorët autonomë shkaktuan zvogëlim të likuiditetit. Në kushte të këtilla, bankat e zvogëluan sasinë e instrumenteve monetare për 1.660 milionë denarë, kryesisht te depozitat e plasura të disponueshme në BPRM (për 1.235 milionë denarë).

5.2. Depozitat dhe kreditë e disponueshme⁴⁶ në BPRM

Në vitin 2015, me rastin e administrimit me likuiditetin, bankat në mënyrë aktive i shfrytëzonin depozitat e disponueshme të BPRM⁴⁷. Në fillim të vitit, në kushte të pozicionit të forcuar të likuiditetit, bankat shfaqnin tendencë të plasimit të mjeteve likuiduese tepriçë në depozita të disponueshme.

Bankat më së shumti i shfrytëzonin depozitat e disponueshme për shtatë ditë, të cilat shënonin rritje të vazhdueshme, ndërsa kah mesi i shkurtit 2015, arritën nivelin më të lartë që nga miratimi, dhe atë me 23.085 milionë denarë. Kjo rritje ishte e lidhur me mënyrën e paraqitjes në ankand të bonove të thesarit, e zbatuar nga marsi i vitit 2015, kur bankat kishin për detyrë të ndajnë mjete në depozita të disponueshme me afat prej shtatë ditësh, pa kompensim, po që se e rrisnin kërkesën përtej likuiditetit të tyre të disponueshëm.


Qëndrueshmëria afatgjatë e nivelit të lartë të mjeteve në këtë instrument të bankat e caktuara, si dhe trendi rritës në nivel të sistemit, ishin sinjal për zvogëlimin e normave të interesit në këtë instrument. Kështu, BPRM në mars e zvogëloi normën e interesit të depozitave për shtatë ditë nga 1.0% në 0.5%, dhe të atyre brenda natës nga 0.5% në 0.25%. Përmes këtij hapi, u pa që funksioni themelor i depozitave të disponueshme është plasimi i tepriçave afatshkurta të mjeteve likuiduese të bankave, dhe jo ruajtja e tyre afatgjatë në llogaritë e bankës qendrore. Në mënyrë plotësuese, me futjen e mënyrës së re të krijimit të ofertave nga bankat në ankandet e bonove të thesarit, nga marsi i vitit 2015 u

⁴⁶ Në vitin 2015, në rast të ruajtjes së likuiditetit në nivel relativisht të lartë, bankat shfrytëzonin kredi të disponueshme brenda natës. Norma e interesit në këtë instrument në vitin 2015 mbeti në nivel të pandryshuar prej 3.75%.

⁴⁷ Plasimi i mjeteve likuiduese në depozita të disponueshme te BPRM është iniciativë e bankave. Depozitat e disponueshme brenda natës u jepen në shfrytëzim bankave për çdo ditë, ndërsa mundësi për të plasuar mjete likuiduese në depozita me afat prej shtatë ditësh bankat kanë çdo të mërkurë.


ndërpre detyrimi për ndarje të depozitave shtatë-ditore në fillim të periudhës së rezervës së obligueshme. Efekti i kombinuar i ndryshimeve të normave të interesit, mënyra e ankandimit të bonove të thesarit, ndikimi i faktorëve autonomë në zvogëlimin e tepricës së mjeteve likuiduese, si dhe rritja relativisht stabile kreditore deri në fund të vitit, kontribuan në ndryshimin e dinamikës së shfrytëzimit të depozitave shtatë-ditore në shumën e mjeteve të plasura në këtë instrument, në nivel të 8.016 milionë denarëve.

Grafik 59
Gjendja e depozitave të disponueshme



Burimi: BPRM

Grafik 60
Normat e interesit të BPRM



Në rast të administrimit me tepriçën e likuiditetit në bazë ditore, bankat i shfrytëzonin depozitat e disponueshme brenda natës. Në aspekt të dinamikës, në vitin 2015 nuk u vërejtën ndryshime më të mëdha të ky instrument, të cilin bankat edhe më tej e shfrytëzojnë më fortë kah fundi i periudhave të rezervës së obligueshme.

5.3. Rezerva e obligueshme


Gjatë vitit 2015, ashtu si dhe në vitet paraprake, instrumenti i rezervës së obligueshme përdorej edhe për arritjen e qëllimeve të caktuara makro-prudente. Kështu, përveç funksionit themelor, administrimi i ofertës së parave dhe stabilizimi i normave afatshkurta të interesit në tregun e parave, ndryshimet në rezervën e obligueshme në vitin 2015, kishin për qëllim minimizimin e rreziqeve të caktuara të bilancet e bankave. Në fakt, ndryshimet ishin të orientuara drejt mbështetjes së mëtejshme të procesit të denarizimit, respektivisht, stimulimit të kursimit afatgjatë në valutën vendore dhe kreditim më të madh në sektorin korporativ.

Pasiguria si pasojë e ndodhive në skenën politike vendore, duke i shtuar kësaj edhe eskalimin e krizës greke, u reflektuan negativisht mbi pritjet e subjekteve ekonomike. Rritja vjetore e depozitave u ngadalësua, ndërsa ndikimi më i theksuar negativ u vërejt te kursimet me valutën vendore. Në kësi rrethanash, në gusht të vitit 2015, BPRM e uli normën e rezervës së obligueshme për detyrimet e bankave ndaj personave fizikë në valutën vendore me afat të dakorduar mbi një vit, nga 8% në 0%. Me këtë ndryshim, u zgjerua zbatimi i normave prej 0%, për herë të parë të vendosura në vitin 2012, me qëllim të ndërtimit të një baze stabile depozitore, para së gjithash në valutën vendore.

Efektet e para të volitshme nga masat e reja u panë në tetor të 2015 me stabilizimin e lëvizjes së depozitave denarike, posaçërisht për afatet mbi një vit, ndërkohë që në mënyrë plotësuese u përforcua edhe rritja vjetore e detyrimeve të përgjithshme të sistemit bankar,


pjesëmarrja e të cilit në obligacionet e përgjithshme⁴⁸ të bankave në fund të 2015 arritën në 55.7%.

Grafik 61
Norma të rezervës së obligueshme sipas detyrimeve




Burimi: BPRM.

Grafik 62
Norma vjetore e rritjes së detyrimeve të bankave




Zbatimi i normave të përmendura prej 0% mundësoi çlirimin e mjeteve likuiduese në sistemin bankar në sasi prej 1.371 milionë denarësh dhe të orientohen drejt mbështetjes së rritjes kreditore. Gjithashtu, BPRM edhe më tej e zbaton edhe masën jo-standardë⁴⁹, të orientuar kah kreditimi i rritur i sektorëve të rëndësishëm sistemorë për ekonominë e vendit – neto-eksportuesit dhe prodhuesit e energjisë elektrike. Kjo masë nxiti vendosjen e kushteve të volitshme nga ana e bankave për kompanitë e këtyre dy sektorëve, përmes zbatimit të normave më të ulëta të interesit dhe harxhimeve për provizion, lehtësimeve të sigurimit, qasje më të madhe dhe krijim të produkteve të ri kreditorë. Edhe në vitin 2015, pjesa më e madhe e rritjes së këtyre kredive, prej 2.740 milionë denarësh ose çereku i rritjes së përgjithshme vjetore të kredive të miratuara në sektorin korporativ, u orientuan kah neto-eksportuesit. Në gjysmën e dytë të vitit, përforcim i caktuar u vërejt edhe te kreditë e miratuara për prodhuesit e energjisë elektrike. Duke marrë parasysh përfitimet pozitive të kësaj mase të kreditimit të sektorit privat, BPRM kah fundi i vitit 2015 e vazhdoi vlefshmërinë e saj deri në fund të vitit 2017.

Grafik 63
Kreditë e sapo-miratuara për sektorët e targetuar



Burimi: BPRM.

Grafik 64
Rezerva e ulur e obligueshme nga masat



⁴⁸ Analiza e trendeve të detyrimeve të bankave është bërë mbi bazën e të dhënave për detyrimet e bankave të përfshira në bazën për përlogaritjen e rezervës së obligueshme.


⁴⁹ Masa mundëson zvogëlim të bazës së rezervës së obligueshme të bankave për vlerën e kredive të sapo-miratuara dhe investimeve në letra me vlerë në formë borxhi në valutën vendore pa klauzolë valutore të lëshuara nga neto-eksportuesit dhe prodhuesit e brendshëm të energjisë elektrike. Kjo masë u vendos kah fundi i vitit 2012 dhe filloi të aplikohet nga viti 2013.

Zvogëlimi i rezervës së obligueshme nga masat e ndërmarra në tërësi e tejkaloi kontributin e rritjes së detyrimeve në konstatimin e rezervës së obligueshme në denarë, ashtu që situata në këtë instrument shënoi ulje në bazë vjetore për 225 milionë denarësh dhe ishte 17.297 milionë denarë. Rezerva e obligueshme në euro në kundërvlerë ishte 13.262 milionë denarë dhe në bazë vjetore ishte më e lartë për 638 milionë denarë, që kryesisht sqarohet me rritjen e moderuar të detyrimeve devizore të bankave.

Nga këndvështrimi i dinamikës së plotësimit të rezervës së obligueshme, në vitin 2015 bankat përsëri e zbatuan të a.q. strategji të tepricës së mjeteve likuiduese, që dallon nga viti 2014, kur për shkak të rritjes së bonove të blera të thesarit, u zvogëlua likuiditeti dhe u zbatua e a.q. strategji e mungesës së mjeteve likuiduese.⁵⁰ Kontribut më të madh drejt këtyre ndryshimeve pati zbatimi i mënyrës së e të formimit të ofertave të bankave në ankandet e bonove të thesarit, respektivisht ndërprerja e detyrimit për pasimin e mjeteve në depozite shtatë-ditore në fillim të periudhës së rezervës së obligueshme. Zbatimi i strategjive të ndryshme për menaxhim me likuiditetin ishte goxha efikas, ndërkohë që teprica mesatare e mjeteve likuiduese përmbi rezervën e obligueshme në vitin 2015 edhe më tej mbetet në nivel të ulët.

Grafik 65


Teprica mesatare e likuiditetit në ditën e fundit të periudhës së rezervës së obligueshme



Burimi: BPRM.

Grafik 66

Dinamika e plotësimit të rezervës së obligueshme



5.4. Repo-operacione për krijimin e likuiditetit në sistemin bankar

Në vitin 2015, BPRM realizoi ankande të rregullta javore për repo-transaksione, me qëllim të sigurimit të mbështetjes afatshkurtër likuiduese të bankave.⁵¹ Megjithatë, në kushte të tepricës së likuiditetit, bankat nuk kishin interes për të përdorur këtë instrument. Oferta ishte 517 milionë denarë, mesatarisht, ndërsa bankat kishin kërkesë vetëm në dy ankande, në të cilat u miratuan mjete likuiduese në shumë prej 1.400 milionë denarësh.

5.5. Kredia e instancës së fundit

Në vitin 2015, BPRM e revidoi kornizën për kredinë e instancës së fundit, në pajtim me praktikat më të zhvilluara të vendosjes së këtij instrumenti. Kështu, për shkak të rritjes së fleksibilitetit dhe sigurisë së bankave për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm në kushte krize, u mundësua, me rastin e përdorimit të këtij instrumenti, bankat, përveç garancisë së

⁵⁰ Në rast të mungesës së mjeteve likuiduese (backloading) të plotësimit të rezervës së obligueshme, bankat e fillojnë periudhën e plotësimit me nivel më të ulët të mjeteve likuiduese në raport me rezervën e obligueshme, ndërsa deri në fund të periudhës i rrisin mjetet likuiduese. Përkundër kësaj, në rast të strategjisë së tepricës së mjeteve likuiduese (frontloading), bankat e fillojnë periudhën me tepricë mbi rezervën e obligueshme, ndërsa plotësimi mesatar deri në fund të periudhës shënon trend rënës.

⁵¹ Ankandet për sigurim të likuiditetit në shtatë ditë realizohen njëherë në javë, respektivisht çdo të premte.

letrave me vlerë në formë borxhi, devizash dhe kërkesash nga BPRM, të shfrytëzojnë edhe garanci kërkesë nga klientët. Në vitin 2015, duke marrë parasysh pozitën solide të likuiditetit, bankat nuk e shfrytëzuan këtë instrument.


Raporti 2. Zhvillimet në tregun e parave⁵²

Ndryshimet rregullative të lidhura me ankandet e bonove të thesarit kishin ndikim të konsiderueshëm ndaj aktivitetit të bankave në tregjet e parave në vitin 2015 në kuptim të segmentit, vëllimit dhe afatit të transaksioneve. Zvogëlimi i normave të interesit të depozitave të disponueshme u reflektua në mënyrë gjegjëse ndaj normave tregtare të interesit, të cilat shënuan lëvizje të moderuara teposhtë.

Në vitin 2015 vëllimi i aktivitetit tregtar në tregjet e parave në RM u zvogëlua në bazë vjetore për 38%. Rënia vjetore kryesisht sqarohet me tregtimin më të ulët në tregun ndër-bankar të depozitave të pasiguruara me afat brenda natës, për dalim nga viti i kaluar, kur në kushte të zbatimit të të a.q. depozita shtatë-ditore "të obligueshme", bankat fuqishëm tregonin në këtë segment tregtar. Norma e interesit МКДОНИА në vitin 2015 ishte 0.99% mesatarisht dhe ishte për 0.8 p.p. më e ulët në bazë vjetore, aq sa është edhe rënia mesatare e normave të listuara të interesit СКИБОР përgjatë tërë lakores së kontributeve.

Grafik 67


Qarkullimi i tregut të parave



Burimi: BPRM

Grafik 68

Qarkullimi i depozitave të pasiguruara



Në anën tjetër, tregtimi sekondar me letra me vlerë shënoi rritje që kryesisht kishte të bëjë me tregtimin e shtuar me bono thesari në pjesën e dytë të vitit, në kushte të zbatimit të mënyrës së re të ankandimit. Njëherit, diversifikimi i strukturës pronësore dhe vazhdimi i afatit mesatar të letrave shtetërore me vlerë kontribuoi në rritjen e tregtimit me këto letra me vlerë për rreth 42%. Bankat siguruan një pjesë të vogël të likuiditetit të nevojshëm edhe ne repo-tregun.

⁵² Tregu u parave në Maqedoni i përfshin këto segmente: tregun e depozitave të pasiguruara, tregun sekondar të letrave afatshkurta dhe afatgjata me vlerë, dhe tregun e depozitave të siguruara (repo-tregun).

VI. Menaxhimi dhe investimi i rezervave valutore

Menaxhimi i rezervave valutore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: rezervave valutore) është funksion shumë i rëndësishëm i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë. Ajo zbatohet në përputhje me qëllimet themelore: mbrojtja e burimeve, garantimin e sigurisë së plasmanëve dhe investimeve, sigurimin e likuiditetit për qëllime të ruajtjes së stabilitetit të kursit të këmbimit dhe kryerje të papenguar të pagesave jashta shtetit, dhe më në fund, sigurimin e kthimit të investimeve, me ç'rast rritet vlera e tyre.

Investimi i rezervave valutore në vitin 2015 u përball me sfidat e ruajtjes së vlerës dhe krijimin e të ardhurave nga mjetet e investuara. Gjegjesisht, gjatë vitit 2015, Banka Qendrore Evropiane ka vazhduar me rritjen e likuiditetit të tregjeve financiare për të stimuluar aktivitetin ekonomik, gjë e cila solli një rënie të mëtejshme të të ardhurave të instrumenteve më të sigurta financiare, dhe në disa vende rendimentet hynë edhe në zonën negative deri në afate të mesme. Në rrethana të tilla, korniza për investime u zgjerua me mundësi të tjera për investime të cilat akoma siguronin kthime pozitive dhe rrezik të ulët të kreditit. Gjithashtu, në kufijtë e paraparë për administrimin e rrezikut të normës së interesit, u zgjeruan investimet në maturitetet më të gjata nga lakorja e të ardhurave për investimet në euro. Në të njëjtën kohë vazhdoi strategjia e investimeve për rritje të moderuar në ekspozimin e rezervave valutore ndaj valutave me perspektiva për rendimente më të larta relative dhe vlera intervalutare kundrejt euros. Për këtë qëllim, në pritje të normalizimit të kushteve monetare në SHBA, u rritën investimet në instrumentet financiare të shprehura në dollarë amerikanë. Investimet në valuta të tjera janë ndjekur në mënyrë aktive dhe janë testuar për nga aspekti i pritjeve për lëvizjen e vlerave dhe të ardhurave të tyre relative, të cilat çuan në braktisjen e investimeve në korona norvegjeze në fund të vitit, duke rritur investimet në paund britanikë. Shkalla e përgjithshme e kthimit të rezervave valutore në vitin 2015 arriti në 0.74% në nivel vjetor.

6.1. Ndryshimet në kornizën për menaxhimin me rezerva valutore

Gjatë menaxhimit me rezervat valutore, Banka Popullore e RM aplikon një qasje parandaluese duke monitoruar objektivat kryesore të investimeve, edhe atë: të sigurisë, likuiditetit dhe profitabilitetit. Arritja e objektiveve të shumta, në kushte të politikave divergjente monetare të bankave qendrore me ndikim më të madh në botë, lëvizja jo stabile e tregjeve ndërkombëtare financiare, të hyra të ulëta ose negative dhe lëvizjet e ndryshueshme të çifteve valutore, është një sfidë e madhe që nga kriza e këndeje, kështu që paraqitet nevoja për rishikim të vazhdueshëm të strategjive për investim.

Në vitin 2015, sfida më e madhe ka qenë portofoli i investimeve në euro, si pjesë më e rëndësishme e rezervave të huaja, i cili është në funksion të strategjisë së aplikuar monetare në targetimin e kursit ditorë të denarit. Lëvizjet negative në tregjet në Eurozonë shkaktuan rishikim dhe ndryshim të strategjisë së investimit dhe kornizës për menaxhimin e rrezikut, në fakt pranim të moderuar të ndryshime më të larta të çmimeve dhe të monedhës të vlerës së instrumenteve financiare për shkak të ecurisë pozitive të investimeve. Si pasojë:

- U rishikua pjekuria maksimale sipas llojeve të letrave me vlerë, si dhe vlerësimi minimal kreditor i instrumenteve;
- U rishikuan shtetet në të cilat mund të investohen rezervat valutore dhe u zmadhuan nivelet e lejueshme të ekspozimit maksimal për disa vende në eurozonë, ndërsa në

- mënyrë plotësuese u mundësua investim në letra me vlerë - bonot euro, të lëshuara nga vendet e Bashkimit Evropian;
- U zgjerua gama e instrumenteve investuese në dollarë amerikanë, duke futur letra borxhi të emetuar nga agjencitë amerikane me një mbështetje të pritshme të shtetit. Gjithashtu, në portofolin e investimeve të drejtuar në kuadër të programit RAMP (shih Shtojcën 3) u siguroa investim në letra borxhi me një normë të ndryshueshme të interesit dhe letra borxhi të indeksuara me normën e inflacionit;
 - Kohëzgjatja themelore në portofolin e investimeve në euro në mënyrë taktike përshtatej gjatë vitit, me ç'rast u krijua hapësirë për investime me rezultate pozitive në pjesën më të gjatë të kurbës së rendimenteve;
 - Rregullisht janë monitoruar aktivitetet e bankave qendrore dhe reagimet e tregut, me ç'rast janë hapur pozita të gjata aktive tek valutat ku ka pasur pritje për rendimente më të larta. Nga ana tjetër, në kushte të tendencës në rënie të çmimeve të derivateve, është rishqyrtuar arsyeshmëria e investimeve në valutat që varen nga këto lëvizje të tregut.

Shtojca 3. Aktivitete të lidhura me promovimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e rezervave valutore

Një nga detyrat themelore ligjore të përcaktuara të Bankës Popullore është menaxhimi me rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë. Ky funksion është jashtëzakonisht i përgjegjshëm duke pasur parasysh se bëhet fjalë për mjete kombëtare të cilat, përveç qëllimeve të caktuara për funksionimin normal të ekonomisë, luajnë rol në garantimin e sigurisë financiare të brezave të ardhshëm. Procesi i zbatimit të saj në Bankën Popullore kërkon ngritjen e një sistemi të mirë të menaxhimit. Për këtë qëllim, BPRM në mes të vitit 2014 ka filluar bashkëpunimin me Bankën Botërore në kuadër të programit për menaxhim me rezervat valutore RAMP (Reserves Advisory and Management Program), e cila është e specializuar në ofrimin e asistencës teknike dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e menaxhimit dhe investimit të rezervave valutore.

Në periudhën e kaluar janë realizuar tri misione pune nga ana e ekspertëve nga Banka Botërore. Në gusht të vitit 2014, me ekspertët janë shqyrtuar bazat e alokimit strategjik të rezervave valutore dhe mundësitë për përmirësim në fazën fillestare dhe ndoshta më të rëndësishme të procesit të investimit. Gjithashtu, janë shqyrtuar mundësitë për zbatimin e menaxhimit aktiv dhe marrja e pozicioneve për përmirësimin e performancës nga mjetet valutore të investuara. Në fund të vitit 2014 u mbajt takimi i dytë i punës, ku ekspertët e Bankës Botërore i shqyrtuan mundësitë për ushtrimin e praktikave më të mira në fushën e kontabilitetit, si dhe në fushën e mbështetjes ligjore të investimit. Në mes të 2015, fokusi i diskutimeve në kuadër të takimit të tretë të punës me ekspertët e Bankës Botërore ka qenë në fushën e operacioneve në prapavijë dhe mënyrat për të rritur fleksibilitetin në këtë segment. Përveç kësaj, BPRM në shtator 2015 ishte nikoqir, organizator i seminarit ndërkombëtar me temë në fushën e kryerjes së aktiviteteve sfond në procesin e menaxhimit me rezervat valutore.

Një pjesë e madhe e njohurive të fituara gjatë takimeve të punës me ekspertët e Bankës Botërore kanë filluar të aplikohen në kuadër të zbatimit operacional të procesit të menaxhimit të rezervave valutore. Kështu, në fillim është bërë rishikimi dhe përmirësimi i kornizës ligjore për zbatimin e këtij procesi, si dhe avancimi i procesit të alokimit strategjik. Në fund të vitit 2015 është miratuar një politikë e re për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore në përputhje me të cilën u vendos një definicion më i gjerë dhe më i qartë i rolit themelor të rezervave valutore, u vendosën drejtimet për përcaktimin e strukturës kryesore së valutës, ndërsa risi e rëndësishme ishte vendosja e kriterit të vetëm për rejtingun kreditor më të ulët të lejuar dhe përkufizimi i tolerancës për rreziqet e tregut. Gjithashtu, u miratuan rregulla të reja për menaxhimin dhe investimin e rezervave valutore, ku u vendosën kahjet e dhëna nga politika, dhe u sollën drejtimet strategjike për menaxhimin e rezervave valutore për vitin 2016. Në përgatitjen e udhëzimeve të reja të investimeve, është zbatuar modeli i alokimit të fondeve Vorkbench, i cili është zhvilluar nga Banka Botërore.

Aktivitetet në fushën e përmirësimit të procesit të menaxhimit të rezervave valutore vazhdojnë në lidhje me zbatimin e menaxhimit të portofolit aktiv. Për këtë qëllim, është paraparë operacionalizim i modelit për monitorimin e rrezikut të pozitive aktive. Në këtë pjesë, është planifikuar që të vazhdohet me trajnimet e filluara të të punësuarve në njësitë organizative të përfshira në menaxhimin e rezervave valutore. Gjatë periudhës së bashkëpunimit të BPRM me Bankën Botërore, rreth 30 punonjës, të përfshirë në këtë proces, patën mundësinë që të marrin pjesë në seminare të organizuara nga Banka Botërore. Kjo mundëson avancimin më të gjerë të njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale në BPRM, që është kyçe për mbajtjen e një niveli të lartë të efikasitetit, profesionalizmit dhe cilësisë së burimeve njerëzore të angazhuara në menaxhimin e rezervave valutore.

6.2. Kushtet për investim në tregjet ndërkombëtare financiare

Në kushtet e zbatimit të politikës ekspansive monetare nga Banka Qendrore Evropiane (në tekstin e mëtejshëm: BQE), investitorët në tregjet financiare në eurozonë u përqendruan në instrumente të sigurisë së lartë. Zgjerimi i mëtejshëm i programit të BQE-së për lehtësim sasior përmes blerjes⁵³ së letrave me vlerë nga bilancet e pjesëmarrësve të tregut ka shkaktuar një rënie të të ardhurave të obligacioneve qeveritare në rekorde të reja më të ulëta (në disa vende dhe nivele negative deri në pjesën e mesme të kurbës së interesit), ndërsa dallimi në mes të të hyrave në ekonominë periferike dhe thelbit të eurozonës u ngushtua⁵⁴.

Presionet e ulëta të çmimeve dhe rritja e dobët ekonomike në eurozonë i forcuan pritjet e pjesëmarrësve të tregut se BQE do të marrë masa monetare shtesë për stimulim monetar⁵⁵, gjë e cila ka kontribuar në mbajtjen e një niveli të ulët të rendimenteve deri në fund të vitit.

Nga ana tjetër, pjesëmarrësit në tregut ishin në pritje të normalizimit të mëtejshëm të politikës së bankës qendrore amerikane - FED, për shkak të performancës së favorshme të ekonomisë amerikane. Megjithatë, FED, në gjysmën e parë të vitit nuk morri hapin e parë për të rritur normat e interesit për shkak të luhatshmërisë në tregjet financiare globale, të ndikuar nga lëvizjet e trazuara në tregjet në Kinë⁵⁶ dhe në shtetet në zhvillim. Në kushte të zhvillimeve të favorshme në ekonominë amerikane dhe stabilizimit të tregjeve financiare, në takimin në dhjetor FED i përmbushi pritjet e tregut dhe vendosi të rrisë normën e interesit të synuar me 25 pikë bazë në 0.25% -0,50%. Divergjencia e mëtejshme e politikave të FED dhe BQE-së gjatë vitit solli një zgjerim të mëtejshëm të diferencave midis rendimenteve të obligacioneve qeveritare amerikane dhe evropiane. Kjo lëvizje ishte më e theksuar tek letrat me vlerë afatshkurta, të cilat zakonisht janë të ndikuara nga politika monetare.


⁵³ Në mars 2015 u parapa blerja e letrave me vlerë të shprehura në euro me rejting të investimeve të lëshuara nga qeveritë qendrore të vendeve anëtare të eurozonës, agjencitë dhe institucionet evropiane, ku letrat me vlerë janë me afat maturimi duke filluar nga 2 deri 30 vjeç, si plotësim i programit për blerjen e obligacioneve të mbuluara / kolateralizuara (Covered Bond Purchase Programme 3) dhe programit për blerjen e letrave me vlerë të siguruara (Asset-Backed Securities Purchase Programme).

⁵⁴ Këto lëvizje të tregjet në eurozonë kanë mbetur, pavarësisht shqetësimeve për Greqinë, sidomos me ardhjen në pushtet të partisë së majtë SYRIZA, e cila kishte qëndrime të kundërta në lidhje me kalimin e kërkesave nga kreditorët ndërkombëtarë. Pas disa muajsh bllokimi në bisedime, Greqia në korrik arriti një marrëveshje me kreditorët, e cila është mbështetur me nënshkrimin e një plani të tretë për ndihme financiare.


⁵⁵ Në dhjetor, BQE uli normën e interesit të depozitave me 10 pikë bazë në një nivel prej -0.30% dhe vazhdoi zbatimin e programit të lehtësimit sasior për gjashtë muaj, deri në fund të marsit 2017.

⁵⁶ Turbullira të mëdha në tregjet shkaktoi zhvlerësimi i papritur i juanit kinez nga banka qendrore e Kinës në mes të gushtit. Tek investitorët, kjo tregoi për performancë të dobët të ekonomisë kineze, e cila ka ngjallur shqetësime rreth efekteve globale.

Grafik 69
Rendimentet e obligacioneve qeveritare (%)




Grafik 70
Diferenca midis rendimenteve të obligacioneve në eurozonë (në p.p.)




Gjasat për shtrëngimin e politikës së FED, kundrejt politikave më liberale të bankave të tjera qendrore në nivel global⁵⁷, kontribuuan në vlerësimin e dollarit amerikan kundrejt disa valutave, sidomos kundrejt euros. Edhe Funta britanike ka pasur një rritje në vlerë kundrejt euros gjatë vitit 2015, në kushte të performancës solide ekonomike. Vlera e valutave të lidhura me prodhimet e mallrave të tilla si dollari kanadez dhe Kruna norvegjeze, u zvogëlua, kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të naftës dhe qëndrimit të lirë të politikës monetare në këto vende. Dollari Australian gjithashtu pati rënie në vlerë, për shkak të çmimit më të ulët të mineralit të hekurit dhe perspektivës së paqartë për të ardhmen e ekonomisë kineze si partneri më i rëndësishëm tregtar i Australisë.

Grafik 71
Lëvizja e kurseve të këmbimit kundrejt euros
31.12.2012 = 100 (indeksi)



Burimi: BQE dhe kalkulimet e BPRM.

Grafik 72
Çmimet e naftës dhe arit



Për vitin 2015 ishte e veçantë edhe rënia e çmimeve të derivateve, sidomos të energjisë⁵⁸, gjë e cila solli uljen e pritjeve nga inflacioni. Çmimi i arit nuk kishte rënie të dukshme si nafta, por edhe më tej ka një prirje rënëse, si në dy vitet e mëparshme, duke

⁵⁷ Banka e Japonisë e ka ruajtur sasinë e konsiderueshme të blerjes së letrave me vlerë. Banka Qendrore e Zvicrës në fillim të vitit 2015 e zvogëloi normën tashmë negative të interesit dhe e lëshoi kufirin e sipërm të kursit të këmbimit të monedhës vendase ndaj euros (1.20 franga për euro), e cila shkaktoi rënie të vlerës së euros ndaj valutës Zvicerane. Qëndrim të relaksuar të politikës monetare kishin edhe bankat qendrore të Australisë, Kanadasë dhe Suedisë, të cilat në dy ose tri raste e zvogëluan normën bazë të interesit.

⁵⁸ Në këtë kontekst, vazhdoi rënia e çmimeve të naftës që filluan në gjysmën e dytë të vitit të kaluar duke rënë nga 55.8 dollarë / fuçi në 31.12.2014, në 35.8 dollarë amerikanë / fuçi të 31.12.2015 vit. Rënia e çmimit të naftës është për shkak të niveleve gjithnjë e më të larta të ofertës, në kohë të kërkesës relativisht të qëndrueshme. Vendet anëtare të OPEC-ut gjatë vitit nuk vendosën për të reduktuar prodhimin e këtij karburanti dhe secili nga ata u përpoq të ruajë pjesën e tregut.


lëvizur në mënyrë të ndryshueshme. Në aspektin e vlerësimit të dollarit amerikan dhe mungesën e presioneve të çmimeve, në fund të vitit 2015 çmimi i arit ishte 1.062,3 dollarë amerikan, që është deri 11.4% më pak në krahasim me vitin e kaluar. Gjatë vitit, kërkesa për ari nga bankat qendrore ishte në nivel të lartë, për shkak të nevojës për diversifikimin e rezervave valutore në kushte të rreziqeve ekonomike dhe gjeopolitike. Për më tepër, Bankat qendrore në bazë neto kanë blerë 588.4 ton, përafërsisht sa kanë blerë gjatë vitit të kaluar (583.9 ton)⁵⁹.

6.3. Investimi në rezerva valutore të huaja

6.3.1. Ekspozimi kreditor


Siguria e investimeve të rezervave valutore ka rëndësi të madhe në përcaktimin e strategjisë të investimeve të BPRM. Në përputhje me kornizën e planifikuar të investimeve, pjesa më e madhe e rezervave valutore, ose mesatarisht 71.3% janë investuar në instrumente financiare me nota më të larta për vlerësimin e kredive (nga AAA deri në AA-), d.m.th. me ekspozim më të ulët ndaj rrezikut të kredisë. Megjithatë, kjo veçori e investimeve imponon mundësi të kufizuara për balancimin e parimit të ruajtjes së vlerës në kushtet e rendimenteve të ulëta dhe negative. Për këtë arsye, një pjesë e investimeve të rezervave të huaja janë drejtuar edhe në instrumente me vlerësim kreditor nga A + në A-, të cilat gjithashtu paraqesin një nivel të lartë të sigurisë ndërsa mundësojnë një kthim të moderuar pozitiv të mjeteve. Një pjesë e vogël e investimeve të rezervave valutore ishin edhe në instrumentet financiare me vlerësim kreditor investues, gjë që kryesisht kishte të bëjë për instrumente me afat të mbetur maturimi më të shkurtër se një vit.

Grafik 73
Struktura e investimeve sipas vlerësimit kreditor, mesatare vjetore



* në kategorinë „e mbetur” janë të klasifikuara ММФ, БИС.
Burimi: BPRM.

Grafik 74
Struktura gjeografike e investimeve në fund të vitit



* me shkurtesën MFI/MPБ janë shënuar institucionet financiare ndërkombëtare dhe bankat zhvillimore.

Në aspekt të shpërndarjes gjeografike të investimeve, BPRM zbaton parimin e diversifikimit sipas vendeve, ku investimet lëvizin në pajtim me kufizimet sasiore të vendosura.⁶⁰ Sipas kësaj, mesatarisht rreth 42.8% e investimeve gjatë vitit janë shpërndarë në instrumentet financiare nga vendet nga bërthama e eurozonës - Gjermania, Franca dhe Holanda, ndërsa një pjesë janë drejtuar kah vendet e tjera të eurozonës, si dhe vende të

⁵⁹ World Gold Council, Shkurt 2016.

⁶⁰ Në përcaktimin e fushëveprimit dhe kufizimeve sasiore për investime sipas vendeve, përveç vlerësimit kreditor të lartë afatgjatë të dhënë nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit, merret në konsideratë edhe vlerësimin i brendshëm i kreditit.


Bashkimit Evropian. Rritje të konsiderueshme kishin investimet në instrumente financiare nga emetues amerikan, nga 8% në fund të vitit 2014, në 22% në vitin 2015, në pajtueshmëri me pozicionimin taktik aktiv drejt këtij tregu, në pritje të lëvizjes së të ardhurave dhe ndryshimeve ndër-valutore përpjetë në të ardhmen.

6.3.2. Likuiditeti i rezervave valutore

Likuiditeti operativ i rezervave valutore për të kryer transaksione në tregun e këmbimit valutor dhe për realizimin në kohë të detyrimeve jashtë vendit u sigurua përmes mbajtjes së portofolit të likuiditetit në euro dhe dollarë amerikan, të vendosur në aktive likuide afatshkurtra, llogaritë rrjedhëse, por edhe në bono thesari likuide, me afat maturimi deri në 1 vit. Mjetet në kuadër të këtij portofoli gjatë viti 2015 përbënin rreth 13.4% të totalit të rezervave valutore.


Pjesa më e rëndësishme e rezervave valutore janë investuar në kuadër të portofolit të investimeve (EUR, USD dhe valuta të tjera), të cilat në vitin 2015 përbënin 76.5% të rezervave valutore, mesatarisht. Në kuadër të këtyre portofoleve, investimet kryesisht fokusohen në letra me vlerë dhe një pjesë tjetër është vendosur në depozita në bankat e huaja komerciale⁶¹. Duke pasur parasysh se letrat me vlerë janë të përfaqësuara edhe në portofolin e investimeve dhe likuiditetit, këto instrumente financiare, me një pjesëmarrje mesatare prej 78.4%, janë më të përfaqësuara në strukturën e rezervave valutore sipas instrumenteve.

Grafik 75
Struktura e investimeve sipas instrumenteve mesatare në vjet



Burimi: BPRM.

Grafik 76
Struktura e letrave me vlerë sipas llojeve në fund të muajit



Pjesën më të madhe të letrave me vlerë, ose rreth 69.1% gjatë vitit 2015, e përbëjnë letrat me vlerë të qeverisë me likuiditet të lartë dhe letrat me vlerë me garanci shtetërore, e cila lejon përfaqsimin optimal të parimit të vendosjeve të likuiditetit me parimin e sigurisë. Pjesë të konsiderueshme (10.5%) kishin edhe investimet në instrumente të lëshuara nga institucionet financiare ndërkombëtare⁶², të cilat pavarësisht nivelit të lartë të sigurisë, mundësojnë rendimente më të larta në krahasim me letrat me vlerë të qeverisë. Në të njëjtën kohë, janë rritur investimet edhe në letra me vlerë me një mbështetje të prishme të shtetit, të cilat arritën në 12.3%. Një pjesë e arsyeshme e investimeve ishte drejtuar në letra me vlerë të emetuara nga qeveritë rajonale të Gjermanisë, Australisë dhe Kanadasë, me një pjesëmarrje mesatare prej 6.5% në letra me vlerë dhe në letra me vlerë të siguruara me borxhin publik.

⁶¹ Investimet në depozita në kuadër të portofolit të investimeve janë të kufizuar me afat maturimi deri në gjashtë muaj.

⁶² Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Banka Evropiane e Investimeve (EIB), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), Banka Nordike e Investimeve (NIB)

Përveç realizimit të rregullt nga investimet në letra me vlerë, në vitin 2015 BPRM vazhdon t'i shfrytëzojë transaksionet e huazimit të letrave me vlerë, si një mënyrë shtesë për të siguruar një nivel të caktuar të të ardhurave. Ata arrihen me anë të përmbylljes së njëkohshme të transaksioneve repo dhe repo të kundërta, me bankat e huaja tregtare, me të cilat BPRM ka lidhur kontrata standarde.

]]Në kuadër të strukturës së rezervave valutore, pjesa e arit ka shënuar një rritje të moderuar në vitin 2015. Kështu, në kushtet e paqëndrueshmërisë në tregjet ndërkombëtare dhe zvogëlim të çmimeve të metaleve të çmuara, kjo zhvendosje në pjesëmarrje është rezultat i zvogëlimit të sasisë së rezervave valutore⁶³, gjatë sasisë së pandryshuar të arit. Ari, i cili zakonisht është një instrument financiar me një të ardhura më të ulëta në treg, gjatë vitit ishte vendosur në depozita afatshkurtra tek bankat e huaja komerciale të klasit të parë.


6.3.3. Struktura valutore⁶⁴

Shpërndarja sipas valutës është realizuar me respektimin e duhur të përcaktimit themelor strategjik për strukturën valutore të rezervave valutore, me funksion kryesor për dispozicionin e fondeve për të mbështetur strategjinë monetare të targetimit të kursit të këmbimit. Rrjedhimisht, fondet e investuara në instrumente financiare të shprehura në euro janë të përfaqësuara kryesisht në kuadër të rezervave valutore, me një pjesëmarrje mesatare prej rreth 57.9%. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar, përqindja e këtyre investimeve ka rënë me 16,3 p.p., për shkak të rritjes së investimeve në instrumente financiare të shprehura në dollarë amerikanë. Këto ndryshime në strukturën e valutore janë pjesë e strategjisë taktike të investimit për të rritur ekspozimin ndaj dollarit amerikan, si valutë me perspektivë për rendimente më të larta në të ardhmen. Ky pozicion aktiv investues mundëson respektim të principeve të sigurisë dhe likuiditetit, duke pasur parasysh se valuta amerikane është një monedhë globale në të cilën mbahen rezervat ndërkombëtare në nivel botëror, ndërsa çifti valutore euro/dollar amerikan është më i tregtuari në tregjet globale valutore.


⁶³ Gjatë vitit 2015, rezervat valutore janë ulur për 174.8 milionë euro. Reduktimi i rezervave valutore është kryesisht për shkak të shpenzimeve neto për pagesën e detyrimeve shtetërore jashtë vendit, në vlerë prej 205,2 milionë euro (të dalat kryesore ishte gjatë shlyerjes së parakohshme të detyrimeve ndaj FMN-së gjatë gjysmës së parë të vitit, si dhe për shkak të Eurobondit të arritur në dhjetor, të cilat janë kompensuar pjesërisht nga të ardhurat e reja, emetimit të katërt të euro-obligacioneve). Gjithashtu, edhe intervenimet në tregun valutore kanë kontribuar në rënien e rezervave valutore, duke arritur në 34.2 milionë euro. Nga ana tjetër, vlera e tregut të rezervave valutore u rrit me rreth 45.5 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së dollarit amerikan. Rritje të vlerës së rezervave valutore kishte edhe për shkak të të ardhurave nga investimet e mjeteve.

⁶⁴ Struktura valutore është analizuar në aspektin e rezervave valutore të reduktuara nga sasia e arit.

Grafik 77
Struktura valutore e rezervave valutore
Në fund të muajit



Mesatare vjetore




Burimi: BPRM.

Gjatë vitit 2015, përqindja mesatare vjetore e valutave të tjera ka qenë 9.8% dhe në krahasim me vitin e kaluar ka shënuar një rënie të moderuar. Kjo është për shkak të shqyrtimit dhe braktisjes së investimeve në Krunën norvegjeze në fund të vitit, në pritje të zhvlerësimit të mëtejshëm të kësaj valute dhe rendimenteve të pafavorshme.

6.3.4. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit dhe rezultatet nga investimi i rezervave valutore


Vendosja dhe investimi i rezervave valutore ishte kryesisht në letra me vlerë të cilat sjellin të ardhura nga interesi dhe kuponat, por të cilat janë të ekspozuar edhe ndaj ndryshimeve në çmimet e tyre në treg, respektivisht në rendimentet rrjedhëse. Ky ekspozim ndaj rrezikut të normës së interesit kontrollohet përmes caktimit të një kohëzgjatje bazë të modifikuar dhe ruajtjen e letrave me vlerë deri në maturim⁶⁵. Kështu, në kushte të pritjes për ruajtjen rendimenteve të ulëta mbi letrat me vlerë dhe rënien e tyre të mëtejshme, në portofolin e investimeve në euro ishte vendosur kohëzgjatje primare e modifikuar relativisht më e gjatë. Për më tepër, për shkak të përshtatjes fleksibile në kushtet e tregut gjatë vitit, vazhdimisht rivlerësohej kohëzgjatja e modifikuar në një nivel taktik.

Grafik 78
Kohëzgjatja bazike e modifikuar e portofolit investues (në muaj)



Burimi: BPRM.

Grafik 79
Kthim të portofolit investues të indeksuar me portofol të referencës



⁶⁵ Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim në euro dhe në dollarë amerikanë janë një e treta e investimeve në letra me vlerë. Në fund të vitit, maturiteti i mbetur i letrave me vlerë në euro arriti në rreth 7.8 muaj, ndërsa portofoli në dollarë amerikanë arriti në rreth 8.6 muaj.

Nga ana tjetër, në pritje të normalizimit e kushteve monetare në SHBA, mjetet brenda portofolit të investimeve në valutë janë me një kohëzgjatje relativisht të shkurtër të modifikuar prej rreth një viti. Tek portofolet tjera investuese janë përcaktuar udhëzimet për mbajtjen e kohëzgjatjeve të modifikuara në varësi të nivelit aktual të rendimenteve dhe lëvizjet e pritura në të ardhmen.

Me pozicionimin e instrumenteve financiare, në përputhje me kornizën e caktuar nga kohëzgjatja bazike e modifikuar e portofoleve të investimeve, u mundësua realizimi i të ardhurave në kuadër të të ardhurave nga tregu. Realizimi në portofolin e investimeve në euro ka qenë mesatarisht më e ulët në krahasim me kthimin e investimeve të treguesve referues të tregut⁶⁶, duke pasur parasysh se kontributi pozitiv ndaj kthimit të investimeve në letra me vlerë të qeverisë pjesërisht ishte neutralizuar me rendiment negativ nga investimet në letrat me vlerë të qeverisë të lëshuara në një monedhë të ndryshme nga ajo kombëtare (bonot euro). Në portofolin e investimeve në dollarë amerikanë, realizimi ishte mesatarisht më i lartë në krahasim me kthimin e indekseve referuese të tregut për shkak të performancave të përmirësuara të instrumenteve financiare të investuara në kuadër të portofolit të investimeve, kryesisht të letrave me vlerë të agjencisë dhe të letrave me vlerë të lëshuara nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Në lidhje me shpërndarjen e rezervave valutore në valuta të tjera, edhe këtë vit konfirmohet arsyeshmëria nga ky vendim investues, me ç'rast kthimi i investimeve në valutën origjinale është nga 0.5% në 2.19%. Shkalla e përgjithshme e kthimit të rezervave valutore në vitin 2015, e cila krahas të ardhurave të realizuara i përfshin edhe ndryshimet e kalkuluar të çmimit dhe të kursit të këmbimit, arriti në 0.74% në vit.

⁶⁶ Indeksin referues të çmimeve të letrave me vlerë dhe indeksi i tregut të parasë, i përbërë nga instrumente reale financiare, me kohëzgjatje të modifikuar që korrespondon me kohëzgjatjen primare të portofolit të investimeve. Para fillimit të vitit 2015, BPRM e rishikoi përbërjen e instrumenteve në portofolet referuese, me vendosjen e shtrirjes së tyre vetëm në letra me vlerë shtetërore. Kjo është bërë në përputhje me diskutimet dhe rekomandimet e ekspertëve të Bankës Botërore, për të adresuar më mirë rezultatet dhe rreziqet e menaxhimit aktiv.

VII. Aktivitetet dhe trendet në sistemet pagesore

Në vitin 2015, vlera e përgjithshme e qarkullimeve pagesore ka pasur rritje, ngjashëm si rritja e PBB, në kushte të rritjes së qarkullimit përmes Sistemit pagesor interbankar të Maqedonisë (MIPS) dhe Sistemit të kliringut interbankar (KIBS). Tek instrumentet pagesore, vlera e transfereve kreditore janë rritur në nivel vjetor, në kushte të rritjes më të theksuar të transfereve kreditore elektronike. Normat e larta të rritjes vjetore janë vërejtur edhe në numrin dhe vlerën e transaksioneve me kartela pagesore. Njëkohësisht, era e re e pagesave digjitale në Republikën e Maqedonisë vërehet përmes shfrytëzimit më të madhe të Internetit dhe telefonave celular (pagesa që kanë rritje dyshifrore), kurse në vitin 2015, për së pari herë, edhe në shfrytëzimin e pajisjeve për kryerje të pavarur të pagesave. Këta trende janë dëshmi se përparimi i teknologjisë në fushën e pagesave në botë në mënyrë të përsheptuar bartet edhe në qarkullimet pagesore të vendit përmes ofrimit të zgjidhjeve tekniko-teknologjike për kryerjen e pagesave, dhe me këtë edhe në qasjen në shërbimet pagesore tek personat fizik dhe juridik.


Edhe gjatë vitit 2015, BPRM vazhdoi me traditën e pasurimit me djjeni dhe shkëmbimin e përvojave me ekspertë të sektorit financiar, përmes mbajtjes së konferencës së rregullt ndërkombëtare për sistemet pagesore dhe sistemet për balancimin e letrave me vlerë, si dhe punëtorive në fushën e mbikëqyrjes së sistemeve pagesore, statistika pagesore dhe instrumentet për financimin e tregtisë ndërkombëtare. Këto ngjarje edukative kanë dhënë kontribut në përpunimin e akteve të reja nënligjore në domenin e mbikëqyrjes së sistemeve pagesore dhe statistikës pagesore, që kanë për qëllim harmonizimin e ligjeve kombëtare me ligjet e Unionit Evropian.

7.1. Sistemet pagesore

Në vitin 2015, vlera e përgjithshme e qarkullimit pagesor ka qenë 5,206 miliardë denarë (duke realizuar rritje vjetore prej 6.0%), prej të cilës pjesa më e madhe (65%) është realizuar përmes MIPS.⁶⁷ Numri i përgjithshëm i transaksioneve të kryera në vitin 2015 ka qenë 65.7 milionë transaksione, gjatë së cilës pjesa më e madhe (56%) janë kryer përmes sistemeve pagesore interne të bankave. Në MIPS janë përpunuar mesatarisht 20.642 transaksione në ditë, derisa numri maksimal i transaksioneve të përpunuara në ditë ka arritur numrin 66.318. Në vitin 2015, vlera mesatare për transaksion në MIPS ka pasur rritje vjetore prej 10.1% dhe ishte 670.868 denarë.

⁶⁷ Në vitin 2015, MIPS punonte në kohë reale me qasje 100% të kohës. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë në MIPS në fund të vitit 2015 ka qenë njëzet e dy: BPRM, katërbëmbëdhjetë banka komerciale, Banka e Maqedonisë për mbështetje të zhvillimit SHA Shkup, Ministria e financave të Republikës së Maqedonisë, Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë, Sistemi i kliringut ndërbankar SHA Shkup, Depozitesi qendror për letra me vlerë SHA Shkup, Sistemi ndërkombëtar i kartelave – KASIS dhe Masterkard internacional.

Grafik 80
Gjithsej qarkullim pagesor sipas sistemeve




Burimi: BPRM.

Në vitin 2015, shpërndarja e numrit të dergesave pagesore të kryera përmes MIPS sipas pragjeve të definuara të vlerës së mesazhit individual, tregon se pjesëmarrje më të madhe (23.5%) kanë mesazhet pagesore me vlerë prej 1.000 deri 5.000 denarë, gjegjësisht afër 95% të numrit të përgjithshëm të dergesave pagesore janë me vlerë më të vogël se 1 milionë denarë. Shpërndarja e vlerës së dergesave pagesore të kryera përmes MIPS, tregon se pjesëmarrje më të madhe (55.5%) kanë mesazhet pagesore me vlerë më të madhe se 500 milionë denarë, përderisa mesazhet pagesore me vlerë mbi 1 milionë denarë marrin pjesë me 96% në qarkullimin e përgjithshëm të kryer përmes MIPS.

Shpërndarja ditore e transaksioneve përmes MIPS tregon se pjesa më e madhe e transaksioneve (22.9%) balancohen midis orës 14 dhe 15, derisa rreth 85% e transaksioneve barazohen midis orës 11 dhe 16. Nga aspekti i vlerës së transaksioneve, vlera më e madhe e transaksioneve (me vlerë mesatare të transaksionit prej 5.6 milionë denarë) barazohen midis orës 9 dhe 10 (29.9% prej vlerës së përgjithshme të transaksioneve gjatë një dite), derisa vlerë më e vogël e transaksioneve barazohet (3.2%) midis orës 8 dhe 9 (me vlerë mesatare e një transaksioni prej 0.9 milionë denarë).

Grafik 81
Treguesit e shpërndarjes së dergesave pagesore dhe transaksioneve në MIPS⁶⁸



Burimi: BPRM.


⁶⁸ Dergesa pagesore është formë elektronike e instrumenteve pagesore që mund të përmbajë më tepër transaksione individuale (p.sh., urdhëresë për transfer ПП32 që mundëson në barë të një urdhëruesi të transferohen mjete tek më tepër pranues).

7.2. Instrumentet pagesore

Zgjidhjet moderne tekniko-teknologjike në domenin e pagesave dhe përdorimit të medimeve dhe pajisjeve të sofistikuar për kryerje të pagesave kishin efekte pozitive edhe në zhvillimin e qarkullimit pagesor në vend. Kështu, një risi e rëndësishme në vitin 2015 tek transferet kreditore është themelimi i sistemit për pagesë të shpejtë, si teknologji inovative që mundëson pagesë në para të gatshme përmes terminalit për shërbime të ndryshme (pagesa e faturave për ujë, taksës radiodifuzive, televizionit kablovik, telefonisë celulare, sigurimit, etj.). Përveç pagesave në para të gatshme, ky sistem mundëson edhe pagesa në para jo të gatshme përmes kuletës elektronike të klientit, përmes telefonit celular, nga ana e shfrytëzuesit të shërbimit. Tek transferet kreditore, vazhdoi trendi i rritjes së lartë vjetore të numrit dhe vlerës së transfereve kreditore nga ana e personave juridik dhe fizik (51% dhe 77%, gjegjësisht). Tek pagesat me kartela, normat e larta të rritjes vjetore tek numri (34%) dhe vlera (61%) e transaksioneve të kryera përmes Internetit e shënuan vitin.

Në vitin 2015, vazhdon prezenca e lartë e transfereve kreditore në kuadër të pagesave në para jo të gatshme (95.7%). Gjatë kësaj, si rezultat i zgjidhjeve tekniko-teknologjike për pagesa në para jo të gatshme, është shënuar pjesëmarrje e rritur në transferet kreditore elektronike në pagesat e përgjithshme me para jo të gatshme (34.6%) ose rritje e pjesëmarrjes prej 1.8 p.p. në krahasim me vitin 2014. Vlera e përgjithshme e transfereve kreditore shënoi rritje vjetore prej 4.3%, me pjesëmarrje më të madhe të transfereve kreditore elektronike (3.6 p.p.), që tregon ndryshim në sjelljet për kryerje të pagesave të personave fizik dhe juridik, më saktësisht, përdorim gjithnjë e më i shpeshtë i përfitimeve të shërbimeve elektronike të bankave. Edhe përkaj pjesëmarrjes më të lartë të urdhëresave më letër për kryerjen e transfereve kreditore (72% në numër dhe 64% në vlerën e transfereve kreditore), vlera e transfereve kreditore elektronike ka shënuar rritje të lartë vjetore prej 10.6%, derisa numri i transfereve kreditore elektronike shënon rritje vjetore më të butë prej 5.9%.

Grafik 82
Treguesit e instrumenteve pagesore




Burimi: BPRM.

Në domenin e punës me kartela, edhe përkaj pjesëmarrjes së konsiderueshme të tërheqjes së parave të gatshme në rritjen e vlerës së transaksioneve me kartela pagesore në vitin 2015, përsëri vazhdon tendenca e rritjes së pagesave jo në para të gatshme në vendet e shitjes në tregti. Në vitin 2015 vlera e transaksioneve për pagesë në vendet e shitjes në tregti është rritur për 18.5% në nivel vjetor, në kushte të rritjes vjetore të tërheqjes të parave të gatshme prej 11.6%, që tregon një ndryshim në kulturën pagesore të personave juridik dhe fizik për shfrytëzim më masiv të kartelave pagesore në vendet e shitjes, dhe me

këtë edhe ulje në shfrytëzimin e parave të gatshme. Në numrin e përgjithshëm të transaksioneve me kartela pagesore në vitin 2015 vërehet rritje vjetore e përsheptuar prej 23.2%, në të cilën kontribut më të madh ka rritja e pagesave në tregti (16.4 p.p.). Trendet pozitive në shfrytëzimin e kartelave vërehen edhe përmes rritjes së numrit të përgjithshëm të kartelave të emetuara në qarkullim në territorin e Republikës së Maqedonisë, që ka shënuar rritje vjetore prej 4.3% dhe në fund të vitit 2015 ishte 1.670.765. Njëkohësisht, zgjerohet edhe infrastruktura për shfrytëzimin e kartelave pagesore si rezultat i rritjes së numrit të pajisjeve që pranojnë kartela pagesore në tregti dhe rritja e numrit të shitësve që pranojnë kartela pagesore (të dy kategoritë shënuan rritje vjetore prej afër 4%).

Gradiku 83


Treguesit e punës me kartela



Burimi: BPRM.

Numri i përgjithshëm i llogarive të hapura tek personat fizik dhe juridik në vitin 2015 ka pasur rritje prej 2.6%, në kushte të kontributit të vazhdueshëm të lartë të numrit të llogarive të hapura nga personat fizik (2.4 p.p.), i ndjekur nga rritja adekuate e numrit të deponuesve persona fizik. Digjitalizimi i pagesave tërheq rritje të zmadhuar të llogarive që mundësojnë pagesa përmes Internetit (17.0%), edhe pse pjesëmarrja e tyre është ende e ulët në numrin e përgjithshëm të llogarive të hapura (3.8%). Në vitin 2015 vazhdon trendi rënës i llogarive të bllokuara (14.8%) dhe deponuesve të bllokuar (18.4%), me kontribut të lartë nga personat fizik me 13.3 p.p. në numrin e llogarive të bllokuara dhe 16.1 p.p. në numrin e deponuesve të bllokuar. Gjatë kësaj, në tre vitet e kaluara, rritja e llogarive të bllokuara tek personat juridik është ngadalësuar ndjeshëm (3.8%, mesatarisht, në krahasim me 31% mesatarisht për periudhën 2009-2012). Në vitin 2015, në krahasim me vitin 2014, deponuesit e bllokuar persona juridik kanë rritje të kontributit prej vetëm 1 p.p., derisa për tërë periudhën 2012-2015, nuk është vërejtur rritje më e madhe se 2 p.p. në nivel vjetor. Në krahasim me personat fizik, është vërejtur rritje e moderuar e numrit të deponuesve të bllokuar që në vitin 2015 janë 4.9% e numrit të përgjithshëm të deponuesve në sektorin bankar. Gjatë kësaj, norma e rritjes së deponuesve të bllokuar persona fizik në vitin 2015 u ngadalësua dhe ishte 27.4%, në krahasim me 47.6%, sa ishte në vitin 2014. Sa për krahasim, në periudhën gjatë dhe pas fazës akute të krizës (vitet 2009-2010), numri i deponuesve të bllokuar rritej për njëherë deri tre herë në nivel vjetor.

Grafik 84
Treguesit e zhvillimit të sistemeve pagesore



Burimi: BPRM.

7.3. Mbikëqyrja e sistemeve pagesore

Për shkak të avancimit të rolit mbikëqyrës të BPRM në domenin e punës me sistemet pagesore gjatë vitit 2015, u përgatit rregullorja e re nënligjore për mbikëqyrje të sistemeve pagesore që i rregullon kriteret për klasifikimin e sistemeve pagesore, standardet e punës me sisteme pagesore, si dhe mënyrën dhe metodologjinë e mbikëqyrjes së sistemeve pagesore. Me përmbushjen e kërkesave nga rregullorja e re nga ana e sistemeve pagesore pritet të avancohen efikasiteti dhe siguria e rregulimeve për kryerjen e pagesave, kliring dhe barazim dhe më gjerë, do të kufizohet rreziku sistemor, do të rritet transparencja e punës dhe do të jepet kontribut në stabilitetin financiar. Me mënyrën dhe metodologjinë e re për mbikëqyrjen e sistemeve pagesore, para së gjithash, pritet që të arrihet forcim i mbikëqyrjes jashtë terrenit të sistemeve pagesore, edhe atë nëpërmjet raporteve periodike ad-hoc për punën e tyre, dorëzimin e planit vjetor të aktiviteteve në lidhje me testimin e zgjidhjeve dhe procedurave të rregullta dhe rezerve, si dhe dorëzimin e planit vjetor për vlerësimin e rrezikut të sistemit pagesor. Kjo rregullore bazohet në standardet e reja të pranuar ndërkombëtarisht të njohura si "Principe për infrastrukturën e tregjeve financiare"⁶⁹, gjatë së cilës njëkohësisht është implementuar qasja e Bankës qendrore Evropiane për klasifikimin e sistemeve pagesore, si dhe obligimet gjegjëse për sistemet e klasifikuara pagesore individuale në përmbushjen e principeve dhe kërkesat adekuate gjegjëse.

7.4. Aktivitetet tjera në sistemet pagesore

Nga aspekti i realizimit të rolit katalizator zhvillues të BPRM në sistemet pagesore, gjatë vitit 2015, BPRM ka realizuar një numër aktivitete të cilët para së gjithash ishin të orientuara drejt pajtimit të ligjeve vendore me rregullat evropiane në domenin e sistemeve pagesore. Kështu, përmes shumë takimeve dhe punëtorive me bankat dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve pagesore (raportues), u shqyrtua rregullorja e re nënligjore për dorëzimin e të dhënave për aktivitetet e kryera në qarkullimin pagesor. Rregullorja e re pritet të sigurojë përgatitjen e të dhënave më gjithëpërfshirëse dhe me cilësi të lartë për statistikën pagesore, si dhe gatishmëri metodologjike dhe operative të statistikave pagesore të BPRM në pajtueshmëri me kërkesat e Bankës qendrore Evropiane.

Në kuadër të projektit IPA për harmonizimin e ligjeve vendore në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit dhe shërbimeve pagesore dhe financiare me ligjet e Unionit Evropian, BPRM ndërmerr një numër të aktiviteteve (përmes mbajtjes së takimeve interaktive, diskutimeve, punëtorive, dhe vizitave studimore) të orientuara drejt transponimit të direktivave të Unionit

⁶⁹ Principtet e infrastrukturës së tregjeve financiare janë shkruar nga Komiteti për sisteme të pagesave dhe barazimit në Bankat për barazim ndërkombëtar dhe Organizatën ndërkombëtare të komisioneve të letrave me vlerë në prill të vitit 2012.

Evropian në lidhje me shërbimet pagesore, parave elektronike dhe harmonizimin me ligjet e Republikës së Maqedonisë. Transponimi i këtyre direktivave në ligjet tona do të kontribuojë në mbrojtjen më të madhe të konsumatorëve, arritjen e nivelit të lartë të transparencës, si dhe inkurajimin në zbatimin e llojeve më efikase të pagesës. Me ligjin e ri pritet të arrihet rritje e konkurrencës në domenin e shërbimeve pagesore.

Duke e mbajtur vazhdueshmërinë në bartjen e dijenive dhe informacioneve në sektorin financiar në vend në lidhje me trendet dhe risitë në sferën e sistemeve pagesore, BPRM në bashkëpunim me bankat qendrore të Holandës dhe Portugalisë në vitin 2015 organizoi konferencën e tetë për sistemet pagesore dhe sistemet për barazimin e letrave me vlerë. Mundësitë për zhvillimin e tregtisë elektronike dhe sfidat në fushën e kartelave pagesore dhe inovacionet në pagesa paraqesin një sfidë dhe fushë tërheqëse në interes edhe të Republikës së Maqedonisë, për të cilët diskutohej në konferencën nga aspekti i rritjes së mëtutjeshme të pagesave me para jo të gatshme në vend. Interes i veçantë u ishte kushtuar proceseve integruese në sferën e pagesave në Unionin Evropian, zhvillimi i vazhdueshëm i Projektit për fushë të vetme evropiane të pagesës (SEPA) dhe trendet tek sistemet për barazim të letrave me vlerë dhe realizimit të projektit "TARGET2 për letrat me vlerë". Kushtet e volitshme për hapjen e llogarive të transaksionit, zgjerimin e rrjeteve bankare veçanërisht në regjionet jo mjaft të zhvilluara, produktet e reja financiare dhe edukimi adekuat financiar, janë vetëm disa nga aspektet që përfshihen në problematikën e përfshirjes financiare, në të cilën BPRM përkushton interes të veçantë. Në konferencë diskutohej edhe për mbarëvajtjen pa pengesa të transaksioneve pagesore, për të cilën nevojitet mbrojtje dhe përmirësim i qasshmërisë fizike të shërbimeve pagesore për konsumatorët dhe kompanitë, si dhe nevojën për zhvillim të financimit të tregtisë.


Në këtë kontekst, në mënyrë plotësuese, BPRM organizoi trajnim për organet shtetërore për garancitë bankare si instrument për financimin e tregtisë ndërkombëtare. Trajnimi për garancitë bankare solli përfitime për organet shtetërore në aspektin e zhvillimit të dijenive analitike, shkathtësive diagnostike dhe zbatim adekuat i garancive bankare si instrument për mbrojtje nga rreziqet e raporteve të kontraktuara.

VIII. Emetimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike në Republikën e Maqedonisë - operacionet e thesarit

8.5. Monedha në qarkullim

Sasia e monedhave në qarkullim me datë 31.12.2015 ishte 31,948 milionë denarë⁷⁰ dhe ne krahasim me sasinë ne vitin 2014 regjistron rritje prej 3,868 milionë denarë, ose 13.8%.

Grafik 85
Monedha në qarkullim



Burimi: BPRM


Ne strukturën e monedhave në qarkullim ne fund të vitit, kartëmonedhat bëjnë pjesë me 97.1%, ndërsa monedhat metalike me 2.9% ne vlerën e përgjithshme.

Për sa i përket numrit të monedhës në qarkullim, pjesa e kartëmonedhave është 27.0% (79.6 milionë copë), dhe monedha metalike 73.0% (215.4 milionë njësi).


Pjesë më të madhe në vlerën e përgjithshme të kartëmonedhave në qarkullim e bëjnë kartëmonedhat me emërtim prej 1000 denarë (76.2%) dhe 500

denarë (16.6%). Kartëmonedhat tjera përbënin 7.2% të vlerës së përgjithshme të kartëmonedhave në qarkullim. Në vitin 2015, vlera më e madhe te monedhat metalike kane monedhat me prej 50 denarë (32.2%), 10 denarë (27.8%) dhe 5 denarë (18.0%).

Grafik 86




Burimi: BPRM.



⁷⁰Në të dhënat e treguara për lëshimin e parave në qarkullim nuk janë inkorporuar sasi të dhe vlera e parave për qëllime kolecionuese, të cilat BPRM për qëllime artistike, kulturore si dhe arsye promotive i ka krijuar dhe lëshuar në qarkullim. Monedhat për qëllime kolecionuese janë të eksponuara së pari në mërgatë, por edhe në RM. Vlera e këtyre monedhave në qarkullim përfundimisht me 31 dhjetor 2015 arinë 2.9 milionë denarë.

Grafik 87




Burimi: BPRM.

Sipas numrit të sasisë e emtuar, në strukturën përgjithshme, kartëmonedhat me emërtim prej 10 denarë kane pjesëmarrje prej 34.4%, 1,000 (29.7%) dhe 100 (18.2%). Kartëmonedhat e mbetura përbënin 17.7% të shumës së përgjithshme të kartëmonedhave në qarkullim. Pjesa më e madhe në totalin e emtuar kanë monedhat metalike me emërtim prej 1 denarë (41.2%).

8.6. Furnizimi i bankave me kartëmonedha dhe monedha metalike

Gjatë vitit 2015, Thesari Qendror i Bankës popullore dhe pesë seksione për trajtimin e qarkullimit të parasë jashtë Shkupit⁷¹, disbursuan para bankave në vlerë prej 34.4 miliardë denarë (rritje prej 23.2% në krahasim me vitin 2014). Në të njëjtën kohë, ata pranuan para nga bankat në vlerë prej 30.6 miliardë (një rënie prej 22.9% në krahasim me vitin 2014). Analiza e strukturës së emërimit të kartëmonedhave dhe monedhave metalike sugjeron se, gjatë emetimit dhe pranimit, kartëmonedha më e zakonshme është emërtim prej 1000 denarë, me një pjesëmarrje prej 41.1% në vitin 2015 (dhe 36.2% në vitin 2014), ndërsa te monedhat metalike mbizotëron prerja prej 10 denarë me një pjesëmarrje prej 26.7% në vitin 2015 (kundrejt 24% në vitin 2014).

Grafik 88



Burimi: BPRM.

⁷¹ Për shkak të punës jrentabile, BPRM gjatë muajit tetor në vitin 2015 filloj procesin e ristrukturimit të operacioneve me para të gatshme me reduktim gradual të Reparteve për trajtimin e të hollave. Që nga dhjetori 2015 funksionimi i tze u ndal në tërë Republikën

8.7. Përpunimi dhe riciklimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike

Gjatë vitit 2015, gjatë procesit të kontrollit të cilësisë i kartëmonedhave në qarkullim në thesarin qendror dhe në seksionet për qarkullim te parasë në vend, janë të përpunuara të gjitha kartëmonedhat e pranuar. Nga totali i kartëmonedhave të përpunuara, përshkak të lashtësisë dhe dëmtimit 15.8 milionë kartëmonedha janë të shkatërruar (13.6 milionë kartëmonedha në vitin 2014). Kartëmonedhat më të shkatërruara janë me emërtim prej 1,000 denarë dhe 100 denarë (56.3%). Në vitin 2015, të gjitha monedhat metalike në emërtim prej 1, 2, 5, 10 dhe 50 denarë që janë pranuar janë përpunuar, nga të cilat 170 mijë copë u etiketuan si lashtë.


8.8. Ekspertiza për paratë e dyshimta/ falsifikuara

Brenda kompetencave të saj, Banka Popullore, si autoriteti i vetëm për të identifikuar vërtetësinë e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të denominuara në denarë ose në monedhë të huaj, edhe në vitin 2015 me sukses vazhdon të kryejë funksionin e ekspertizës së parave të falsifikuara. Në mënyrë që të forcojë kapacitetin për të zbuluar me saktësi paratë të dyshimta dhe të falsifikuara në vitin 2015, Banka popullore e ka vazhduar me trajnimin e stafit nëpër bankat. Përmes prezantimeve dhe trajtimit të drejtpërdrejtë të parave autentike dhe të falsifikuara, pjesëmarrësit njoftohen me ekspertizën.

Sa i përket numrit të ekspertizave të kryera gjatë vitit 2015, nga 1415 kartëmonedha të dyshimta denarike të dorëzuara, ekspertiza profesionale konstatoj që 131 kartëmonedha ishin të vërteta, ndërsa 1284 të mbetur ishin kartëmonedha të falsifikuara. Në vitin 2015, numri i kartëmonedhave të falsifikuara të zbuluara është rritur për 4.6 herë në krahasim me vitin 2014. Nga numri i përgjithshëm i zbuluar të kartëmonedhave të falsifikuara në denarë në vitin 2015 më zakonshëm është denominimi në 500 denarë, ekskluzivisht për shkak të lejes organizuar të falsifikatëve në qarkullim me këtë vlerë të denominuar. Si pas kësaj, Nga numri i përgjithshëm i zbuluar të kartëmonedhave të falsifikuara në denarë në vitin 2015 më zakonshëm është denominimi në 500 denarë (1144 copë), ose 89.1% nga numri total i falsifikuar, pastaj denominimi në 1000 denarë (35 copë), ose 2.7% nga numri i përgjithshëm. Vlera e përgjithshme e falsifikuara në denarë në vitin 2015 arriti në 677,650.00 denarë dhe ka një peshë të papërfillshme në krahasim me vlerën e monedhës në qarkullim.


Grafik 89

Kartëmonedha të falsifikuara në denarë



Burimi: BPRM.

Kartëmonedha të falsifikuara në valutë të huaj



Në lidhje me valutat e huaja të falsifikuara, në vitin 2015 janë të bëra 670 ekspertiza të kartëmonedhave dyshimta të paraqitura, nga të cilat 599 kartëmonedhave janë përcaktuar si të falsifikuara dhe 71 kartëmonedha origjinale. Nga numri i përgjithshëm i kartëmonedhave të falsifikuara, më të zakonshme janë kartëmonedhat në euro (303 copë) dhe dollar amerikan (137 copë).

Ndryshe nga vitet e mëparshme , në vitin 2015, u zbuluan dhe monedha të falsifikuara në monedhë të huaj . Bëhet fjalë për sasi prej 154 monedha , nga të cilat 152 monedha të falsifikuara denominuara në 2 euro dhe dy monedha të falsifikuara denominuara në 1 euro .

Konkluzioni i përgjithshëm është se kartëmonedhat e falsifikuara janë të një cilësie relativisht e varfër, duke lejuar identifikimin e thjeshtë dhe të lehtë të tipareve të tyre. Nga ekspertiza e teknikës së përpunimit të kartëmonedhave të falsifikuara është përcaktuar se ata janë bërë kryesisht në letër të thjeshtë pa elemente të sigurisë, duke përdorur kompjuterin (për skanim dhe shtypje), apo makinë kopje me ngjyra.

8.9. Shitja e monedhave metalike për çështje koleksionimi

Gjatë vitit 2015, Banka popullore përveç dy serive aktuale të monedhave metalike për çështje koleksionimi ("Ikonat e shenjtorëve" dhe "Shenjat Zodiac"), në qarkullim vendoj edhe nje seri të monedhave metalilke për çështje koleksionimi - "Dita e Engjëllit".

Monedhat metalike për qëllime koleksionimi janë unike, përfaqësuese dhe me vlerë të madhe artistike që kontribuon në promovimin e Republikës së Maqedonisë. Edhe pse kryesisht shitja e monedhave për çështje kolleksionimi është e destinuara dhe zhvillohet jashtë vendit , ka pasur interes të konsiderueshëm në to dhe në vend. Gjatë vitit 2015 janë shitur 481 copë të monedhave koleksioniste.

IX. Statistika

Banka popullore është një nga organet e autorizuar për kryerjen e anketave statistikore brenda sistemit statistikor kombëtar në Republikën e Maqedonisë. Funkzioni statistikor i Bankës popullore është përcaktuar me Ligjin për Bankën popullore të Republikës së Maqedonisë dhe Ligjin për statistikat shtetërore. Hulumtimet statistikore të kryera nga Banka popullore janë paraqitur në Programin statistikor për hulumtime. Aktualisht, Banka popullore prodhon të dhëna të përgjithshme mbi statistikat monetare dhe statistikave të normave të interesit, të bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare, investimet direkte, borxhi i jashtëm dhe pretendimet, rezerva valutore dhe likuiditetit në valutë të huaj. Statistikat janë bazë për informimin e publikut në lidhje me mjedisin financiar dhe makroekonomik dhe trendet në Republikën e Maqedonisë, por edhe paraqesin një mbështetje të rëndësishme për vendimet që kanë të bëjnë me funksionet bazë të bankës popullore.

Banka popullore, në kuadër të hulumtimit statistikor në juridiksionin e saj, ndërmerr aktivitete të përhershme për monitorim dhe pajtueshmërisë me standardet statistikore ndërkombëtare dhe evropiane. Për këtë qëllim, Banka popullore vazhdimisht bashkëpunon me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bankën për Rregullime Ndërkombëtare, Bankën qendrore Evropiane dhe Eurostat-in, për përmirësimin e cilësisë së të dhënave në dispozicion, në njërin anë, dhe për shpërndarjen e rregullt të të dhënave statistikore për këto institucione, nga ana tjetër. Aktivitetet më të rëndësishme të kryera gjatë vitit 2015 kanë vazhdojnë të jenë: 1) përputhja me standardet e reja statistikore ndërkombëtare në fushën e statistikave të jashtme, dhe në përputhje me këto aktivitete, edhe në Shtetet Anëtare të BE-së. 2) pasurimin i sipërfaqes dhe tërësinë e të dhënave statistikore në dispozicion të publikut, duke marrë parasysh ngarkesën e raportimit, si dhe qasja më e shpejtë dhe më e lehtë për përdoruesit e jashtëm. Këtë vit më të rëndësishme janë aktivitete të cilat janë pjesë e projekteve afatmesme: zhvillimi e statistikave të llogarive financiare dhe projektet për përmirësimin e ofrimit të informacionit në fushën e statistikave të jashtme financiare. Për të shënuar është forcimi e bashkëpunimit me aktorë të tjerë të hulumtimeve statistikore, kryesisht me ESHS dhe MF, të cilat çuan në krijimin e burimeve të reja të të dhënave për nevojat e statistikës e llogarive financiare. Përparimi në fushën e hulumtimeve statistikore është konfirmuar nga vlerësimi në raportin e KE-së për përparimin e Maqedonisë në vitin 2015, ku thuhet se Banka Popullore përgatit statistikat e jashtme në përputhje me standardet më të fundit statistikore.

Në veçanti, është bërë progres në statistikat e fushave të mëposhtme:

- në fushën e statistikave të jashtme, vazhdojnë aktivitetet për rritjen e cilësisë të të dhënave, kryesisht me të dhëna për investimet direkte jashtë vendit, ku në kuadër të bilancit të pagesave është arritur pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë të dhëna për fitimet e riinvestuara dhe kredive tregtare tek investimet direkte jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, ishin të përgatitur dhe publikuar seri kohore të të dhënave mbi lëvizjet në investimet direkte jashtë vendit sipas llojit të investimit, vendi i ndërmarrjes jorezidente në të cilën është investuar dhe aktiviteti ekonomik të investitorët vendas. Gjithashtu ka filluar mbledhja e të dhënave më të detajuara për kreditë tregtare sipas kërkesave statistikore në këtë segment;
- progres solid është bërë edhe tek projekti për ndërtimin e një "depo" të vetme të të dhënave statistikore, e cila ka për qëllim që të sigurojë menaxhimin optimal të bazave të të dhënave statistikore në BPRM, si dhe shpërndarjen e ardhshme për

- të dhëna më të detajuara deri në Eurostat dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
- si pjesë e aktiviteteve për krijimin e statistikave të letrave me vlerë, filloi raportimi mbi investimet e banorëve në tregjet e huaja të letrave me vlerë, duke aplikuar parimin e njoftimit individual për çdo letër me vlerë. Gjithashtu, është konceptuar edhe sistemi i burimeve të të dhënave për investime në letra me vlerë në tregun e brendshëm, nga banorët dhe jorezidentët, me të cilën mbledhja e këtyre të dhënave do të fillojë gjatë vitit 2016;
 - në fushën e statistikave monetare, Banka Popullore ka rritur mbulimin e të dhënave në kuadër të bilancit dhe përmbledhjet të institucioneve të tjera financiare dhe shqyrtim të institucioneve financiare duke i përfshirë të dhënat për kompanitë e lizingut dhe kompanitë financiare, duke filluar nga viti 2014 e tutje, me të cilën u arrit mbulimi pothuajse e plotë e sektorit "institucionet e tjera financiare". Përveç kësaj, të publikuar janë edhe të dhëna të hollësishme mbi institucionet e tjera financiare, sipas nënsektorët. Projekti afatmesëm për harmonizimin e statistikave mbi normat e interesit me legjislacionin evropian përfundojë me publikimin e të dhënave të reja të harmonizuara. Gjithashtu, pas analizave të bëra, Banka Popullore ka vendosur për të futur një sistem të integruar të mbledhjes së të dhënave për qëllime statistikore dhe mbikëqyrëse. Bëhet fjalë për projekt afatgjatë për qëllim sigurimin e mbulimit të duhur të të dhënave monetare në përputhje me rekomandimet e BQE-së dhe rregulloreve të reja të BE-së për statistikën e skemave bilancore dhe paraqitjen statistikave rrjedhës, si dhe zgjidhjet optimale në drejtim të marrjes së të dhënave;
 - gjatë vitit 2015, në fushën e statistikave të llogarive financiare, një sërë aktiviteteve u ndërmor për të krijuar burime të reja dhe më të racionala të përdorimit të të dhënave ekzistuese për nevojat e llogarive financiare. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, u etablu burim i ri të dhënave duke plotësuar tërësinë e të dhënave që janë mbledhur nëpërmjet llogarive vjetore të subjekteve të biznesit. Gjithashtu, në bazë të bashkëpunimit intensiv me Ministrinë e Financave ka qenë i përgatitur raportimi i ri mbi statusin dhe shpërndarjen e aktiveve dhe detyrimeve të shtetit financiar. Në bashkëpunim me Entitetin Shtetëror Statistikor, Banka organizoi ciklin e dytë të trajnimit për kompanitë raportuese për hulumtim statistikor për nevojat e statistikave të llogarive financiare. Gjithashtu, aktivitetet për përmirësimin e cilësisë të llogarisë preliminare financiare dhe kompozimin e matricës së flukseve monetare kanë vazhduar, me përpjekjet e vazhdueshme për të siguruar konsistencë më të madhe të të dhënave për sektorë të veçantë institucionale;
 - në kuadër të angazhimit strategjik për përmirësimin e cilësisë së komunikimit me raportuesit dhe konsumatorët, aktivitet të ndryshme janë të ndërmara. Me qëllim që të zvogëlohet barra raportuese, akte nënligjore të reja janë të miratuara për regjistrimin e operacioneve kreditore të përfunduara të jorezidentëve, e cila thjeshton procedurën për regjistrimin dhe zvogëlon volumin e dokumenteve të paraqitura në Bankën Popullore. Në aspektin e komunikimit me përdoruesit, në kuadër të Kontributit statistikorë tremujorë të dhëna të reja detajuara janë të publikuara lidhur me statistikën monetare dhe statistikën e interesit. Në shkurt të vitit 2015, në kuadër të aktiviteteve të edukimit financiar, janë organizuar prezantime për gazetarët, ku ndër të tjera u njohën edhe me funksionin statistikor të Bankës Popullore dhe mënyrat e mundshme të

monitorimit analitik të të dhënave në dispozicion. Gjatë vitit, Banka filloi një projekt të ri për të ndërtuar një mjet për analizë të brendshëm të statistikave dhe portalit statistikor i të nternetit për përdoruesit e të dhënave;

- Në kuadër të përpjekjeve për zbatimin e duhur të klasifikimeve statistikore ndërkombëtare Banka Popullore krijua një bazë të centralizuar statistikor të departamenteve të personave juridikë, në përputhje me bazën e të dhënave të sektorëve institucionalë nga ESHS të subjekteve të ekonomisë së vendit.
- Gjithashtu, për të lehtësuar zbatimin e Klasifikimit të ri Kombëtar të sektorëve institucionalë në bazë ESA2010 është përgatitur dhe "Udhëzues për segmentim sipas sektorëve institucionalë" të destinuar për raportuesit dhe shfrytëzuesit e të dhënave.

Praktika për përmirësimin e vazhdueshëm të kapacitetit të Bankës popullore në fushën e statistikave, ka vazhduar gjatë këtij viti, përmes trajnimit dhe bashkëpunimit me disa banka qendrore të Shteteve Anëtare të BE-së, përmes Instrumentit të Asistencës së Para-aderimit të vendeve kandidate për anëtarësim në BE - TAIEX vazhdon dhe përmes bashkëpunimit me misionin teknin e FMN- së në statistikat monetare .

X. Funkzioni mbikëqyrës dhe rregullator i BPRM

10.1 Kuadri rregullator mbikëqyrës për vitin 2015

Gjatë vitit të kaluar u miratuan shumë ndryshime në kuadrin rregullator mbikëqyrës, nga të cilat më të rëndësishmet kanë të bëjnë me punën e shtëpive të kursimit, funksionimit të Regjistrit të Kredive, paraqitjen e masave të veçanta mbrojtëse, përcaktimit të palëve të lidhura, metodologjinë për përcaktimin e kapitalit adekuat dhe rregulloren për menaxhim me riskun kreditor.

Me qëllim të afrimit drejt standardeve të cilët aplikohen tek puna e bankave në Republikën e Maqedonisë, në vitin 2015 u soll ndryshimi në aktet nënligjore për shtëpitë e kursimeve me të cilën përforcohen standardet për punën e shtëpive të kursimit që kanë të bëjnë me kapitalin adekuat, menaxhimin me riskun valutor, mënyrës së organizimit të auditimit të brendshëm dhe sigurinë e sistemeve të informacionit të shtëpive të kursimit.

Ndryshimet dhe plotësimet e akteve nënligjore të Regjistrit kreditor kanë pasur për qëllim që të sigurojnë pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, përmes përshkrimit të mënyrës së qasjes së personave fizik deri tek të dhënat dhe informacionet e tyre në Regjistrin kreditor, si dhe mundësisë për korigjimin e të dhënave të gabuara personale.

Duke marrë parasysh zhvillimet në Republikën e Greqisë, në mesin e vitit 2015, BPRM solli masa mbrojtëse, me karakter të përkohshëm, me të cilët u mundësua kufizimi i rrezikut nga dalje të konsiderueshme të kapitalit nga Republika e Maqedonisë drejt jorezidentëve nga Republika e Greqisë. Këto masa mbrojtëse u ndërprejnë pas kalimit të gjashtë muajve nga prezantimi i tyre (dhjetor 2015).

Ndryshimi në pjesën e përcaktimit të palëve të lidhura është bërë me qëllim të arritjes së një përputhshmërie me rekomandimet e përfshira në dokumentin e Baselit për matjen dhe kontrollin e ekspozimeve të mëdha, në aspekt të mënyrës së vlerësimit dhe monitorimit të a. q lidhje ekonomike. Pastaj, në qoftë se ekspozimi i bankës ndaj një personi individual është më i vogël se 2% nga mjetet e tija vetanake, ajo nuk duhet që të vlerësojë ekzistimin e lidhjes ekonomike.

Në fund të vitit, u sollën ndryshime dhe plotësime në metodologjinë për përcaktimin e kapitalit adekuat, të cilat ishin të orientuara drejt "pengimit" të rritjes së mëtejshme të kredive konsumatore afatgjate, e cila është e pranishme sidomos në dy vitet e fundit. Bankat janë të detyruara që të ndajnë një sasi më të lartë të kapitalit për kredi konsumatore afatgjata me një afat të barabartë ose më të gjatë se tetë vjet, edhe atë vetëm për kreditë e reja konsumatore afatgjata. Në të njëjtën kohë, me qëllim që të krijohen kushte për një qasje më të lehtë të shoqërive jo-financiare deri tek shërbimet financiare, është përcaktuar një sasi më e ulët kapitale për kërkesat e bankave të cilët janë të siguruara me hapësirë afariste. Në lidhje me këto ndryshime u miratuan edhe ndryshime në rregulloren për menaxhim me riskun kreditor, me të cilat përforcohen politikat për menaxhim me riskun kreditor, dhe përcaktohen edhe detyrime për bankat që të kryejnë fshirjen e të gjitha kërkesave të cilat tërësisht janë të rezervuara për më shumë se dy vjet.

Gjatë kësaj periudhe vazhduan aktivitetet për zgjerim lidhur me të a. q Basel 3, edhe atë në lidhje me hartimin e rregullores për zbatimin e: 1) standardit të ri të likuiditetit,

gjegjësisht normës së mbulimit me likuiditetit; dhe 2) kërkesat e reja në lidhje me elementet e mjeteve vetanake të bankës. Në këtë mënyrë do të sigurohet një harmonizim i mëtejshëm i rregullores së vendit me kërkesat e Basel 3 dhe, direktivës dhe rregullores evropiane përkatëse.

10.2 Kryerja e supervizionit dhe mbikëqyrja

Gjatë vitit 2015 kontrollet inspektuese dhe mbikëqyrëse në masë të madhe janë zbatuar në mënyrë të sinkronizuar, dhe në krahasim me vitin 2014 e zvogëlon numrin e kontrolleve të regjistruara në terren. Kështu që, tek 6 banka dhe një shtëpi kursimi me aktivitetet kontrolluese është kryer vlerësimi i profilit riskoz të tyre, si dhe përputhshmëria e punës së tyre me rregullat. Gjithashtu, me aktivitetet kontrolluese, tek 5 banka është kryer vlerësimi i vetëm i ekspozimit ndaj rreziqeve të caktuara, ndërkohë që tek 7 banka dhe 2 shtëpi kursimi është kryer mbikëqyrje ndaj zbatimit të rregullave. Në periudhën raportuese, është kryer edhe një kontroll tematik për vendosjen e sistemeve të informacionit të bankave në lidhje me përmbledhjen e llogaritjeve në pagesa me para të gatshme dhe para jo të gatshme dhe librave të tyre afariste. Janë kryer aktivitete të kontrollit edhe tek 2 ofrues të shërbimeve për transfer të shpejtë të parave, tek 40 nën agjentët si dhe tek 64 zyra të këmbimit të autorizuar.

10.3 Kontrollat në terren të rreziqeve

Bankat në Republikën e Maqedonisë janë të orientuara kah aktivitetet tradicionale bankare dhe risku kreditor në masë të madhe e përcakton profilin e tyre të rrezikut⁷². Nga kjo, ky rrezik, veçanërisht cilësia e menaxhimit me të, më shpesh është subjekt i vlerësimit tek kontrollet në terren. Në vitin 2015, një vëmendje e veçantë i është kushtuar rreziqeve të segmentit "popullsi", duke pasur parasysh orientimin e bankave kah mbështetja më e madhe kreditore për këtë segment. Gjithashtu, tek disa banka janë vlerësuar sistemet e duhura për ndalimin e larjeve të parave, riskut të likuiditetit, riskut operativ, profitabilitetit të tyre, sigurisë informative, si dhe qeverisjes korporative.

Kontrollet tregojnë se bankat në mënyrë të kënaqur menaxhojnë me rreziqet në të cilat janë të ekspozuar dhe kryesisht janë të përgjegjshëm për masat korrigjuese të dhëna nga ana e BPRM. Tek bankat ku është vlerësuar qeverisja korporative është vërtetuar ekzistimi i një strukture adekuate organizative dhe proceseve për menaxhim me rreziqet si dhe mekanizmave të vendosura të kontrollit të brendshëm të cilat në mënyrë të vazhdueshme po përforcohen.

Për përmirësimin e rregullave dhe praktikave të vendosura për menaxhim me rreziqet janë dhënë rekomandime adekuate, të cilat në lidhje me riskun kreditor kanë të bëjnë me: përforsim të analizave kreditore për klientët, përforsim të monitorimit në lidhje me shfrytëzimet adekuate të kredive të aprovuara, përmirësimin e sistemeve për identifikim dhe monitorim të palëve të lidhura, përmirësimin dhe monitorimin e aftësive kreditore tek klientët nga segmenti "popullsi" përmes monitorimit të borxhit të përgjithshëm të tyre në nivel të sistemit, përmirësimin e procesit të klasifikimit të ekspozimeve kreditore në aspekt të ndikimit në aftësinë kreditore dhe historisë kreditore, përmirësim të kriteriumeve të paralajmëruara në procesin e monitorimit të kredive miratuara, përforsimin e monitorimit të kredive të miratuara me përjashtim, si dhe rekomandime për përmirësimin e auditimit të brendshëm në lidhje me këtë rrezik.

⁷² Analiza e rreziqeve në sektorin bankar është i përfshirë në Raportin për rreziqet në sektorin bankar në vitin 2015.

Në lidhje me masat dhe aktivitetet të cilat bankat i ndërmarrin për parandalimin e larjeve të parasë dhe financimin e terrorizmit, janë dhënë rekomandime për: përforsim të masave për identifikim dhe verifikim të identitetit të vërtetë të pronarit (klientit), përmirësim i strukturës dhe përmbajtjes së analizave për klientët dhe transaksioneve me qëllim të vërtetimit më të saktë të nivelit të rrezikut të klientëve, përkatësisht njohjen e transaksioneve të dyshimta, përforsim të treguesve për njohje ose identifikim të transaksioneve të dyshimta eventuale, përmirësim të profilizimit dinamik të rrezikut të klientit, harmonizim të sasisë së masave dhe aktiviteteve që merren me nivelin e rrezikut të klientëve dhe përforsim të aktiviteteve të auditimit të brendshëm.

Për të përmirësuar menaxhimin e riskut të likuiditetit janë dhënë rekomandime në lidhje me mënyrën e projektimit të pagesave në bazë të kredive, revidim të skenarëve përmes së cilave kryhet stres-testimi dhe përpunimi i planeve për menaxhim me likuiditetin në kushte të jashtëzakonshme. Menaxhimi me riskun operativ do të përmirësohet përmes: përmirësimit të procesit të vërtetimit të riskut, përmirësimit të përdorimit të bazave të ngjarje me dëme, përditësimit në kohë të planeve për vazhdimësi në punë në përputhje me proceset afariste dhe sistemeve në banka dhe rritjes së mbulimit me testim përmes përfshirjes më të madhe të anës afariste, përmirësimit të kontroleve në zyrat e thesarit, përforsimit të rolit të Zyrës së menaxhimit me rreziqe në lidhje me këtë rrezik. Me qëllim të rritjes së sigurisë informative janë dhënë rekomandime për: përmirësimin e proceseve të analizës së rreziqeve, përforsimin e masave të kontrollit, përmirësimin e sistemit në gjurmë auditimi, përmirësimin e aktiviteteve gjatë zbatimit zhvillim dhe rindërtim dhe përmirësimin e mbrojtjes së komunikimit me shfrytëzuesit e sistemit elektronik bankar.

10.4 Kontrollat në terren në pajtueshmëri me rregulloret

Aktivitetet e kontrollit në terren, përmes së cilave ishte kontrolluar puna e bankave dhe shtëpive të kursimit nga aspekti i zbatimit të rregulloreve, përfshinë verifikimin e pajtueshmërisë me: Ligjin për BPRM, Ligjin për veprimeve të këmbimeve valutore, Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore, Ligjin për kryerje të shërbimeve transfer të shpejtë të parave dhe Ligjin për qarkullim pagesor. Tek të gjithë subjektet e kontrolluara është vërtetuar kryerja e aktiviteteve në përputhje me rregulloret. Disa rezultate në lidhje me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë kredive konsumatore dhe Ligjit për veprimeve të këmbimeve valutore, në aspektin e përmbajtjes së formularit për informacione para-kontraktuale, elementet e detyrueshme të kontratave për kredi konsumatore dhe elementeve të kontratave për kreditim në valutë për rezidentët, janë tejkualuar gjatë kohëzgjatjes së kontroleve. Bankave iu janë dhënë udhëzime për rregullimin e mënyrës së informimit të konsumatorëve në rastet e refuzimit të kredive të kërkuara. Tek verifikimi i përputhshmërisë së punës me Ligjin për BPRM, në aspekt të përlogaritjes dhe përmbushjes së rezervave të detyrueshme, tek shumica e bankave ishte treguar nevoja për kontroll të rregullt në përmbushjen e kushtit të përcaktuar në rregullore⁷³ që ka të bëjë me lartësinë normës së interesit e cila do të paguhet gjatë tërheqjes së parakohshme të depozitave të afatizuara. Në pjesën e rregullores e cila e rregullon veprimet e këmbimeve valutore, disa bankave iu është treguar për ndryshimet në rregulloren që ka të bëjë me rregullimin e hyrjen në valuta nga jo-rezidentët.

⁷³ Duke pasur parasysh ndryshimet në vendimin për rezerva të detyrueshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 153/12, 98/13, 166/13, 143/14, 30/15, 35/15, 148/15 dhe 223/15) nga gushti 2015, me të cilat rregullohet norma e rezervës së detyrueshme prej 0% për kategori të caktuara të detyrimeve, dhe veçanërisht për depozitat mbi një dhe dy vjet i përshkruhen kushtet e kontratës tek ata.

Kontrollet në terren të institucioneve financiare jo-bankare, gjegjësisht zyrave të këmbimit të autorizuar, ofruesve të shërbimeve për transfer të shpejtë të parave dhe nën agjentëve të tyre kanë pasur për qëllim që të japin vlerësim për përputhshmërinë e veprimtarisë së tyre me Ligjin për veprimeve të këmbimeve valutore, Ligjit për transfer të shpejtë të parave dhe Ligjit për ndalimin e larjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Me kontrollet janë vërtetuar disa parregullsi tek zyrat e këmbimeve të autorizuar në mënyrën e kryerjes së operacioneve të këmbimit.

10.5 Licencimi i bankave dhe shtëpive të kursimit në vitin 2015

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta që kanë të bëjnë me licencimin e bankave dhe shtëpive të kursimeve, në pajtim me Ligjin për banka, gjatë vitit 2015 nga ana e BPRM janë zhvilluar 69 procedura për dhënien e miratimeve. Procedurat e kryera gjatë vitit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3

Procedurat e licencimit të kryer në vitin 2015

Lloji i lejes/pëlqimit (bankat)	lëshuar	refuzuar	ndalur
Pëlqimi për fillimin e kryerjes së aktiviteteve financiare	3	/	1
Pëlqim për ndryshimin e statutit	9	/	/
Pëlqim për emërimin e anëtarit të Bordit Mbikëqyrës	39	/	/
Pëlqim për emërimin e anëtarit të Bordit Drejtues	16	/	/
Lloji i lejes /pëlqimit (Banka e Kursimeve)	lëshuar	refuzuar	ndalur
Pëlqim për marrjen e mbi 50% nga investimet në shtëpitë e kursimeve	1	/	/
Totali	68	/	1

BPRM realizoi edhe një procedurë për licencim në përputhje me Ligjin për qarkullim pagesor, sipas së cilës ishte nxjerrë pajtueshmëria për kryerjen e mikropagesës.

XI. Auditimi i brendshëm

Në vitin 2014, Departamenti i auditimit të brendshëm (DAB) plotësisht e zbatojë Programin e vet të punës. Nëpërmjet të një vlerësimit sistematik dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e procesit të menaxhimit të rrezikut, përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe proceseve të menaxhimit, auditimi i brendshëm i kryen objektivat e tija kryesore, duke u dhënë siguri rreth:

1. Përdorimit efikas dhe ekonomik të burimeve;
2. Ruajtjen dhe mbrojtjen e mjeteve;
3. Besueshmërisë dhe integritetit të informacioneve financiare dhe të tjera; dhe
4. Përputhshmërisë së operacioneve me ligjet dhe rregulloret, politikat e brendshme dhe procedurat e punës.

Në vitin 2015, janë realizuar gjithsej 22 auditime të rregullta dhe një e jashtëzakonshme në 28 procese të punës, ku për rezultatet e dhëna janë dhënë gjithsej 53 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrolleve të brendshme. Në bazë të tremujoreve të rregullta është monitoruar zbatimi i rekomandimeve të dhëna dhe gjetjet nga monitorimet e kryera sugjerojnë në atë se rekomandimet kryesisht respektohen dhe po realizohen brenda afatit të caktuar. Në vitin 2015, 96% e rekomandimeve janë zbatuar.

Auditimi i brendshëm, përveç operacioneve të rregullta kishte aktivitete shtesë për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e operacioneve të veta. Nga ky këndvështrim, gjatë vitit 2015 është kryer vetëvlerësim periodik i brendshëm i punës së DAB-it, është rishikuar Udhëzimi për punë në DAB, është aplikuar programi për vërtetim të cilësisë dhe përmirësim në punë, si dhe aktivitete të tjera me karakter edukativ.

Operacioni i Departamentit të auditimit të brendshëm ishte e mbikëqyrur nga afër nga Komisioni i Auditimit, i cili ka mbajtur pesë takime gjatë vitit 2015.

XII. Përmirësimi i kapacitetit institucional i BPRM

12.1. Planifikimi strategjik

Sipas praktikës së vendosur, gjatë vitit është sjellë Plani strategjik i BPRM për vitin 2016 - 2018. Në bazë të Planit Strategjik janë sjellë Udhëzimet për punë dhe Programi për punë për vitin 2016 i cili paraqet përpunim të detajuar të qëllimeve të vendosura dhe udhëzimeve për të periudhën e ardhshme, nga aspekti i bartësve, afateve dhe statusit të realizimit të tyre. Plani Strategjik e pasqyron dedikimin për realizimin e suksesshëm të qëllimeve të vendosura ligjore të përkthyer në misionin e BPRM. Angazhimi për të ruajtur inflacion të ulët dhe të qëndrueshëm përmes strategjisë për mbajtjen kursit të qëndrueshme të denarit ndaj euros, si dhe ruajtjes së stabilitetit financiar si një element integral i stabilitetit makroekonomik dhe një parakusht për realizim të rritjes dhe prosperitetit ekonomik, janë shtylla kryesore e aktiviteteve të BPRM. Për më tepër, Plani strategjik është vazhdimësi e qëllimeve strategjike të përcaktuara më parë në sferën e krijimit dhe zbatimit të politikës monetare dhe mbështetjes së tregjeve financiare, menaxhimit me rezervat valutore, ruajtjes së stabilitetit financiar, emetimit dhe menaxhimit me kartëmonedhat dhe monedhat, sistemit të pagesave, statistikës dhe hulumtimeve. Në këtë drejtim, BPRM edhe më tej do të vazhdojë që të zhvillojë qeverisjen korporative dhe do të thellojë sistemin e vlerave, ndërtimin e kapitalit njerëzor kompetent dhe bashkëkohor, krijimin e inovacioneve teknologjike më të fundit në proceset afariste dhe zhvillimin e bashkëpunimit me institucionet vendit dhe të huaja.

12.2. Menaxhimi me rreziqet operative

Në janar të vitit 2015, Këshilli i BPRM-së paraqiti Politikën për menaxhim me rreziqet operative, e cila në fakt paraqet një përpunim të mëtejshëm dhe qartësim të sistemit të vendosur për menaxhim me rreziqet në BPRM. Qëllimi kryesor i Politikës për menaxhim me rreziqet operative është që të sigurojë një sistem për menaxhim të koordinuar, gjithëpërfshirës dhe sistematik të rreziqeve operative, me qëllim të përcaktimit të ngjarjeve të cilët mund të ndikojnë në punën e bankës, mbajtjes së ekspozimit ndaj rreziqeve brenda kornizave të pranueshme dhe realizimit efikas të qëllimeve të BPRM.

Korniza e vendosur për menaxhim me rreziqet operative buron nga detyrat dhe qëllimet e përcaktuara strategjike dhe i përfshin hapat e mëposhtme: regjistrimin e proceseve dhe projekteve të punës, përcaktimin e shkallës kritike të tyre, identifikimin, regjistrimin dhe vlerësimin e rreziqeve gjatë zbatimit të proceseve dhe projekteve të punës, identifikimin e strategjisë dhe planit akcionar me masat për tu marrë, raportuar dhe monitoruar me rreziqet.

Për të operacionalizuar kështu e vendosur kjo kornizë metodologjike, ishte e vendosur një organizim i duhur dhe ndarje të saktë të detyrave dhe përgjegjësive gjatë menaxhimit me rreziqet. Procesi i menaxhimit të rreziqeve operative në BPRM është vendosur në një bazë të centralizuar, në drejtim të zbatimit të metodologjive dhe sistemit të raportimit, por është i disperzuar në drejtim të zbatimit të tij. Kompetencat për menaxhim i janë ndarë Këshillit të BPRM-së, guvernatorit dhe Komisionit për menaxhim me rreziqet, personit përgjegjës për menaxhim me rreziqet, drejtuesve të njësive organizative, personave për menaxhim me rreziqet në njësitë organizative, Departamentit për auditim të brendshëm dhe në përgjithësi, gjithë të të punësuarve në BPRM.

Gjatë vitit 2015, një vëmendje e veçantë iu kushtua proceseve dhe projekteve të punës, identifikimit të lidhjes së tyre me qëllimet strategjike dhe është bërë një lidhje funksionale të proceseve dhe projekteve të punës të cilët zbatohen nga njësitë e shumta organizative në BPRM. Bazuar në analizën e punës në të gjitha njësitë organizative janë ndarë 131 procese pune dhe 7 projekte. Pastaj, duke përdorur disa skenarë ekstreme janë përzgjedhur proceset dhe projektet kritike të punës funksionimi i të cilëve është i një rëndësie të madhe për punën, rezultatit financiar dhe reputacionit të BPRM.

Hapi i ardhshëm për menaxhim me rreziqet, përcaktimi i rreziqeve kryesore operative tek proceset dhe projektet e punës, duhet që të përfundojë deri në mes të vitit 2016, me të cilën do të krijohen kushte për përgatitje të vlerësimit të parë të rrezikut në përputhje me kornizën e re për menaxhim me rreziqet operative.

12.3. Sigurimi i vazhdimësisë në punë

BPRM zbaton proces të rregullt dhe të strukturuar të planifikimit, revidimit dhe testimit të masave të nevojshme për të siguruar mos ndërprerje të punës së proceseve afariste në situata të krizës.

Gjatë vitit 2015, njësitë organizative realizuan azhurim të Planeve për të siguruar mos ndërprerje të proceseve të punës, ku u përfshinë gjithsej 137 proceseve. Gjithashtu, për tu vërtetuar mundësia për zbatimin e planeve për mos ndërprerjen e proceseve kritike të punës, në vitin 2015 u realizuan aktivitete për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm, trajnim për të punësuarit dhe testim i planeve për të siguruar mos ndërprerje tek dhjetë procese kritike të punës nën kushte të skenarëve të krizës më parë të definuar dhe një varg testimesh. Për rezultatet e testeve të realizuara janë përpunuar raporte të detajuara me planet akcionale përkatëse për zbatimin e masave të përcaktuara për të përmirësuar planet për sigurimin e vazhdimësisë në punë.


Shtabi i Krizave i BPRM e shqyrton Raportin për zbatimin e vazhdimësisë së Politikës për mos ndërprerje të punës së BPRM për vitin 2015 dhe në të njëjtën kohë solli konkluzione në pajtueshmëri sipas Planit për sigurim të mos ndërprerjes së punës në BPRM.

12.4. Administrimi i burimeve njerëzore

BPRM është institucion e cila vazhdimisht kujdeset dhe investon tek punonjësit e saj, me qëllim të përforcimit të aftësive dhe kompetencave të tyre dhe rritjen e njohurive profesionale me qëllim të krijimit të një kuadri të kualifikuar, i cili në mënyre adekuate do ti përgjigjet sfidave për realizimin e suksesshëm të qëllimeve të saja. Gjatë vitit 2015, Drejtoria për menaxhim me burimeve njerëzore solli një sërë aktivitete në drejtim të përmirësimit të proceseve të menaxhimit me burimet njerëzore. Në të njëjtën kohë, në masë të madhe përmirësohen funksionet analitike dhe të raportimit të menaxhimit me burime njerëzore, me përgatitje të raporteve vjetore gjithëpërfshirëse, të cilët e përmbledhin analizat e të gjitha proceseve në fushën e menaxhimit me burime njerëzore.

Në vitin 2015, në krahasim me 2014, nuk ka ndryshim në numrin e të punësuarve i cili numër është 439 punëtorë. Në vitin 2015, nuk është vërejtur ndonjë ndryshim në aspekt të gjinisë dhe strukturës së moshës të të punësuarve në BPRM, në krahasim me vitet e mëparshme, pjesëmarrja e femrave është 59% kundrejt meshkujve me 41%.

Grafiku 90
Struktura e kualifikuar e të punësuarve në BPRM në vitin 2015 (në përqindje)




Burimi: BPRM.

Në aspekt të strukturës së moshës, moshë mesatare e të të punësuarve është 44.6 vjeç në vitin 2015, kundrejt moshës mesatare prej 44.8 vjeç në vitin 2014. Struktura e kualifikuar shënon rënie në numrin e të të punësuarve me arsim të mesëm nga 26.45% në 24.6%, ndërsa një rritje shihet tek numri i punëtorëve të cilët kanë përfunduar studimet e magjistraturës, nga 16.6% në 19.4%, dhe një rritje të dukshme ka edhe tek përqindja e doktorëve të shkencave, nga 2.9% në 4.8%, në llogari të uljes së përqindjes të të punësuarve me arsim të lartë (nga 48.9% në 46.0%).

Proceset e zhvillimit profesional, vlerësimi i performancës së punës dhe shpërblimi

Grafiku 91
Numri i zhvillimeve profesionale të realizuara në vend dhe jashtë vendit (numri i zhvillimeve profesionale)



Burimi: BPRM.

janë procese të cilët ndikojnë në zhvillimin e karrierës së punonjësve në BPRM. Vitin e kaluar u realizuan konsultime në nivel të drejtorive për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të vlerësimit, me qëllim të sigurimit të aplikimit objektiv të saj dhe të jep informatë kthyesë tek të të punësuarit për performancën e tyre. Ky sistem shfrytëzohet si një mjet për angazhim më të madh, produktivitet dhe shfrytëzim të potencialit kreativ të institucionit. Gjithashtu, për kryerjen cilësore të të këtyre proceseve, ashtu si çdo vit, në mënyrë intenzive është punuar në zhvillimin e aftësive menaxheriale të të gjithë udhëheqësve në institucion.

Gjatë vitit 2015 janë organizuar gjithsej 298 zhvillime profesionale në vend dhe jashtë vendit. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i zhvillimeve profesionale shënon rritje për 6.8%, përderisa në krahasim me vitin 2013 kjo përqindje ishte 27.3%. Kjo tregon se BPRM vazhdimisht investon në zhvillimin dhe përmirësimin profesional të të gjithë të punësuarve, me qëllim të përmbushjes së qëllimeve strategjike, misionit dhe vizionit të institucionit. Numri i të punësuarve të cilët kanë marrë pjesë në zhvillimin profesional është rrit për 9.6% në krahasim me vitin e kaluar, krahasuar me vitin e kaluar, me vitin 2014, kur kjo përqindje ishte 1.2%.

Organizatorët kryesorë të jashtëm për zhvillime profesionale janë Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Bankat qendrore të Bashkimit Evropian, me të cilat BPRM bashkëpunon në mënyrë intensive nëpërmes programeve për bashkëpunimit reciprok, ndërsa organizatorët kryesorë të zhvillimeve profesionale në vend paraqiten qendra e vendit për edukim, në sferën e mbrojtjes të të dhënave personale dhe ndryshimi i rregullave ligjore, në domenin e punës së BPRM.

BPRM i ndjek trendët në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, i nxit të mësuarit të vazhdueshëm dhe zhvillimin e punonjësve e sidomos të kuadrit të ri. Për këtë qëllim, janë organizuar trajnime të brendshme për aftësi të lehta të të të punësuarve, që

kanë të bëjnë me përforcimin e aftësive të lehta të punonjësve dhe strukturës menaxheriale të BPRM, si dhe trajnime të specializuara për njohuri profesionale në bashkëpunim me ekspert të jashtëm.

Për stimulim të komunikimit të mirë profesional dhe lidhjen më të mirë rrjetore të punonjësve në BPRM, në vitin 2015 u organizuan gjithsej shtatë ngjarje për ndërtim të grupeve në nivel sektorial. Ngjarjet që lidhen me ndërtimin e grupeve kanë për qëllim zhvillimin e shpirtit grupor, sigurimit të sinergjisë dhe kulturës për ndarjen e njohurive në proceset e punës si një vlerë e rëndësishme organizative e institucionit.

12.5. Veprimtaria kërkimore

Veprimtaria kërkimore e BPRM në vitin 2015 u përqendrua në fushat që janë të rëndësishme për arritjen e qëllimeve kryesore të saja dhe përforcimin e mëtejshëm të kapacitetit institucional. Projektet kërkimore të realizuara kontribuuan për të mbështetur procesin e vendimmarrjes në BPRM dhe shqyrtimin në kohë të sfidave të ardhshme. Gjatë vitit 2015 u realizuan shtatë projekte kërkimore në lidhje me: finalizimin e versionit të ri të modelit bazë për analiza të politikave – MAK-PAM, kuptimin e strukturës sektoriale të kreditimit për aktivitete ekonomike dhe kursit të këmbimit koncentrimin dhe karakteristikat strukturore të plasmanëve jofunksionale, infrastrukturës së tregut financiar dhe analiza krahasuese e sistemeve të pagesave në rajon, dhe tri punime në fushën e numizmatikës. Përveç kësaj, gjatë vitit 2015, është punuar edhe në dhjetë projekte kërkimore realizimi i të cilave është në progres, edhe atë në fushat e mëposhtme: parashikime afatshkurtra, modelime makroekonomik, komunikim dhe transparencë në fushën e politikës monetare, bashkëveprime midis sektorëve themelore makroekonomik, stabilitetit financiar, hulumtime për qëllime të statistikave, numizmatika dhe teknologjitë e informacionit. Programi për veprimtari kërkimore për periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2018, e miratuar në mesin e vitit 2015, udhëzon në aktivitete të mëtejshëm në drejtim të projektet kërkimore të filluara, si dhe u plotësua edhe me disa projekte të reja.

Më 23 prill 2015, me rastin e përvjetorit të pavarësisë monetare të Republikës së Maqedonisë, ishte e organizuar konferenca e katërt me temë: "Trajtimi me rigidët strukturore në kontekst të efektivitetit të transmisionit të politikës monetare." Konferenca ishte e organizuar në katër sesione të mbulonin tema të rëndësishme për bankat qendrore, institucionet akademike dhe kërkimore, duke përfshirë edhe panelin e Guvernatorëve për sfidat me të cilat përballen bankat qendrore. Në konferenca u prezantuan materialet kërkimore të përfaqësuesve të bankave qendrore dhe institucioneve akademike nga rajoni dhe BE. Në kuadër të kësaj ngjarje ishte ndarë edhe çmimi i rregullt vjetor i BPRM për veprën më të mirë nga hulumtuesi i ri, në fushën e makroekonomisë dhe bankave dhe sistemi bankar.

Në kuadër të aktiviteteve për të mbështetje të zhvillimit të aktiviteteve analitike dhe kërkimore vazhdoi puna e Klubit të hulumtuesve, i cili gjatë vitit 2015 mbajti katër seanca tremujore. Në këto sesione u prezantuan dhe u diskutuan shumë punime kërkimore shkencore që i adresohen pyetjeve vijuese kërkimore: formimin e pagave dhe çmimeve, determinantët dhe ciklet e politikës fiskale, ndikimi i politikës fiskale në llogarinë rrjedhëse, efektet nga goditjet e jashtme ndaj qëndrueshmërisë dhe borxhit publik, marrëdhëniet midis tatimeve dhe pabarazive, lidhja midis kredive dhe rritjes ekonomike, konvergjenca drejt BE-së dhe kuptimi i goditjeve në ofertën e kredive. Gjithashtu gjatë vitit në BPRM u organizuan ligjërata të veçanta nga ekspertë të shquar ndërkombëtarë mbi tema aktuale nga aspekt i

punës qendrore-bankare. Gjatë vitit 2015, me qëllim të arritjes së zhvillimit të mëtejshëm të veprimtarisë kërkimore, BPRM realizoi bashkëpunim teknik me Bankën Qendrore Gjermane. Të punësuarit në Bankën popullore me punimet dhe prezantimet e tyre morën pjesë në shumë konferenca dhe ngjarje ndërkombëtare.

12.6. Zhvillimi në fushën e teknologjisë informative

Në kuadër të aktiviteteve të ndërmarra për realizimin e Programin vjetor të BPRM, gjatë vitit 2015 në fushën e teknologjisë së informatikës është punuar në më shumë se 6000 raste të punës. Nga këto, pjesa më e madhe, ose 62%, janë kërkesat për shërbime të IT nga katalogu (e cila numëron rreth 50 shërbime), 28% kanë të bëjnë me zgjidhjen e incidenteve dhe ndihmë gjatë punës së punëtorëve në lidhje me aplikimin e IT-së, ndërsa 10% kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rregullt e infrastrukturës informative dhe përmirësimin e saj.

Drejtoria e IT-së mban më shumë se 170 aplikacione (zgjidhje software) të cilën punonjësit e përdorin për çdo ditë. Gjatë vitit 2015, nga Drejtoria e IT-së, në përputhje me programin e përcaktuar të punës janë realizuar 16 kërkesa për përpunim të aplikacioneve të reja dhe 215 kërkesa për ndryshime të aplikacioneve ekzistuese (duke shtuar funksionalitete të reja, raporte, module dhe përmirësime dhe ndryshime të tjera).

Gjatë vitit 2015 është përfunduar projekti për unifikimin e rrjetit të mbyllur të komunikimit përmes bankave dhe institucioneve financiare, me të cilën e u mundësua zgjerimi i kapaciteteve, lidhjes së lokacioneve rezerve të bankave dhe pjesëmarrjes në më shumë operator të komunikimit. Gjithashtu u kompletuan edhe shumë projekte për mirëmbajtje të rregullt, siç janë: zëvendësim i më shumë se 200 kompjuterëve personal, rindërtim i sistemit për autentifikim dhe të drejta për qasje të përdoruesve (Active Directory), rindërtim i mjeteve për kontrolli në bazën e të dhënave e të tjera. Gjithashtu, është punuar edhe në shumë projekte afatmesme, të tilla: futja e një sistemi për ruajtjen e të dhënave, sistemit për biznes-intelegjencë, softver për kontroll të kodeve programuese si dhe rindërtim i sistemit të pagesave në kohë reale, në të cilën do të punohet edhe në të ardhmen.

Në periudhën prej 2 deri më 4 qershor 2015, Drejtoria për IT organizon IT forum me temë "Zgjidhje për depot e të dhënave dhe të biznes-intelegjencës në bankat qendrore" (Data Warehouse and Business Intelligence Solutions in Central Banks). Në këtë forum morrën pjesë 26 mysafirë të huaj nga 19 vende dhe u prezantuan gjithsej 19 punime. IT-forumi ofroi mundësi të shkëlqyeshme për të mësuar më shumë në lidhje me menaxhimin me të dhëna dhe analiza e tyre, përmes bisedimeve, diskutimeve, shkëmbime të përvojave dhe prezantime se si bankat qendrore menaxhojnë dhe i shfrytëzojnë të dhënat e tyre.

XIII. Aktivitete tjera

13.1. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë vitit 2015, BPRM vazhdoi me aktivitetet lidhur me mirëmbajtjen dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, si në rafshin multilateral ashtu edhe në atë bilateral.

Në kuadër të bashkëpunimit multilateral, u realizua vizitë e rregullt nga ana e përfaqësuesve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), lidhur me konsultimet në përputhshmëri me Nenin IV të Statutit të Fondit. Gjatë vitit 2015, gjithashtu vazhdoi bashkëpunimi teknik me FMN në fushën e statistikave monetare edhe financiare, gjegjësisht avancimin e tyre. Nga ana tjetër, guvernatori dhe zëvendës guvernatorët morrën pjesë në takimet e rregullta pranverore dhe në asamblenë vjetor të FMN-së dhe Bankës Botërore, si dhe në takimin e konstituencës holandeze, në të cilën bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë. Sa i përket bashkëpunimit me Bankën Botërore, u realizuan një seri takimesh me përfaqësuesit e këtij institucioni në lidhje me aranzhmanet aktuale, përgatitjen e raporteve të rregullta dhe publikimeve të Bankës Botërore. Gjatë vitit 2015, BPRM morri pjesë në disa nga takimet e rregullta të Bankës për rregullime ndërkombëtare në Bazel, si dhe në takimet e organizuara nga Klubi i guvernatorëve të bankave qendrore të rajonit të Detit të Zi, Ballkanit dhe Azisë Qendrore.

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral, BPRM vazhdoi bashkëpunimin teknik të vendosur me partnerët më të rëndësishëm strategjik, Bankën Qendrore Holandeze, Bankën Qendrore Gjermane, BP të Polonisë, si dhe me bankat tjera qendrore të BE-së dhe vendeve në rajon. Sa i përket bashkëpunimit me Bankën Qendrore Evropiane, i njëjti u zhvillua në kuadër të qasjes së vendosur rajonale për bashkëpunim mes BQE dhe bankave qendrore të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë vitit 2015, BPRM vazhdoi të marrë pjesë në procesin e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, përmes pjesëmarrjes së saj në zbatimin e detyrimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (MSA), në përgatitjen dhe realizimin e Programit vjetor kombëtar për miratimin e të drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA), si dhe në kuadër të përgatitjeve të Programit për reforma ekonomike (ERP).

BPRM ka qenë e përfshirë në projektin "Harmonizim i mëtutjeshëm me BE acquis në fushën e lëvizjes së kapitalit dhe shërbimeve financiare – tregut të letrave me vlerë dhe shërbimeve investive", në pjesën që ka të bëjë me harmonizimin e Direktivës për shërbime pagesore, si dhe në tuining-projektin "Përforcim i mëtutjeshëm i kapaciteteve institucionale dhe organizacionale në procesin e integritimit evropian", në kapitullin "Lëvizje e lirë e kapitalit" dhe "Politika ekonomike dhe monetare". Gjithashtu, në kuadër të Programit shumëpërdorues për bashkëpunim statistikor nga IPA, u siguroa përkrahje financiare për pjesëmarrje të përfaqësuesve të BPRM-së në takimet e rregullta të Eurostat-it, në fushën e statistikave të bilancit të pagesave dhe statistikave të llogarive financiare, si dhe pjesëmarrje në trajnimet në fushën e statistikave të tregtisë së jashtme të shërbimeve dhe statistikave financiare qeveritare. Në kuadër të instrumentit për ndihmë teknike të BE-së (TAIEX) gjatë vitit me sukses janë realizuar tetë projekte në më shumë fusha të punës së bankave qendrore.

13.2. Marrëdhëniet me publikun

Banka Popullore edhe në vitin 2015 vazhdoi të mbaj politikë transparente me qëllim të informimit në kohë të publikut më të gjërë për punën e saj. Informimi u realizua përmes komunikimit të rregullt me mediat publike përmes lëshimit të njoftimeve për shtyp, dhënie përgjigje të pyetjeve gazetareske, organizim të intervistave, konferenca për shtyp, si dhe publikimi i përmbajtjeve në internet-faqen (www.nbrm.mk). Në faqen fillestare të internet-faqes në mënyrë të përditësuar publikoheshin njoftimet e rregullta nga mbledhjet e Këshillit të Bankës Popullore dhe të Komisionit për politikë operative monetare të BPRM-së si dhe njoftime për zbatimin e instrumenteve të politikës monetare si në gjuhën maqedonase ashtu edhe në atë angleze. Në të njëjtën kohë, është rritur edhe numri i kumtesave me përmbajtje të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me punën e Bankës. Gjatë vitit 2015 guvernatori dhe zëvendësguvernatorët e Bankës Popullore kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në shumë ngjarje në vend dhe jashtë vendit në të cilat kanë mbajtur fjalime dhe prezantime të tyre.

Banka Popullore komunikon në mënyrë të drejtpërdrejt me publikun edhe përmes postës elektronike info@nbrm.mk e cila është e vendosur në internet-faqen e Bankës Popullore. Gjithashtu në internet-faqen është e shpallur edhe adresa për qasje të lirë tek informatat me karakter publik, si dhe adresa contact.statistika@nbrm.mk dhe supervizija@nbrm.mk për parashtrim të pyetjeve dhe përgjigjeve nga fusha përkatëse profesionale.

Gjatë vitit 2015, në internet faqen rregullisht janë të përditësuara materialet e vendosura si në gjuhën maqedonase ashtu edhe në atë angleze.

BPRM e informon publikun edhe përmes botimit të publikimit vjetor në formë të shtypur për punën e BPRM-së me titull "Raporti vjetor për vitin 2014". Ky raport, si dhe raportet tjera vjetore, kuartale, mujore dhe të tjera për punën e BPRM-së, janë të publikuara edhe në formë elektronike në internet faqen e BPRM-së, në gjuhën maqedonase dhe atë angleze. Nga viti 2015 filloi përkthimi në gjuhën shqipe i raporteve vjetore dhe kuartale të punës së Bankës, me çka raportet e përkthyer janë të publikuara në internet faqen e BPRM-së.

13.3. Edukimi financiar

Në kuadër të projektit "Edukimi financiar" gjatë vitit 2014 u realizuan disa aktivitete për të informuar për së afërmi popullatën me financat dhe ekonominë si dhe gjithashtu u organizuan ngjarje me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

Më 27 dhe 28 shkurt të vitit 2015, BPRM dhe rregullatorët tjerë të sistemit financiar, në bashkëpunim me Fondin Evropian për Evropën Juglindore (European Fund for Southeast Europe – EFSE), organizuan punëtori për gazetarët e redaksive ekonomike të medimeve të shtypura, televizione dhe elektronike.

Gjatë Javës globale të parave, nga 09 e deri më 17 Mars të vitit 2015, por edhe gjatë tërë vitit u organizuan vizita në shkollat fillore dhe të mesme në tërë Republikën, në kuadër të së cilës janë mbajtur ligjërata me qëllim që nxënësit të njihen për së afërmi me paranë, rëndësinë e tyre, këmbimin, inflacionin, politikën monetare. Gjatë vitit janë organizuar edhe vizita në BPRM nga nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, por edhe studentë nga e universitetet e Republikës.

BPRM ka të vendosur bashkëpunim me shumë organizata të njohura ndërkombëtare dhe institucione nga lëmi i përfshirjes financiare, siç janë: Organizata Ndërkombëtare për Edukim Financiar të fëmijëve dhe të rinjve, Aflatun, Aleanca për Përfshirje Financiare dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. BPRM, si institucion partner i këtyre organizatave ndërkombëtare, ndërmerr iniciativa, organizon aktivitete dhe merr pjesë në ngjarje të ndryshme ndërkombëtare. Më konkretisht, në bashkëpunim me Aleancën për Përfshirje Financiare (AFI), me përkrahje të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BZM) dhe Sekretariatit për Çështje Ekonomike të Zvicrës (SECO) u organizua ngjarje publike me titull: Forumi i Parë Rajonal në Europën Lindore dhe Azinë Qendrore (ECA) për përfshirje financiare në rrjetin e AFI-së, i cila u mbajt në Shkup, nga 26 e deri më 28 tetor të vitit 2015. Qëllimi kryesor i ngjarjes ishte që pjesëmarrësit e shtatëmbëdhjetë institucioneve nga rajoni i ECA-së, të cilët janë bartës të politikave për: shërbime financiare digjitale (DFS), financim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), edukim të konsumatorëve dhe sjelljes së tregut (CEMC) dhe të dhënat për përfshirje financiare (FID), të konfirmojnë konsensusin e Shkupit, si platformë për bashkëpunim të mëtutjeshëm me rrjetin e AFI-së.

Më 02 nëntor të vitit 2015, Fondi për Zhvillim të Fondit Evropian për Europën Juglindore (EFSE), në bashkëpunim me BPRM-në, promovoi broshurën edukative "Blerje të shtëpisë me kredi banesore" në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe, si dhe video promovuese në gjuhën maqedonase. Broshura, e cila para së gjithash është e dedikuar për amvisëritë në Republikën e Maqedonisë, jep informacione për rreziqet që duhet merren parasysh para marrjes së kredive afatgjate me qëllim që t'iu ndihmoj përdoruesve të kredive të marrin vendime financiare të shëndosha.

Me rastin e Ditës Botërore të Kursimeve më 31 tetor, BPRM, Ministria e Financave dhe Agjencia për Mbikëqyrje të Sigurimeve shpalli konkurs për fëmijë dhe të rinj, për vepra letrare dhe artistike në këto tema: "Edhe unë di të kursej" dhe "Çka do të thotë për mua sigurimi i shtëpisë dhe familjes". Konkursi është në kuadër të aktiviteteve për ngritjen e nivelit dhe të vetëdijes së përgjithshme për kulturën, përfshirjen dhe edukimin financiar të popullatës, në veçanti tek të rinjtë. Sipas organizatorëve, tri institucionet e përfshira, bëhet fjalë për ide kreative dhe inovative të fëmijëve në lidhje me kursimin dhe sigurimin. Dymbëdhjetë konkurruesit më të suksesshëm fituan diploma dhe shpërblime në para, ndërsa shkollave pjesëmarrëse në konkurs iu ndanë mirënjohje.

13.4. Veprimtari muzeore, bibliotekare dhe arkivuese

Në aspektin e aktiviteteve hulumtuese si pjesë e punës së Muzeut të Bankës Popullore, gjatë vitit 2015, u realizuan tre projekte të veçanta hulumtuese, rezultatet e të cilave u prezantuan në Kongresin e XV numizmatik botërore, të mbajtur në shtator në Itali. Gjithashtu vazhdoi finalizimi i projektit hulumtues për material të gjerë numizmatik i zbuluar në Kalanë e Samoilit në Ohër, i cili do të publikohet si veprimtari bashkë-botuese me Institucionin Kombëtar Muzeu dhe Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Ohër.

Përveç këtyre aktiviteteve u publikua edhe Udhërrëfyes për fëmijë përgjatë ekspozitës muzeore të Bankës Popullore e cila shkaktoi rritje të konsiderueshme të vizitave në Muze, nga të cilët numri më i madh ishin fëmijë të moshës shkollore, e cila ishte në përputhshmëri me qëllimin e tij.

Në lidhje me aktivitetet hulumtuese, si pjesë e punës së bibliotekës dhe arkivit të Bankës Popullore, vitin e kaluar u ndërmorën aktivitete hulumtuese paraprake për përzgjedhjen e materialit arkivor i cili është i rëndësishëm për punës e bankës qendrore në Republikën e Maqedonisë dhe i cili ndodhet në Bankën Popullore të Serbisë.